

MOISI ZALOSHNA

BIBLIOTEKA
SHTETIT

854 .32

L. 22



Gurë
Stralli

TREGIME E NOVELA

8 SH. 32
—
£. 22

MOISI ZALOSHNAJA

GURË STRALLI

tregime e novela

3444

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

GURË STRALLI

|| Kisha vajtur për një vizitë në muzeun e Luftës Nacionalçlirimtare të qytetit të vogël N. dhe po bisedoja me drejtorin e tij. Ndërtesa e muzeut është bërë e re. Pak vite ka që është inauguruar. Tek e sheh nga jashtë, të mbeten sytë në të për bukurinë që ka. Unë, për veten time, bëj nga bëj e vete, më duket sikur atje gjej çlodhje. Kishim zënë me drejtorin një bisedë për Luftën. Ai më pyeste e unë i tregojja. Kohë më kohë atij i ngrinte lapsi në dorë, hidhte sytë mbi mua, më vështronë si i hutuar, sikur më shih të parë dhe dukej sikur më thoshte: «Çfarë trimash na janë vrarë, xha Selman!». Një herë tjetër: «Çfarë force kjo fjala e Partisë, mor xha Selman!».

Ndërkaq dëgjohet një e trokitur në derë. Qe një e trokitur tingëlluese, si me shkop.

— Hyr.

Te dera u dha një trup i gjatë, eshtra më shumë se mish. Dhe një shkop i trashë me dorak të përkulur bëri trak në dysheme. Ne i thamë, të dy

në një gojë me drejtorin, si të isha edhe unë zot shtëpie: «Urdhëro, bujrëm, bujrëm, Asllan, si në shtëpinë tënde.»

Vuri buzën në gaz Llania për shakanë tonë, a ndofta pse e ftova edhe unë, si në shtëpinë time. Na u përgjigj po me shaka:

— Po të mos ishte edhe shtëpia ime, nuk vija.

U ul. U pëershëndetëm. Nxora paketën, i dhashë një cigare dhe i zgjata çakmakun e ndezur.

— Jo, — më tha e me një të fryrë ma shoi sakaq flakën e çakmakut, — do ta ndezim si njëherë e një kohë. — Dhe futi dorën në xhepin e xhaketës. Nxori që andej një shakullore të vogël prej lëkure keci të argasur, siç i argasnin barinjtë dikur, shtëllizi nga gryka e saj një rrip të hollë po prej lëkure, pastaj futi në të dy gishtat tregues.

Llania nxori qetë-qetë urorin, një gur stralli, një top eshkë sa një arrë me shark, shkëputi prej andej një fijez, sikur të shkëpuste një llatkëz mishi nga trupi i tij dhe shkrap i ra vetëm një herë gurit me uror. Vura re se duart i dridheshin paksa dhe në fytyrë kishte një shprehje si i dalldisur në mendime e kujtime. Eshka zuri me herën e parë. Era e tymit të saj të hollë, që nisi të ngrihej fjollë përpjetë, na kënaqi.

— Na paska marrë malli për erën e eshkës! — thamë të dy me drejtorin e muzeut dhe i ndezëm me radhë cigaret. Kur eshka po i afrohej fundit e ndezi edhe velë Llania.

— Kjo, — ai na tregoi fijen e eshkës, — éshtë hera e parë dhe e fundit...

Drejtori më pa drejt në sy, edhe unë po ashtu.

Llania futi brenda në shakullore urorin, gurin, eshkën e, si e rrotulloi disa herë rripin rrëth grykës,

e mblođhi midis pëllëmbëve. Tërë këto veprime i bëri me drithërima shpirti, me aq përkëdheli e kujdesje, sa thoshe se në atë mënyrë kishte marrë e po ruante zemrën e vet.

— Për këtë kam ardhur... Kjo më pruri s-këtu...

Drejtori i muzeut, me një gëzim të brendshëm që nuk deshi ta fshihte, iu drejtua:

— Xha Selmani nuk e di, po unë i rashë hiles që në krye, se ajo shakullore urori të ka prurë këtë radhë këtu. Veç tregona tani...

Drejtorit i lexohej në fytyrë padurimi.

Jam gati moshatar me Asllan Osumin. Ia dimë njëri-tjetrit jetën pothuaj më të gjitha. Ai ka qenë i internuar nga fashistët gjermanë në Mathauzen e, gjer atë kohë, kur pati rënë fjala, më pati treguar pér vuajtjet që pati hequr në internim. Por, që të lidhej me ato vuajtje edhe historia e shakullores që mbante ndër duar, këtë nuk ma kishte treguar.

— Si është puna e asaj queske, bre Llane? — e nxita se, të them të drejtën, edhe mua nuk po më durohej.

Më pa si me inat, si me qejf të prishur, a, më saktë, si me dhimbje. Nuk po kuptoja gjë. I bëra shenjë me duar dhe e pyeta me atë gjest: «Mos e shkela?»

Më kuptoi.

— E shkele dhe e shkele keq, — më zgjati duart me shakulloren pushtuar midis tyre. — Pse e quan queskë!?

Përnjëherësh, as vetë nuk e di, po ndjeva thellë
në vvetete një pendesë gjer në dhimbje.

— Jo, o Asllan, unë nuk e di, por... të më besosh...

Ma thithi pendesën nga sytë, nga dridhjet e zërit. Thithi cigaren e dytë, që sapo e ndezi me fundin e së parës (koka e cigares skuqi fort e gjatë) dhe na u drejtua në një kohë të dyve, duke shëtitur sytë ngultas sa te njëri, te tjetri.

— Këtë shakullore me urorin, gurët e strallit e me dy topa eshkë gati nga kaq, — mblodhi dorën grusht për të treguar madhësinë, — i kam pasur me vete, i ruajta sa qeshë, dy vjet e ca, i internuar në Mathauzen dhe i solla prapë në Shqipëri. — Shtrëngoi ballin e rrumbullakët me pëllëmbën e madhe e gishtat tërë nyje të dukshme, jo nga mosha më shumë se nga puna, si të kishte nevojë t'i mblidhte e t'i rendiste mirë kujtimet. — I solla në Shqipëri, — tha, — por më kanë kushtuar shumë. — Këtu i mëshoi zërit dhe përsëriti me zë edhe më të fortë: — Më kanë kushtuar shumë!... Vec... — ngriti gishtin tregues i dalldisur e na e drejtoi para syve, me një zë që pas çdo fjale bëhej më i gjallë, më i fuqishëm, — vec, këta që janë këtu më bënë edhe të kthehem i gjallë vetë, të kthehen gjallë edhe shokë të tjerë dhe... — psherëtiu thellë, pa frikë se mos lëndonte apo turpéronte burrërinë e vet, — dhe, edhe ata që lamë atje përjetë, këta gurë... — e shtrëngoi shakulloren, — i bënë që të vdisnin shqiptarë. E dini ç'do të thotë të vdesësh si shqiptar?! — Dhe u përgjigj po vetë: — Këtë e di unë, unë që e kam parë me këta sy. Dhe nemceve, sado egër-sira që qenë, sado që kishin hasur në burra e çfarë burrash, prapëseprapë vdekja e tanëve atje ua zgur-

dullonte sytë... Dhe unë them... — e mori shakulloren në një dorë, — dhe unë them se edhe kjo shakullore, me ç'ka brenda, i bëri edhe më burra tanët, gjithë kohën sa vuajtëm atje dhe në qastet e vdekjes...

Jashtë ndihej jehona e një këngë në radio, që buçiste nga dritaret e pallateve, ngritur në shpat të kodrës, ku është ndërtuar qyteti ynë.

Llania u ra disa herë thinjave me dorë, si t'i paloste. Nga tërë shprehja e fytyrës, e syve dhe e qëndrimit të tij pata përshtypjen se ai me trup ishte aty me ne, por me mendje bridhte.

— E kam mbajtur këtë shakullore në atë copë valixhe që kam. Im nip ma pati parë kur merrja makinën e rrojës. Po nuk më pati pyetur. Dje, tek po kërkoja diçka, ma pa përsëri.

«C'e ke, baba, atë shakullore që e ruan si drinën e syve?! Mos ke, — më shkeli syrin me qerra-tallëk, — ndonjë thesar?»

«Për mua është më shumë, më shumë...»

Nipi u bë kureshtar.

Nga ky qast Asllani po fliste si i harruar nga gjithçka dhe notonte vetëm nëpër dallgë kujtimesh, duke u fjalosur si me vete;

— Më nisën nga Shqipëria në një mesnatë të errët pus. Mjegulla e dendur mbulonte çdo gjë përreth. Nuk dija ku hidhja këmbët. Gjëmimi i motorëve të makinave buçiste me tasari. Eh, ta kisha parë edhe një herë këtë baltë që më ushqeu! Ta kisha parë edhe një herë qiellin tim! Por me mend u thosha fricëve: «E ç'do të fitoni, mor qena, more egërsira, se do të më vrissni mua?!!» Në Operacionin e Dimrit ne ua kishim bërë brinjët byk. Komisari na pati thënë: Ditët e Hitlerit qenë të numëruara.

Shpejt në Shqipëri Partia do ta bënte vendin të lirë, pa këpusha e shushunja. Edhe kokën time ma kishte paguar shtrenjtë nazisti. Në këngët tona thuhet: Vrave shtatë, pa të vranë! por unë, besa, e them jo për mburrje, pata rrëkellyer shtatëmbëdhjetë, njëzet e shtatë, e kush i kishte numëruar qentë! Jo, jo, nuk po më vinte keq pér veten. Doja të ishte ditë, të ishte makar natë me hënë dhe t'i hidhja njëherë sytë rreth e qark vendit tim, që të mos shkoja i maluar. Më kishin rrasur në një makinë të mbyllur. Atje kishte dhe shumë të tjerë. Isha i fundit. E mbyllën derën. Pus dynjaja. Në fund, dy esesë me mitraloza të vegjël dore gati pér zjarr. Herë pas here ndiznin një elektrik dore. Atëherë pashë se qemë bërë kokë më kokë, si ata berrat, prandaj edhe mezi rrotulloheshim.

— Shok, nga je?

— Shok, po ti ku ke qenë?

— Ty pse të kanë burgosur?

— Nuk më vjen keq... Këto bisha...

Esesët në fund ndiznin elektrikun dhe ulërinin, kur pëshpëritjet shtoheshin.

Ecëm tërë natën dhe një pjesë të ditës. U hap pér një minutë dera, po drita na vrau sytë e nuk e morëm vesh ku ishim. Hynë dy esesë të tjerë me mitraloza, u mbyll dera, prapë errësirë. Një orë, dy orë, errësirë, ku ta dish! Dhe prapë makina u ndez. Po sa ishin para, sa prapa? Ec... ec... ec! Me hamentje kuptionim se kalonim nëpér rrugë të këqija, ngjitnim të përpjeta, merrnim të tatëpjeta. Uria na grinte.

— U mor vesh, nuk do të na pushkatojnë.

— Si duket po na internojnë.

— Në ç'vend, vallë, po na shpien?

— Xhanëm, pse na internojnë e nuk na vranë?

— I duhem i përkrahë pune. Përndryshe pse t'i dhimbej një plumb fashistit?!

— Mirë, or shok, po ne, gjersa të sosim në Gjermani, kemi vdekur për bukë.

Ec... ec... ec... Pas dyzet e tetë orësh, ndofta edhe më shumë, na dhanë nga dyqind gramë bukë të zezë e një gojë marmalatë. Qëndrojmë. Sa? S'e dimë. Hapet dera rrallëherë, bëhet dritë, po sytë na qenë verbuar. As ndërrimin e rojeve nuk e merrnim vesh. Dhe ja, një natë na zbritën. Na urdhëruan me shenjë e me ulërima. Fishkëllima rrëqethëse çanin kupën e errët të qiellit. Zhurma gjithfarë llojesh të panjohura, lëvizje, të bërtitura, urdhra... Të mbajtur dorë për dore me njëri-tjetrin ecnim kuturu. Kush më ka zënë për cepi të setrës e s'më lëshon? Kë kam zënë për krahu te bërryli e mbahem fort? Me goditje qytash, shkelmash e grushtesh, me sa mundnin e ku mundnin, na futën në një vagon të blinduar, që as e kishim parë, as e kishim dëgjuar. Errësirë, etje dhe uri.

Besnikut i erdhi një teshtimë. Asllani u duk sikur atë kohë u përmend nga një gjendje e përhumbur. U shkund i téri paksa, i çoi sytë vetëtimthi sa te ne, aq edhe rrëth e qark, e mblodhi në çast dhe na pyeti:

— Mos po e zgjas shumë?... Mos ju lodha?

— Vazhdo, — nxitova t'i thosha dhe, me një shenjë që i bëra, i dhashë të kuptonte se po e ndiqnim të përpire.

— ... Arritëm më në fund gjer në një stacion të vogël treni, — vazhdoi Llania. — Ky vend paskesh qenë jo larg Mathauzenit. Atje na zbritën nga vagonat e blinduar. Krrakërimat e dyerve zhurmëruan.

Kot që të përsërit të tregoj klithmat, goditjet, të sharat. Qe mëngjes e dielli pak kish që kishte lindur. Ftohtë që të hynte në palcë. Dëbora gjer në gju, e ngrirë, e shkoqur, si kokrra orizi, kërciste nën këmbë. Me sy të rrudhur nga drita e fortë e nga shkëlqimi i borës, me duart lëshuar përpara, kërrusur si të thyer në kryqe, ecnim duke u përpjekur të gjenim dikë ku të mbaheshim. Lëkundeshim tamam si të dehur sa përpara, majtas e djathtas. Shumë nga ne pengohen e marrin vrull, krahëhapët dhe me hundë e me buzë përplasen mbi dëborë. Të fuqishëm përpiken të ngrihen prapë, po shkelmat e esesëve i bëjnë të shkarrëzehen nëpër dëborë përdy-tre metra krahë-e-shalëhapët.

Në këto e sipër ndihen pëshpëritje:

- Shqiptar?
- Shqiptar.
- Të mos ndahemi.
- Po, të mos ndahemi.

Një dorë më mbërtheu fort pér krahu. Forca e saj nuk i ngjante asaj së një burri. Me mend e kisha përfytyruar të vogël, ashtu siç qe vërtet. Shumë herë ajo dorë më qe ngjitur te krahu e nuk më qe shqitur. Kush do të ishte vallë? Disa herë kisha shquar nëpër terr një njeri të vogël, të krus-pullosoj dhe pas tij një tjetër, të madh, që s'i shqitej të voglit e që i pëshpëriste vazhdimisht.

— Mos iu shqit nga krahu atij shokut, xhan.

Herë i shquaaja mirë këto porosi plot dhimbje, herë nuk arrija.

U mblodhëm të gjithë mbi dëborë. Kishim qenë shumë. Tetëqind, një mijë... ndofta edhe më shumë. Lloj-lloj njerëzish, lloj-lloj gjuhësh. U grupuan gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë shqiptarë.

— Sa jemi?

Mblidhen supet.

— Ata që janë shqiptarë, të vijnë këtu.

Ky zë që thirri fort, na bëri të kthenim kryet
andej nga erdhi. Qe një i ri fytyrëmbël, me sy në
formë bajameje.

— Mirë bëre, shok.

— Thirr edhe një herë. Do të ketë edhe të
tjerë.

I riu thirri përsëri, me dorën si hinkë te goja.
Vijnë të nxituar e të telikosur edhe shtatë a tetë
të tjerë e bashkohen me ne, me një gëzim të ngrirë
në fytyrat e zbehta, të buhavitura, me sy të enjtur,
të skuqur. Ka edhe plot gra në atë turmë. Ja, në
krahun tim të djathtë shoh një vajzë dymbëdhjetë-
-trembëdhjetë vjeçë me kokën të mbështjellë me
një shall të leshtë, punuar me shtiza. E thatë, e
hequr në fytyrë, qafa e dorës si shkarpë. Dhe pranë
saj ai trup i madh që e kisha shquar vazhdimisht
si hije pas meje. Ishte një grua. Ia mora kokën vaj-
zës, ia vura në prehër e po e përkëdhelja.

— Shqiptare?

— Po.

— Po ju? — pyeta gruan ngjitur.

— Shqiptare. Jam e éma.

Pastaj gruaja heshti e qetë, me sytë plot urej-
tje për esesët, që vinin vërdallë poshtë e lart të
çakërdisur, me një shprehje të fytyrës si të donin
të hanin njerëz.

— Prej nga jeni?

— Nga Elbasani. Më quajnë Ana.

— Po çupën?

— Katerinë?

— Këtë ke vetëm?

— Kam dy djem partizanë. I madhi është komisar i batalionit partizan të Dumresë. Kam dhe një vajzë më të vogël dhe burrin.

— Ata shpëtuan?

— Po. Nuk u ndodhën në shtëpi atë natë që erdhën e na arrestuan.

— Mos kini merak. Do të shpëtojmë. Këta qena nuk e kanë të gjatë.

— Për asgjë nuk kam gajle, — më foli gruaja, e vendosur. — A arritëm t'i shohim këto bisha të bëhen kështu, të çmendur, përpara vdekjes që shohin me sy! Hic s'më vjen keq! Por ama... — Ana më tregoi shpinën e Katerinës dhe murmuriti lehtë-lehtë me një dhimbje që nuk kam si t'jua tregoj, — dua që të mos shoh gjë me sy. — Me dorë më bëri shenjë se donte të vdiste ajo e para.

— As mos e shko nëpër mend!

I thashë kështu e i tregova grushtin për t'i thënë: qëndro e patundur. Pastaj me zë:

— Je shqiptare, apo jo!

Pohoi me kokë:

— Jam shqiptare dhe më e fortë nga sa mund të kujtosh ti.

Nga barku bosh, nga lodhja, pagjumësia rashië si në kllapi. Ku do të jemi vallë?! Ku na kanë prurë?! Si quhet ky vend? Britmat e esesëve sikur u përgjigjeshin pyetjeve të mia: «Mathauzen!... Mathauzen!...» dhe shënonin me gisht grupet e të inter-nuarve. Një tëngë në lugth të kraharorit sa vinte e më rëndonte plumb. Sa larg do të jemi nga Shqipëria?! Nga bie vallë Shqipëria?! Sikur të arratisemi, në ç'drejtë duhet të shkojmë?! Qiellin e veshën rë të murme, të trasha, të rënduara me dëborë. Ca grupe civilësh na erdhën përqark më pas e na shanin

në gjuhë të tyre, na kërcënonin... Kurse të tjerë na vështronin me bisht të syrit e nuk qëndronin...

Nuk i pashë nga dolën e nga i prunë ca kazanë alumini, që avullonin. Avujt e tyre në atë të ftohtë u ngjanin reve të vogla. Po na vjen gjellë, gjellë e ngrohtë! Vërtet ashtu kishte qenë. Po ç'gjellëzeza! Telhe kafeje e zezë prej elbi! Na dhanë nga një kupackë telhe e dyqind gramët e bukës prej tallashi.

Sido që qe, e hëngrëm atë skropë me babëzi.

Kushedi pse, po na mbajtën atje galic mbi dëborë, pa na lënë të lëviznim gjer në kohë dreke. Si hëngra atë lëtyrë gjellë me atë copë tallashi e misërishte, m'u ça fyelli i hundës për një duhan. Nxora çibukun, e mbusha, nxora edhe këtë shakulloren dhe ndeza eshkën. Shumë sy u drejtuan nga unë e po shikonin. Nuk po e kuptoja psenë. Ndillja çibukun si i përhumbur, i pushtuar i téri nga dhimbja për vatanin. Një nga këto strajet, me të cilin pata shkratpitur, as vetë s'e di pse, po e mbaja në dorë me sytë ngulur në të e po mendohesha, pa u merakosur pse vështronin të tjerët nga unë. Në një çast, njëri nga ata që kisha më pranë, u zgjat paksa dhe, pa më marrë leje, ma mori strallin nga dora.

— Nga Shqipëria? — më pyeti ai.

Gurin e mbante në dorë, e vështronte. Sytë e tij të përflakur m'u dukën se derdhnin tek copëza e gurit mall të pashuar.

E mbështolli gurin midis dy pëllëmbëve, thua sikur edhe ai trembej mos ia rrëmbenin. Ngriti kokën, më pa. M'u duk sikur më tha me atë vështrim: «A ia di vlerën këtij guri, vecanërisht tanë, këtu ku jemi?» Më pa, më pa gjatë e pastaj foli:

— Ruaje!...

Me të thënë kështu, ma lëshoi në dorë.

Gjer atë kohë shumë të tjerë përqark e kishin ndjekur bisedën tonë me interes. Këtë e kuptova sapo mora gurin në dorë dhe dëgjova edhe zëra të tjerë të më porositnin:

— Ruaje, shok!...

— Ruaje, vëlla!...

Pas kësaj porosie fshihej mall, dhimbje...

I riu që pati thirrur: «Ata që janë shqiptarë, të vijnë këtu», kur zbritëm'nga treni, më paskesh ndjekur me sy kur e ndeza. Më ftoi me dorë t'i shkoja pranë.

— Nga të kemi?

— Nga Skrapari.

— C'punë ke bërë?

— Çfarë s'kam bërë, pyet më mirë. Murator, kalldrëmxhi, samarxhi, më vjen ndoresh për vegla bujqësie, par menda... Kam punuar si punëtor rrugësh, kam thyer çakëll e...ku s'kam qenë! Edhe hamall në portin e Durrësit kam qenë nja gjashtë muaj.

— Pastaj?

— Pastaj, në dyzetedynë ika ilegal në çetën e Babë Myslimit. Ndenja pak ditë e që andej në çetën e Skraparit.

— Më vonë?

E vështrova njëherë për t'i thënë: «C'më pyet për më vonë? Partizan, ç'do të isha?!» Po nuk i thashë kështu, ia shpjegova me të qetë. E bëra këtë, se m'u duk që në fillim njeri i mirë.

Si m'i dëgjoi të gjitha, të thëna shkurt e shkurt, më pyeti për komandantin e batalionit komisarin e grupit partizan të Skraparit... ake në fund:

— Po ti që ka qenë?

— Komendant kompanie.

Më pëshpëriti në vesh:

— Je anëtar partie?

I tunda kryet dhe i thashë «po» ngadalë.

— Të mos ndahemi!

— Ta ndezim njëherë, — kërkoi Fatmiri. Kështu quhej shoku, për të cilin ju fola gjer tanë.

Dikujt i qe ndodhur një shkrepëse dhe u bë gati t'ia ndizte, po Fatmiri nxitoi e ia zuri dorën.

— Jo. Do të na e ndezë shoku Asllan.

Nxora këtë shakulloren e shkrapita.

Njerëzit përreth, galiç përmbi déborën e ngrirë nga të ftohtët e egër, sikur tymi e zjarri i asaj fijeje eshke të paskesh qenë tymi e zjarri i vatrave që kishin lënë larg, shumë larg, në Atdhe të tyre, u shkri-fëruan, u gjallëruan, harruan ku ndodheshin. Fatmiri hapi grykën e shakullores, i mori të tërë gurët e strallit në dorë. Unë kam qenë e jam merakli përtakëmet e duhanit. Urorin që patë, e kam bërë te Xheladin Kovaçi. Kisha një limë të vogël, çelik e shkuar çelikut, dhe vajta ia shpura, ma bëri uror. Kudo që më zinte syri një strall të mirë, paçka se kisha plot, do ta këputja një ashkël petashuhe e do ta futja në shakullore.

Fatmiri po i kalonte gurët sa nga njëri grusht në tjetrin.

— Ku i ke marrë?

— Ku s'i kam marrë! Ja, këtë e kam gjetur atje, përmbi fshatin tim. As unë nuk e di, po e kam ruajtur, se më kujtonte fshatin, ngado që veja dhe s'e kam harxhuar. — Mora një tjetër. — Këtë e kam marrë në faqen lindore të malit të Tomorit. Kaluam andej me batalionin dhe... Këtë tjetrin, kur thyja

çakëll në xhadenë Durrës-Berat, aty midis Kavajës e Lushnjës. Këtë që vjen si i kuq, në Qafë-Krrabë.

Fatmiri dëgjonte e vinte re si përmallohesha e si digjeshin zjarr sytë e mi e të të tjerëve. Gurin që e kisha gjetur në fshat, po e mbante në dorë veçan.

— Ky të kujton fshatin?

Tha kështu e më pa plot sytë, duke më treguar strallin.

— Po.

— Tani të tërë këta, — ai na tregoi grushtin plot me straje, — na kujtojnë Shqipërinë.

— Ruaji, o shok!...

— Do t'i ruajmë... — foli me gjallëri Fatmiri, duke i dhënë kokës pas e duke nxjerrë paksa gjoksin përpara. Këto fjalë ua drejtoi të gjithëve, jo vetëm atij që m'u lut.

— Ja, si ky stralli jemi ne shqiptarët... Të qëndrojmë kudo ashtu si malet tonë, shokë!...

Të gjithë sa qenë shqiptarë në Mathauzen, e dinin se Asllan Osumi nga Skrapari kishte gurë nga Shqipëria. Për të gjithë unë isha njeriu që kisha thesarë e madh, që donte ta kishte me vete secili.

— Po eshkën, ku e ke marrë, Asllan? — pyesnin.

— Kemi ca ahe lart mbi fshat. Zënë ata eshkë në trup të tyre, një top, një okë.

Ja, eshkë ishte e shkreta, po ishte eshkë Shqipërie. Era e tymit të saj ishte ilaç, ore, ilaç ju them. Nuk ju besohet ndofta, por unë që kam parë me këta sy...

Shkrapitja urorin e ndizja eshkën dhe ja, para syve më vinte fshati im, krahina jonë, cdo vend ku kisha shkelur nëpër këtë vatanin tonë. Më vinte para syve tërë fëmijëria. Ja, më bëhej një natë dimri pranë vatrës. Gjyshja atje, gjyshi në këndin tjetër,

nëna tek lante enët në fund të konakut... Biseda, përralla, kallëzime të vërteta me komitë... Vërret njëra nga të pesë dhitë në të ndarën me gardh në fund të konakut. «Po pjell Bala!» thërret ime motër, e madhja. Të gjithë çohemi të gjallë.

Shkrapit urorin dhe kujtoj atë çikë selishte përpara shtëpisë... Kujtoj malin, kur veja për dru, për lakra në behar, se na sozej buka, për bar e gjeth për atë pak gjë të gjallë që kishim.

Shkrapitja mbi këta gurë dhe në veshët e mi oshëtinin Uji i Furtunave, Pérroi i Pataques, i Zharrë-zës... Humbja në këngë zogjsh të vendit tim. Nuk e besoni, po larg Atdheut edhe kënga e shpesëve të vendit të huaj të duket se nuk është aq e ëmbël, sa ajo e shpesëve të vatanit, ku të ka rënë koka e i ke dëgjuar për herë të parë. Shkrapitja dhe ja, më dilte përpara Myzeqeja...

Këto që ndodhnin tek unë, shkaku i këtyre gurreve, unë e dija, ndodhnin te të gjithë.

Fatmiri, tek më shihte, më thërriste: «Strall, ç'kemi?» Me nismën e tij ne krijuam edhe atje organizatën tonë bazë të Partisë. Strall ma kishte ngjitur ai emrin. «Komisar, — i thosha unë, — filanin nuk e kemi mirë. Ka të ftohtë...». Ma donte shpirti t'i thërritja komisar, se i tillë qe për ne atje. Por ca më shumë edhe pse, duke i thirrur ashtu, më dukej sikur isha në kompaninë, në batalionin tim. Jetoja me marshimet tona partizane... Harroja fare e më bëhej tek isha rrëth zjarreve tona partizane, rrëth vatrave të fshatarëve që na strehonin, rrëth sofrave të tyre, tek përtypnim misërniket me gjizë e qepë me aq uri, si të hanim bukë e mjaltë. Ah, sikur të kishim edhe atje një copëz misërnike e një kokërr qepë, makar në dy javë një herë!» «Strall, — më

thoshte komisari, — i ke gurët?» «I kam». «Mirë... Dëgjo, Asllan...». Këta gurë kishin një forcë mbi çdo forcë. Në ta shihnim Atdheun, për të cilin njeriu derdh gjakun, jep të ritë e tij, tërë gjëzimet dhe shkon prapëseprapë i gjuar, i lumtur. Hë, meqë ra fjala, sado të keqe që e kishim jetën dje, patëm edhe gjëzime, këngë, gosti, dasma... Dhe të gjithëve sa qemë në atë të nëmur Mathauzen, sa merrnim këta gurë në dorë, na kujtoheshin këngët tona. Papo, sado që ishim tretur e terur sa na shquhej edhe uji në gurmaz, kur e pinim, prapëseprapë ia thoshim: O malet e Shqipërisë...

Çuditeshin nemcat me ne! Pashë me sy si tretejjeta e njeriut pak e nga pak nga uria, nga puna, nga rraskapitja, nga plagë e goditje, që bënин të derdhej curril ai cikë gjak i mbetur në trup, por «oh!» nga gojë shqiptari nuk dëgjoi nazisti gjerman. «Strall e shkëmb si malet tona të qëndrojmë», na thoshte Fatmiri, e strall e gur qëndroi secili edhe përpara plumbave, edhe përpara furrave ku na digjin të gjallë. Mblidhnin këmishët shuk dhe e zinin shokët gjakun, por kurrë nuk u dhanë. Çmendeshin esesët tek shihnin të tillë qëndresë dhe bënin mbi ne si bën bisha me prenë e saj ndër thonj. Donin të dëgjonin një «oh» nga ne, një rënkim, një ulërimë... por jo! A rënkon Tomori?! Kjo i bënte më bisha se bishat.

Ishim njëherë nja tridhjetë prej nesh. Qe mesditë e apo kishim ngrënë atë cikë drekë që na jepnin. Punonim për të hapur llogore mbrojtjeje për qytetin. Thellë-thellë dëgjoheshin gjëmime të mybytura topash të rëndë. Kishim mbledhur ca bishtra cigaresh.

— Strall, — më thotë komisari, — nxirre!

Nxora shakulloren. I ndezëm «cigaret», mpleksur më letër gazete. Një eses, komandant ishte ai, na paskesh parë që larg e u nis nga ne. Sytë tek unë. E hetoi Fatmiri qëllimin e tij dhe më tha i alarmuar:

— Fshihe!

E kuptova. Ishte puna për gurët e urorin. Ku ta fshihja? E hodha shakulloren, me qëllim që ta merrja më pas. Esesi gjithnjë sytë tek unë dhe ma bëri me gisht:

— Pst! Pst!

U veçova nga shokët dhe iu afrova.

Zuri të bënte me duar, sikur shkrapiste me uror. U shtira sikur nuk dija gjë, sikur s'kuptoja asgjë. U bë bishë. Më kontrolloi, nuk la vend. Thirri ca ushtarë dhe na kontrolluan të gjithë. E merrni me mend që shkelmat e kamxhikët vlonin mbi ne, ku të na zinin. Si nuk na gjetën gjë në trup, i urdhëroi ushtarët të kërkonin përtokë. Ai e kishte parë mirë shakulloren dhe, duke ua treguar me fjalë e me duar formën e saj, i vuri radhë. Edhe vetë kërkonte. Me bisht të syrit pashë vendin ku e kisha hedhur. Nuk ishte atje. Ç't'ju them?! Vdekje m'u duk ai çast! Dijeni, shokë, se, larg Atdheut, dhemb edhe një kujtim, një shenjëz, një gurth i tij... Pashë se vajti oficeri eses te vendi ku pata hedhur shakulloren e nuk gjeti gjë. «Mos është më tej?», pyeta veten dhe aq u turbullova, sa m'u errën sytë, harrova veten dhe nuk e kisha të qartë vendin ku e kisha hedhur. Por fashistët kërkuan më tej e më tëhu, dhe përsëri nuk gjetën gjë. Nga ky shkak komandanti eses na mori e na vuri të punonim në një vend ku qe balta gjer në gju. Punuam atje plot dy javë. Dy shokë na vdiqën sa kohë qemë në atë batak.

I thashë komisarit ngadalë, duke ecur:

— Ikën gurët!

Po na shpinte esesi te bataku.

— Pse?! I marrim nesër, ose në darkë... Këta
nuk gjetën gjë!

— Nuk qenë atje ku i hodha!

— Kush i mori? Dheu i përpiu?!

Ngrita supet. Ai u bë vrer. E morën vesh të gji-
thë se gurët e Atdheut tonë qenë zhdukur pa nam
e nishan.

Natën, tek kishim rënë të flinim, — ajo natë
qe si natë zie pér ne, — ndjeva në fillim një zhurmë
shumë të lehtë afér meje, pastaj frymëmarrjen e
një njeriu: «Kushedi kush është i sëmurë rëndë e
vjen ndonjë shok i tij pér ndihmë», mendova. Hapa
sytë në terr. Asgjë s'dalloja dot, po frymëmarrjen e
shpeshtë e ndjeva në fytyrë. Dhe ja, dy duar zgjaten
përpara, kërkonin në terrin e dëndur siç kërkon i
verbri rrugën.

— Kush je ti?

— Dua xhaxhi Asllanin.

«Katerina!?!... Katerina!?!... Jo!... Jo! S'është
e mundur! Po të jetë ajo, kushedi q'e ka gjetur
Anën!... Po si do të vinte Katerina natën?!..
Rojat...»

— C'e do xhaxhi Asllanin?! — e pyeta.

— È dua. Ku është?

— Unë jam.

Pëshpëritjet i dëgjova, po gjë s'shihja me sy.
Zgjata duart ashtu siç isha, ndenjur mbi dyshekun
me gjethe e bar. Duart e vogla të Katerinës u shtri-
në drejt meje dhe më lëshoi në duar shakulloren.
Sytë e saj, si dukej, qenë mësuar me errësirën. Si
t'jua tregoj gëzimin që ndjeva! Ia putha duart Ka-
terinës e, pse ta fsheh, burrë isha, shokë më qenë
vrarë ndër duar, shokë varrosa edhe në Mathauzen,

por lot derdha vetëm në duart e Katerinës, që ia laga si të isha fëmijë.

— Po iki, po iki, se më pret mami...

Mezi u shqit Katerina nga duart e mia, se nuk dija ç'bëja, harrova me ç'rrezik jete kishte ardhur ajo e sa rrezik kishte kthimi i saj. E shtypja shakulloren me gishta, ja kështu, e kontrolloja nga jashtë, ishin gurët brenda?...

Katerina qe ndodhur atje pranë nesh, kur unë flaka shakulloren. Ajo e kishte rrëmbyer e ia kishte dhënë vrapit nëpër shkurre. Dhe me të në duar sakaq qe gjendur tek eëma. Edhe për të ata gurë ishin çmallja me vatanin. Natën, Ana nëpër një të çarë të barakës sonë, që ia kishte vënë veshin që ditën, kishte futur të bijën, kur rojat qenë në kohë ndërrrese, e vetë kishte ruajtur jashtë. Unë shtrëngova në dorë gurët, por ama zemra po më luftonte, kisha frikë mos diktonin Katerinën. Sekonda më dukej orë. Prita... prita mos dëgjohej ndonjë e shtë-në... Pas pak u qetësova. E dija sa larg ishte baraka e Anës nga jona.

Të nesërmen oficeri nazist na e kërkoi përsëri shakulloren. Kushedi ç'kujtonte se qe ajo. Ne shtreshim si të habitur, sikur as dinim, as kuptonim gjë. Po këto kërkesa nuk bëheshin me fjalë e shenja vetëm, por me tortura, duke mos na dhënë edhe racionin e ushqimit, të atij ushqimi të zi!

...Kur vdiq Fatmiri (eh, sa shokë na mbetën atje!), iu gjenda pranë.

«Llane, më tha, po të mbushja një herë këto mushkëri me ajrin e Shqipërisë, do të shërohesha!... Vetëm një herë t'i mbushja!...». Ai pati marrë plevit të rëndë dhe ca më shumë e mposhtën uria, puna e rëndë... Gjatë gjithë kohës së internimit na ndoqi

era e thartë e djersës, e trupave të palarë prej vitesh, e pisllëkut... «Llane, më zër një fill eshke e ma afro te hundët». Këputa një copëz, e ndeza dhe bëra si më tha. Filloi të thëthinte me gjithë mushkëritë. «Tani u shërova... jam në malet e Shqipërisë... Ja, po eci kaluar në shpinë të tyre, po fluturoj mbi to... Strall, po dëgjoj fyejt si bien... po eci në marshime partizane, dëgjoj këngët tona «Malet me blerim mbuluar», «Në sulm, në sulm Brigadë Parë»...». Nuk më tha kurrë, gjer në frymën e fundit se «po vdiste», veç kur m'u fik fare përpara duarve, atëherë pëshpëriti: «Asllan, një gur... një gur...». Me siguri donte të më thoshte që një gur të maleve tona t'ia vija nën krye, në varr, se ashtu do të mos i rëndonte dheu i zi i njerëzve të urryer. Dhe unë e bëra këtë...

As unë, as drejtori i muzeut nuk e ndërprenë Asllan Osumin në tregimin e tij, veç kur pushoi vetë. Atëherë na pa të dy dhe tha:

— Nuk besoj se ju lodha kot!

E kundërshtuam të dy në një gojë.

Llania e mori përsëri fjalën:

— Këto që ju tregova juve, ia tregova edhe nipi e ai më tha:

«Baba, këta gurë kanë vlerë të madhe për muzeun!»

«Kanë, iu përgjigja, kanë, po për mua që u di historinë, që di sa na kanë vlejtur, që di... Kurse atje, në muze, ku do të ruhen, do të shënohet në një copë letër vetëm kaq: «Gurët dhe urori që kanë pasur me vete disa të internuar në Mathauzen».

— Nuk është ashtu! — tha Besniku.

Ai, pa e parë as unë, as Asllani, kishte kurdisur mangetofonin dhe veç kur dëgjuam zërin e Asllanit.

— Qysh këtë javë... — vazhdoi Besniku, — të

gjithë do të dëgjojnë historinë e gurëve të strallit,
do të mësojnë atë që dëshiron ti, xha Asllan...

Asllani e mblohdhi me të dyja duart shakulloren
që ishte mbi tryezën e drejtorit, sikur atë çast po ia
dorëzonte e foli me gjithë shpirt:

— Merri, merri, bir!

Tha kështu dhe, me dorakun e shkopit që mba-
hej, goditi disa herë kryet e vet. Me siguri ai qor-
tonte veten atë kohë: «Hej, kokë, kokë! Po të kisha
vdekur papritur, atyre gurëve kush do t'ua dinte
vlerën, pa u ditur historinë!?».

U shikuam sy më sy me drejtorin e muzeut e
buzëqeshëm.

RRUGA QË NA BASHKOI

... Ishte fundi i nëntorit 1943. Ndodheshim në katundin Zhulaj të Skraparit. Qe një ditë me diell. Po rrinim me ca të rinj të fshatit rrëzë një muri, ku s'na hante era e po bënim një bisedë të lirë. Erdhi një shok e më tha:

— Çohu, Muzafer, se na kanë ardhur partizanë të rinj.

— Cilët?

— Akoma nuk e keni marrë vesh? Ka ardhur grupi i dytë partizan i qarkut. Janë pesëqind — gjashqind shokë e shoqe.

U gëzova, se ishte një forcë e rëndësishme dhe ne do të luftonim me radhë më të shumuara. Bashkë me partizanin që na pruri lajmin, shkova të takoja shokët e porsaardhur. Ata në fillim qenë grumbulluar te çezma në mes të fshatit. Pastaj Këshilli Nacionalçlirimtar i kishte shpërndarë nëpër baza. Kështu, në çdo shtëpi, veç pesë apo gjashtë nga shokët

tanë, patën vajtur edhe tetë, nëntë apo më shumë partizanë të tjerë. Kishin mbetur edhe dhjetë partizanë, midis tyre dy shoqe: Leni dhe një tjetër. Këto të dyja dhe tetë partizanët e tjerë i caktuan në familjen ku isha unë me shokët e mi.

Ky qe rasti që u njohëm për herë të parë me Lenin. Ishte një vajzë fjalëpakkë. Kur fliste, e vështroja i heshtur, me një farë përhirimi. Unë e bëja këtë krejt pa dashje, po një ditë njëri nga shokët, Petriti, të cilit i kishte rënë në sy, ma hodhi fjalën larg e larg. E kundërshtova i nxehur, po ai më habiti, duke më thënë: «edhe ajo, kur s'e vështron ti, çoc t'i hedh sytë». Nuk ia ushqeva fjalën dhe u mundova ta bëja të kuptonte se kurrë nuk duhej të më fliste më në atë mënyrë. Por në të vërtetë, kur më tha «Çoc t'i hedh sytë», diç ndjeva në zemër. S'di përsë, si me vjedhuri, fillova të mundohesha të zbulloja në m'i hidhte vërtet sytë apo jo. Ajo që kishte vënë re shoku, ishte e vërtetë. Pak nga pak, vështrimi i saj po ngridhte brenda meje një ndjenjë të fshehtë, që edhe vetes nuk po guxoja t'ia pohoja. Atë kohë i kishim vënë vetes tjetër qëllim, prandaj e quaja marrëzi t'u hapja rrugë ndjenjave të tillë.

Në zonën ku qemë përqendruar ishte një si punë feudali i vogël, Baze Potka, një shtëpi kriminelësh brez pas brezi, që, në çdo situatë politike që qe krijuar në Shqipëri qysh nga koha e Turqisë, nuk kishte bërë gjë tjetër, veçse thikën prapa krahëve i kishte futur popullit. Edhe tani, me pushtimin e Shqipërisë nga fashizmi, qe bërë strofulla e kriminelëve ordinerë, e kusarëve që kishin rrjepur popullin në qafa e gryka. Domosdo, kjo shtëpi ishte bashkuar me «Ballin Kombëtar». Pikërisht ato ditë patëm marrë një informatë, se në fshatin e Baze Pot-

kës e në dy fshatrat ku ai kishte influencë, qenë diktuar lëvizje të shumta pushtuesish e ballistësh, të cilët përgatiteshin të na goditnin në befasi. Komanda jonë partizane mori vendim që forcat fashiste e reaktionare duhej t'i rrëthonim natën dhe, me të aguar, të niste sulmi. U dhanë udhëzimet, u bënë të gjitha përgatitjet dhe në fund skuadrat e kompanitë po niseshin sipas drejtimeve e pozicioneve të caktura që do të zinin. Leni gjithë ditën kishte qenë e sëmurë. Dukej që kishte temperaturë të lartë, se i skuqnin faqet. «Kjo s'duhet të vijë», përsëritja me vete dhe i vija rrëth si pér ta mbajtur. Doja t'i thosha «Ti, Leni, rri!...», po prapë s'guxoja. «Ku të vijë kjo?!», përsëritja me vete e lutesha të gjendej një tjetër t'i thoshte të rrinte. Po si dukej, të tjerët i kishin thënë dhe ajo ua kishte prerë shkurt se nuk do të rrinte pa marrë pjesë në aksion. Më në fund, mendova: «Ç'të fshehta ka midis nesh që unë të druhem?» M'u kujtuan ato fjalët e Petritit që s'i pati përsëritur më. Po kisha vënë re se, sapo sytë e mi shkëputeshin nga Leni, ai bënte buzën në gaz ashtu si kot. Dukej qartë që më thosh: «Eh, kot mundo-hesh! Ç'ma fsheh?!» Po të tjerëve a do t'u ketë rënë gjë në sy? pyesja veten e zemërohesha aty pér aty: Ç'ka këtu pér t'u rënë në sy, kur unë nuk kam asgjë me të?! Me këtë zemëratë me veten i thashë Lenit pa e vështruar e duke bërë sikur lidhja opingat: «Ti, Leni, rri!... Je e sëmurë». U mundova që të isha sa më i natyrshëm, por më duket se tamam zëri më tradhtoi. Ndryshe, ai Petriti s'kishte përsë të buzë-qeshte përsëri me nénkuptim.

Leni nuk u nda. Erdhi në aksion dhe, a se rastisi, a se ashtu na i caktoi pozicionet komandanti i kompanisë, unë nuk e di, por prapë ne u ndodhëm ba-

shkë, bri shoshoqit. Nga meraku që kisha për të, ngaqë ishte e sëmurë, bëja ç'bëja dhe shkoja i rrjia afër. «Nuk duhej të vije, Leni, — i thashë. — E pe si të qortoi komisari!» Ajo nuk m'u përgjigj, edhe kësaj radhe vetëm më shikoi gjatë e me ngulm. M'u duk sikur më pyeste: «Po ti, pse tregon kaq kujdes për mua?! Kur jemi duke ngrënë, ruan a u nginja sado pak. Kur flemë, heton a kam vend të mirë se mos ngrij natën. Tek më sheh veshur keq, dukesh sikur dhimbsurohesh». Vështrimi i saj i gjatë e pyetës, ashtu si e kuptova unë, më detyroi të ktheja kryet e t'i hidhja sytë në faqen e malit që kishim përkundrejt. Tamam atë çast, si për të më falënderuar për kujdesjet e heshtura e të druajtura, ajo më tha: «Muzafer, pas aksionit më jep të ta laj pak këmishën. Ma jep vetë, mos prit të ta kërkoj unë». Fjalët e fundit m'u duk sikur i tha me ton të ndryshuar, me zë disi më të ulët. Mua më rrahu ndryshe zemra e fillova të bluaja lloj-lloj mendimesh: «Mos edhe kjo? ... Ç'dreqin po ndodh kështu?...» «Leni, — i thashë, — hap sytë në këtë aksion, se te forcat e Baze Potkës janë nja pesëmbëdhjetë kriminelë. Një çikë të zbulohesh, ta qepin plumbin si me dorë. Kanë vite me radhë që s'kanë bërë zanat tjetër, veçse kanë vrarë njerëz. Njëri syresh ka deklaruar vetë, se nga viti 1924 gjer më 1941 ka vrarë tridhjetë e pesë njerëz në prita, i paguar nga njëri e nga tjetri». «Pse e mësova që ka të tillë kriminelë të popullit, prandaj edhe erdha në këtë aksion!» — ma ktheu Leni me shpirtin e mbushur plot urejtje.

Sapo zbardhi pak dita, u dha shenja e sulmit dhe forcat tona filluan të lëviznin. Armiku (o pse kishte dijeni, o pse vetë Baze Potka nuk flinte kurrë pa dy palë roja) na ndjeu dhe që me pushkët e para

shpërtheu një zjarr i fuqishëm nga të dyja palët. Por pas tri orësh luftimi të rreptë armiku u detyrua t'i linte pozicionet e para. Fshatrat përreth u çliruan nga forcat tonë, dhe pushtues e mercenarë u ngjeshën të gjithë rrëth fshatit të Bazes, ku nuk ishte e mundur të çaje. U luftua atë ditë gjersa u err. Gjithë natën vazhdoi rrëthimi. Aty nga ora nëntë-dhjetë nata zuri të ftohej edhe më shumë. Lenit i hynë të dridhura, por nuk e jepte veten. Ajo nuk qe mësuar me klimën e fortë të maleve tonë. Dëborën vetëm sa e kishte parë me sy nga larg mbi Tomor, kurse tanë ajo i pudroste supet. Hoqa kapotën time të vjetër e ia dhashë, por ajo mezi e pranoi. Për vete hodha krahëve një copë mushama, nga ato të çadraive ushtarake. Leni hoqi shallin e saj e më tha: «Merre këtë të mbrosh kraharonin, të paktën». Unë nuk desha. Ajo ia dha Petritit, po as ai nuk ia mori. Kur të ftohtët u bë akoma më i fortë e bashkë me borën filloj edhe të frynte, Lenin dhe disa nga shokët i detyruam të shkonin për t'u ngrohur në shtëpinë më të afërt të fshatit të çliruar atë ditë. Të nesërmen, me shfarosjen e strofullës së Baze Potkës e të kriminelëve, morën fund njëherë e mirë bazat e pushtuesve e të reaksionit në tërë krahinën e Skraparit. Populli kërkoi t'u viheshin minat nga themellet shtëpive të Bazes, të mos mbetej gur mbi gur. Dhe ashtu u bë.

* * *

...Lufta na ndau përsëri. Megjithatë Leni nuk m'u hoq nga mendja. U takova me të dy muaj e ca më vonë, pasi kishte marrë fund Operacioni armik i Dimrit.

Kur u takuam, ishte 17 marsi i vitit 1944, dita e inaugurimit të Brigadës së 7-të Sulmuese. Sa arri-
ta në Vëlushë, vija rrëth, si duke kërkuar diçka.
Megjithëse s'doja ta besoja as vetë, megjithëse s'doja
t'ia thosha as vetes, prapëseprapë vija rrëth ashtu
si i hutuar, se kërkoja atë, Lenin. Gjeja një shkak
e hyja në një bazë. Bëja sikur kërkoja dikë e pyesja
në një shtëpi tjetër kush ishte brenda. «Mos është
vrarë!» pyesja me vete, duke më sëmbuar në ze-
mër një dhembje e rëndë dhe një si mall. Të nesër-
men, pas një gjumi plotë ndrra dhe plot tri orë para
se të fillonte ceremonia e inaugurimit, hasëm befas
ballë pér ballë. Duke qenë si të hutuar të dy, duke
çarë me bërryla përmes grumbullit të partizanëve e
të popullit, gati sa s'u përpinqëm kokë më kokë.

— Leni!

— Muzafer!

— Ku je?! Ku je??

Unë nuk po ia lëshoja dorën dhe ajo dukej si-
kur vazhdonte të më ankohej: «Po ku ishe!? Ku
ishe, xhanëm!? Sa më ke lodhur!»

Më në fund, më tha me zë:

— Kemi kaluar çaste shumë të vështira gjatë
këtij dimri dhe nganjëherë kam besuar se nuk do
të të takoja më.

«Paska menduar pér mua!» fola me vete i nga-
zellyer. Po zemra aq sa m'u gëzua, aq e humbi edhe
guximin t'i thosha diçka. Nuk e di si i nxora këto
fjalë:

— Edhe ne hoqëm keq, po ty të kam pasur
gjithmonë ndër mend.

Leni ishte dobësuar shumë. Ajo gati kishte mbe-
tur një dorë eshtra. Megjithatë më dukej sikur kisha
para syve një Leni që më thoshte: «Pas kësaj prove
s'ka forcë të më mposhtë...».

Në një çast më pa drejt në fytyrë e mua m'u dukën aq të qeshur ata sy, aq të ngrohtë, aq qetë-sues... Ù hutova krejt. Turbull dëgjova zérin e saj:

— E di që jemi në një batalion?!... E di, apo jo?!...

I përmendur nga një marramendth i fortë, iu përgjigja pa u munduar ta fshihja gëzimin:

— Jo. Nuk e di!

— Po, po. Ti komisar i kompanisë së parë të batalionit të tretë dhe unë përgjegjëse e rinisë në kompaninë tënde.

Çamë bashkë përmes popullit e partizanëve përtë takuar shokë e shoqe të tjera.

Njëherë dikush e thirri Lenin me një emër të ri: *Systralle*. Për këtë u bë shkak xha Kasemi. Një ditë, pas një mësymjeje me fitore të kompanisë sonë, ndërsa po rrnim nën hijen e një kumbulle, xha Kasemi e pa gjatë Lenin dhe ia krisi këngës, pa ia ndarë vështrimin:

*Sytë e tu me çika stralli,
Leni, moj, na mori malli!...
Leni, moj, syrin me çika,
tedeskët i zuri frika!*

Ndodhi që atë ditë Leni u plagos lehtë. Xha Kasemi e pruri më krah pas sulmit. Tek e pashë, i dola përpara t'ia merrja, po ai nuk më la:

— Lema, — tha, — mos më hiq nga supet.

Leni më buzëqeshi.

— I thashë djallit, — vazhdoi xha Kasemi si

duke u fjalosur me vete e me ton zemërimi, — i thashë: Mos, mos, moj bijë, se do të të hedhin ndonjë bombë! S'më dëgjoi. Atë qenin, mitraljerin fashist, e ngordhi, por ç'e do!...

Leni i lutej ta linte të ecte vetë dhe mua më vështron te si fajtore e më thoshte, kohë më kohë, për të më qetësuar:

— Nuk kam plagë të rëndë. Xha Kasemi e bën të madhe kot.

Pastaj i kthehej xha Kasemit për ta ngacmuar:

— Vetë ma ndolle, xha Kasem. Më ngrite këngën pa u vrarë...

— Mbylle, mbylle, de! — e kërcënoi e iu lut në të njëjtën kohë xha Kasemi, me tërë forcën e zërit e të dhembjes së shpirtit, sepse iu duk sikur me të vërtetë ia kishte ndjellë vrasjen. Djersët i shkonin çurg në atë vapë maji e në atë zagushinë e madhe përmes shkurreve nga po çanim. S'e bëra të gjatë, po ia rrëmbeva Lenin nga shpatullat dhe e hodha vetë në shpinë, gjersa dolëm jashtë rrëzikut.

Kaloi prapë ca kohë, po megjithatë, as unë e as Leni nuk i kishim thënë shoshoqit se duheshim. Ngurroja t'i hapesha, sepse mendoja: «Ende kohë lufte... Po sikur të vritem?... Ta çlirojmë Atdheun njëherë... Të fitojmë lirinë...» Si unë mendonte edhe Leni, gjë që ma tha më vonë. Po kishte edhe raste që më mbushej mendja top t'ia thosha, ta dinte, t'i dinte të gjitha dhe pastaj, me çirimini...

...Ishim duke ngjitur të përpjetën e Pirogoshit vetëm të dy me Lenin. Kompania vinte pas. Kur

arritëm pothuaj në gjysmë të së përpjetës, ajo bëri një gjysmë rrotullimi, qëndroi në vend, me njérën dorë në ije dhe më pyeti, duke u mbushur me zor me frymë nga lodhja:

— Ç'po mendon?

— Asgjë, — iu përgjigja duke mbajtur këmbët e paksa si i habitur që ma bëri atë pyetje.

— Asgjë, asgjë, asgjë?! — më pyeti ajo përsëri me një zë të ëmbël, dyshues, po më shumë ngacmues.

«Mos, — thashë me vete, por, si t'i drejtohesha asaj me një ton sa të prerë aq edhe me drithërima zemre, — mos luaj me zjarrin!...» Dhe nuk di as vetë si u përbajta përpëra atyre syve «me çika stralli», që sa vinte e më shumë më ngacmonin. Ula kryet e u kroda në mendime... Aty për aty vendosa njëherë e mirë që atë ditë duhej të zbulojat ç'kishte ajo në zemrën e saj, ç'ruanter përmua, dashurinë, si unë për atë, apo vetëm miqësinë, miqësinë tonë të madhe partizane?

— Asgjë, — i përsërita duke ngritur kryet e duke i buzëqeshur, por me një ton që fliste qartë se nuk po i thosha të vërtetën.

— Asgjë, asgjë?! — tha ajo përsëri, po këtë radhë si duke buzëqeshur edhe më me shejtanllék, me një mimikë tepër ngacmuese.

— Asgjë pra! — përsërita edhe i druajtur, edhe i turpëruar.

— Nuk më besohet!

Tha kështu, më ktheu shpinën e vazhdoi të printe drejt së përpjetës. Pas saj edhe unë. Po ecnim në heshtje, si pak më parë. Mua më dukej sikur ajo ecte dhe buzëqeshët me vete. «Duhet t'ia zbulojat të fshehtën, — thashë me vendosmëri edhe

më të madhe. — Duhet... Duhet... Duhet...» e, sikur të më vinte ky zë nga larg, si i dikujt tjetër, mora guximin dhe e pyeta:

— Po ti, ç'po mendoje?

Në tonin tim fshihej ngacmim, fshihej «djallëzi».

Ajo ndali, u kthyte nga unë përgjysmë dhe m'u përgjigj:

— Asgjë s'po mendoja.

— Edhe mua sikur nuk më besohet, — ia prita.

Ajo vetëm puliti qepallat, sikur do të mbronte sytë nga një pluhur që s'dukej kurrkund.

— Prandaj, — vazhdova, — thuama ti, Leni, të vërtetën, ç'po mendoje, të ta them edhe unë pastaj.

— Jo! Thuama ti më parë.

— E di ç'bëjmë? — i propozova. — Ç'mendoja unë, do të ta shkruaj në një letër. Ç'mendoje edhe ti, shkruaje në një letër. Pastaj i lëmë mbi një gur. Ti merr timen e unë tënden.

Në këtë mënyrë ramë në ujdi, i kthyem shpinën shshoqit dhe shkruam.

Mirëpo unë doja ta rrëmbeja letrën e saj, pa i rënë në dorë imja, sepse aty i thosha: «Të dua fort... dhe èndërroj të të marr nuse!» Po sikur ajo të kishte shkruar diçka pa kuptim? Nuk doja që të më zbulonte «sekretin».

— Hë, lëre letrën këtu te ky gur, — e nxita duke i treguar me dorë.

Ndërkohë ajo gjeti rastin, ma rrëmbeu nga do-ra letrën që e kisha palosur më katersh, dhe e lexoi shpejt e shpejt.

Pastaj, në çast, fytyra e saj e skuqur sikur mori një dritë të re... U ulëm pranë e pranë. Shpatullat i kishim mbështetur të dy nas një guri. Bustina i qe

varur paksa mbi vetulla, flokët mbledhur pas e lidhur me një rrip si bisht kali.

— Kjo do të ndodhte, — tha ajo papritur me një ton serioz, por plot përzemërsi, ngrohtësi e ledhati. — S'kishte si të ndodhët ndryshe. — Dhe, pa pritur të flisja unë, vazhdoi si t'i kishte lexuar mendimet e mia: — A bëmë mirë? Mos u nxituam? Mos duhej të pritnim sa të mbaronte lufta?... Për këto... — ajo ngriti supet e u krodh në mendime.

Unë po vazhdoja të heshtja, duke i vështruar sytë me përhirim. Sytë e saj «me çika stralli», që ma ndezën zjarrin e zemrës për të mos u shuar kurë, më ftonin të gëzoja, ta ndieja veten si me krahë, të lumtur.

...Pas çlirimit të Beratit e pastaj të Tiranës, luftuam bashkë me Lenin gjer në malet e Vishegradit. E ku s'luftuam!... Arritëm në Maqedoni dhe u kthyem përsëri në Atdhe.

Me t'u kthyer, kishim bërë fjalë me Lenin që të martoheshim e të krijonim familjen. «Kam dëshirë, — më thoshte, — të bëjmë një çupë e një djalë. Çupën dua ta kem të parën dhe t'i rritim mirë, t'i edukojmë mirë... Kështu, Muzo?» «Kështu, Lenka», i përgjigjesha.

Një javë pasi arritëm në Tiranë, Leni u sëmur rëndë. Që kur ishim në Jugosllavi, në malet e Vishegradit, ajo kishte marrë një plevit të fortë dhe këtu iu përsërit prapë. U shtrua në spital. Atje lëngoi një muaj e gjysmë. Veja përditë e shikoja. I jepja kurajë. Po trupi i saj i lodhur, i rraskapur, mezi i bënte ballë sëmundjes. Ajo, sa vente e sikur bënte më poshtë.

— Lenka, ti do të shërohesh...

Ajo pohonte duke tundur kokën, që s'e kishte

ngritur nga jastëku që ditën që kishte zënë shtratin e që dukej sikur do t'i këpütej në çast nga trupi, aq shumë i qe holluar qafa.

— Lenka! Ne do të martohemi...

Ajo tundte kokën përsëri.

— Lenka, ne do të bëjmë çupa, djem...

Unë ia thosha këto pér t'i dhënë kurajë dhe ajo më aprovonte pér të përkëdhelur ëndrrat e mia, të cilat nuk donte t'i lëndonte asnje fije, edhe pse e shihte sa rëndë ishte.

Një pasdite e gjeta shumë rëndë. Mendjen e kishte ende, po gojë jo. Orë e çast i binte me dorë çantës partizane, që e mbante pranë e diç donte të më thoshte. I bëja shenja të mos kishte merak se do t'ia ruaja. Por ajo prapë vuante, se e shihte që unë nuk po e kuptoja ç'donte të më thoshte. Më në fund e kuptova. E hapa çantën. Në një xhep të fshehtë të saj Leni kishte ruajtur ato dy copa letrash që patëm shkruar në krye të së përpjetës së Pirogoshit. Në letrën e saj ajo kishte shkruar: «Unë po mendoja pëty, Muzo. Të dua sinqerisht.»

* * *

Këtë histori të vetën Muzafer Prosekun ka treguar që në ato vitet e para të Çlirimt, e pikërisht në kohën kur ai po martohej me Lenin.

Ai ishte shumë i gëzuar në ato ditë dhe i dukej sikur po bënte veç shokëve. Kjo ndjenjë e mundonte, prandaj edhe donte të gjente rastin t'ia hapte zemrën dikujt e t'i tregonte se me Lenin «kishte hequr halle, shumë halle». Siç duket, më gjeti mua pér t'u rrëfyer. Atëherë, kur e dëgjova pér herë të parë,

më bëri përshtypje tregimi i tij dhe m'u ngulit thellë në mendje. Kurse më pas, sa herë më kujtohej, thosha me vete gjithnjë e më shpesh: Sa mirë bëri që ma kallëzoi! Gjersa një ditë vendosa ta shkruaja këtë dashuri të kohës së Luftës.

D J A L Ë G U R I

2 | Mëngjes herët. Jashtë binte borë. Gjithë natën ajo kishte rënë më e dendur. Tani jepte shenja sikur do të pushonte, po megjithatë atmosfera ishte ende aq shumë e rënduar me ré, saqë njëzet apo tridhjetë metra më tej syve asgjë nuk dallohej.

— Ç'ka ndër mend të bëjë? — pyeti komandanti i grupit partizan të qarkut, duke shtyrë urët e zjarrit, që kishin qëndruar ndezur gjithë natën, sepse shtabi i grupit pothuaj e kishte gdhirë atë natë pa gjumë. Ai e kishte fjalën për armikun.

Komisari, që ishte ulur në këndin tjeter, përkundrejt komandantit, megjithëse pyetja nuk i qe drejtuar vetëm atij, u përgjigj, duke vështruar sa nga komandanti, nga shokët e tjerë të ulur kush pranë zjarrit, kush me shpatullat pas murit:

— Kjo është e qartë, shokë. Gjermanët këtë radhë duan të na rrethojnë dhe pastaj të na asgjësojnë.

Kur pa se asnë nuk po fliste dhe secili po mendonte sa me vend ishin gjykimet e tij për gjen-djen e krijuar, kur armiku nuk luftonte vetëm për ta pasur ai iniciativën, komisari e mori përsëri fjalën dhe tha:

— Nuk dimë q'është bërë mbrëmë e gjatë natës në Qafën e Dardhës. Po qe se batalioni i parë i rinisë atje është detyruar të zmbrapset, ose është në atë rrugë, atëherë situata jonë do të jetë edhe më e rëndë dhe duhet menduar.

— Të shohim, sot duhet ta kemi një lajm që andej medoemos.

Ky që foli ishte nënkomandanti i grupit.

Xha Ademi, i zoti i shtëpisë, hyri në këtë kohë me një tavë me pëershesh me trahana.

— Urdhëroni, shokë, — i ftoi ai, — urdhëroni merrni dy kafshata mëngjes.

Kur shokët e shtabit të grupit sapo kishin mbaruar së ngrëni, xha Ademi hyri përsëri, por këtë radhë i nxituar.

— Një korrier nga Qarkori i Partisë, shoku komisar.

— Le të hyjë shpejt, — folën të gjithë me një gojë.

Komisari la lugën në tavën e zbrazur, e shtyu atë paksa dhe po vështronët nga dera, duke mos duruar gjersa të mësonte pse kishte ardhur korrieri.

Mori letrën që i dërgonin shokët e Qarkorit dhe e lexoi heshturazi. Pastaj e palosi e, duke e mbajtur në dorë, iu drejtua shokëve:

— Pushtuesit fashistë dhe tradhtarët kanë ndërmarrë një operacion të madh në të gjithë vendin. Gjithandej luftohet, si dhe në qarkun tonë. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçirimitare urdhë-

ron... tē evitohen luftimet frontale pēr ditē me rādhë... tē ruhen forcat e gjalla me çdo kusht... armiku tē goditet anash, prapa... nē befas...

— Gjendja nē tē cilën ndodhemi, éshtë shumë e vështirë pēr ne dhe shumë e favorshme pēr armikun, — foli komandanti i grupit, duke zgjatur dorën nga komisari pa i thënë gjë, por që kuptohej se i kërkonte letrën e Qarkorit pēr ta lexuar vetë.

Kur thoshte kështu, ai kishte parasysh atë që dihej prej tē gjithëve: Grupi nuk kishte asnje munësni manovrimi nga asnje krah, sepse që një e dy ditë më parë kishin grumbulluar informata dhe forcat armike pērparonin edhe nga krahinat e tjera.

Në këto e sipër erdhi korrieri i batalionit tē parë tē rinisë. Ai hyri i nxituar, i dorëzoi një letër komisarit dhe u mbështet me shpatullat pas një sënduku.

— Si éshtë gjendja? — e pyeti komandanti korrierin ndërkohë që komisari po lexonte.

— E rëndë, shoku komandant. Batalioni ynë e la Qafën e Dardhës.

Në çast nē konak u nder heshtja. Komisari hapi me nervozizëm një letër tē dytë, që ishte futur e palosur nē atë që dërgonte shtabi i batalionit tē parë. Shokët hetuan nē fytyrën e tij se letra e dytë përbante diçka me rëndësi dhe po prisnin sa t'i dilte nē fund.

— Qenka vrarë komandanti ballist Isuf Zotoja, — tha komisari. — Atij i paskan gjetur me vete këtë dokument shumë tē rëndësishëm, — tundi nē ajër letrën që mbante nē dorë. — Forcat e armikut që janë hedhur nē sulm kundër forcave tonë tē qarkut janë gjashtë mijë e ca. Tri mijë prej tyre veprojnë nē krahun tonë, këtej nga Tomori, dhe tri mijë tē tjera kanë kaluar nga Kiçoku, pēr t'u dalë forcave

partizane të qarkut tonë në krahë e në shpinë e për të bashkëvepruar me forcat armike të qarkut të Gjirokastërës.

Ata që e dëgjuan, tundën kryet si të thoshin: «Shumë vështirë e paskemi».

— Nuk më tha, — e pyeti komisari korrierin, — di gjë, ku e si u vra Isuf Zotoja?

Isuf Zoton e kishte vrarë vetë korrieri. Ai ishte komandant skuadre. Ishte dhënë urdhri për têrheqjen e batalionit, por Bujari, kështu quhej korrieri, kishte qëndruar i maskuar me gjithë skuadrën, e kishin pritur Isuf Zoton, që u thërriste larove që pati lëshuar përpara: «Në sulm, mustaqeçilët e babait!», gjersa u pati ardhur mu në grykë të pushkëve dhe ia kishin bërë gjoksin shoshë. «Mustaqeçilët» pastaj, ca pësuau fatin e «babait» e ca as vetë nuk e ditën kur e mbajtën frymën.

Bujari ia kallëzoi këto komisarit me têrë hollësitë, i tha për dokumentin që i ishte gjetur me vete Isuf Zotos, por nuk i tha se ishte ai dora që e kishte bërë atë qen të ngordhëte.

Duke dëgjuar Bujarin, komisarit iu duk një ftyrë e njohur ai djalth, po kur, ku e si e kishte njohur nuk po i kujtohej dhe as ishte rasti të vriste mendjen gjatë për këtë gjë, sepse situata e rrëthimit në të cilën ndodhej grupi partizan dhe detyrat që i shtroheshin përpara operacionit të madh armik, kërkonin një zgjidhje shumë të shpejtë e shumë të sigurt. Edhe Bujarit ftyra e komisarit i shembelleu... Por vallë ishte ai? Komisari një javë kishte që kish ardhur me atë detyrë në grupin partizan e as ishin takuar, as emrin nuk ia kishte mësuar. Atë me të cilin i shembellente, e mbante mend djalë sapo shkuar brisk në faqe, me një ftyrë të njomë, flokë të zinj

pis. Kurse komisari ishte thinjur fare në tëmtha. Kishte dy javë e më tepër që nuk qe rruar, që kur kishte nisur mësymja armike; mjekra e thinjur i pati shkuar gati dy gishta e ia mbulonte krejt ftyrën.

— Batalionin e parë të rimisë të vejë ta zëvendësojë i treti, — tha komandanti i grupit, kur u shtrua çështja si duhej të vepronin. — Ata janë pak më të çlodhur, — vazhdoi ai.

Mendimin e tij e miratuan shokët e tjerë të shtabit.

— Kjo është një zgjidhje e drejtë sa për ta gozduar armikun për disa orë... për një ditë, — tha komisari. — Po ne jemi të rrrethuar. Ky shoku na thotë, — dhe ai tregoi me kokë Bujarin, — se me munizione edhe batalioni i parë është shumë ngushtë. Çdo partizan nuk ka më shumë se dy e tre ballë fishekë, siç i kemi tani më se gjysmën e partizanëve. — Ai zuri ballin me dorë. Në kokë ndiente si trokitje të fuqishme direktivën e Shtabit të Përgjithshëm: *Armiku do të na vërë në pozita lufte frontale. Kjo të evitohet me çdo kusht. Ne do ta goditim djathtas, majtas, prapa, ku nuk e pret e kur nuk e pandeh...* Të ruajmë me çdo kusht forcat e gjalla nga ky operacion...

E hoqi dorën nga balli, ngriti kryet, shtriu këmbët e mpira dhe mori përsëri fjalën. «Nga zëri më duket tamam si ai!» mendoi prapë Bujari. Edhe komisari, tek fliste, i mbante sytë nga Bujari, i cili e vështronte sikur ia thëhinte çdo fjalë e mendim dhe i bëhej sikur kishte përpara një nxënës me zell të pashoq e me etje të pashuar.

Treqind-katërqind metra, në vijë të drejtë, nga shtëpia ku ishin shokët e shtabit të grupit partizan, fillonte rrëza e Tomorit.

— Po t'i futemi Tomorit lart, — tha komisari,

— ai është i ngarkuar me dëborë. Vende-vende ajo arrin dhe disa metra. Ja, të pranojmë sikur do të gjendeshin aq shpella, sa të strehoheshin pesë-gjashë qind vetë, sa jemi ne, po për ushqim si do të bëjmë? Armiku me siguri do të informohet e do të na e presë çdo mundësi furnizimi nga fshatrat. Vëtëm një rrugë shpëtimi do të kishte: po të ishte e mundur të kalohej Tomori e t'i dilej armikut në shpinë. Por edhe ta mendosh një gjë të tillë, më duket mua, është njëlloj si të thuash: hajde ta marrim malin në krahë e ta zhvendosim. Apo: hajde ta çajmë malin me shpatë më dysh, si në përrallat.

Komisari fliste me bindje si ta njihte mirë vendlin, e malin e Tomorit në veçanti. Dhe ashtu ishte vërtet. Tomori nuk kishte rrugë kalimi për t'i dalë matanë edhe në verë e jo më në dimër.

— Po të sulmojmë drejtëpërdrejt, do të kemi shumë humbje, — foli komandanti me një ton si të thoshte «kjo rrugë që po them, as që duhet zënë me gjëj,» — po ç'rrugë tjetër të gjejmë?

— Jo vëtëm ajo, — shtoi zëvendëskomisari, — po ne duhet të gjejmë rrugë e mënyra që ta goditim armikun ku e kur nuk e pret dhe ta çoroditim.

— Ajo do të arrihej vëtëm po të kalonim një pjesë, qoftë edhe pesëdhjetë partizanë, prapa Tomorit dhe të goditej armiku nga shpina. Kjo goditje të kombinohej pastaj edhe me mësymjen-tonë të befasishme në vendin më të dobët të forcave të armikut.

Duke folur kështu, komisari edhe pshëretiu për të shfryrë dufin, sepse arritja e asaj që mendonte ai, ishte e pamundur.

Bujari ndoqi i heshtur tërë bisedën dhe kohë më kohë lëvizte në vend si ai nxënësi që do të ngrihet në mësim, por që pret me padurim edhe rastin

e përshtatshëm të ngrejë dorën, që ta shohë më-suesi.

Duke e vështruar, komisari, megjithëse ishte në një hall të madh, se pushtuesit kërkonin kokën e qindra shokëve, nganjëherë gjente edhe kohën të pyeste me vete, ashtu si vetëtimthi e tërë kureshtje: «Po ku e kam parë, xhamëm, këtë djalth?!»

Bujari ishte plot njëzet e një vjeç, me trup mesatar e i thatiqëm. Sytë e tij bojëkafë, në atë fytyrë aq simpatike, shkëlqenin me një dritë të përherëshme. Ai ishte nga fshatrat rrëzë Tomorit, me shpatulla mbështetur pas malit, andaj edhe që në njojjen e parë mund ta përcaktoje nga ç'krahinë ishte. Edhe nga shtëpia e tij rrëza e Tomorit nuk ishte më lart se tre-katërqind metra në vijë të drejtë. Kushe-di sa herë ishte ngjitur ai malit përpjetë, që në fëmijëri të tij, duke kullotur bagëtinë, për të bërë dru, për të gjetur pishë për dritë, për të nxjerrë ndonjë tra apo mahi, kur i qe thyer e qe në rrezik t'i shem-bej çatia e shtëpisë. Ai e njihte malin, siç njeh njeriu çdo skutë e brimë të shtëpisë së vet. Por gjer afër mesit, se në mes e lart ishte i pashkelshëm. Kishte vetëm një vend nga mund të kaptoje matanë. Ky ishte Shkëmbi i Bletës. Po të dilje në krye të tij, mali, me vështirësi po prapë shkelej e i dilej Qafës së Dardhës nga prapa. Shkëmbi e kishte marrë këtë emër, sepse në faqen, e tij kishte zgavra ku ngrinin fole bletët. Sa të mëdha ishin ato brenda, nuk dihej. Një gjë ishte e qartë, se brez pas brezi pleqtë tregonin që ato bletë ishin atje prej kushedi sa vitesh, ishin aq shumë, sa në kohën e kullotës mbulonin gjithë malin dhe në shpellë kishte aq mjaltë, sa lum ai që mund të arrinte të ngjitej atje e ta vilte! Do t'i thoshte fukarallëkut sikter përjetë. Edhe Bujari, si

gjithë brezat e mëparshëm të atyre fshatrave përreth, pati ëndërruar për atë bletë e qe përpjekur me dhjetëra herë t'i ngjitej faqes së shkëmbit. «Po të arrij ta vlej atë mjaltë, — pati menduar ai, — do të bëjmë shtëpi të reja, do të blejmë ca dhen ose dhi, një pendë qe, një lopë, një mushkë...» Duke jetuar me një ëndërr të tillë, Bujari pati përfytyruar shpesh nusen e tij, duke nusëruar në shtëpi, në një shtëpi me gjithë të mirat, dhe nuset e çupat e fshatit që do t'i këndonin:

*Dole, moj, dole nga ato kasolle!
Hyre, moj, hyre në ato saraje!*

Kështu, sa herë qe përpjekur, qe ngjitur gjer afër shpellave me mjaltë, por nuk pati mundur kurrë t'u vente atje. Gjithë Shkëmbin e Bletës, e veçanërisht rrugën që kishte ndjekur për t'iu ngjitur, ai e kishte si një pëllëmbë të dorës e ia njihte çdo plasaritje apo shkrep, sado i vogël të ishte, qoftë edhe sa për të ngulur vetëm thonjtë, ashtu siç dinte kallot e plasaritjet e duarve të tij. Siç pati dëgjuar nga pleqtë e fshatit, Shkëmbit të Bletës i qe ngjitur dikur vetëm një Fejzi Ashta. Po për atë tregonin se «e hante shkëmbin» sikur të mos qe njeri, po dhi e egër. «Gjersa paska qenë një Fejzi nga këto anë, që i është ngjitur shkëmbit gjer te zgavrat me mjaltë, — pati menduar shpesh Bujari, — përsë të mos i ngjitet tjetër njeri? Pse të mos jem unë i dyti pas tij? Po ai paska qenë si *dhi e egër!* Mirë, po në fund të fundit prapë njeri ka qenë. Po atij *nuk i merreshin mendtë kurrë, sado lart të gjendej!* Tamam, edhe ai vetë e kishte provuar se nuk i merreshin mendtë.»

Ndoshta-ndoshta, një ditë edhe ai do t'i qe ngjitur Shkëmbit të Bletës, sikur të mos e kishte marrë vesh e ëma e të mos i kishte thënë me lemeri në zemrë: *Bir, po të mora vesh se vete përsëri për t'iu ngjitur shkëmbit, të kam bërë haram qumështin që ke pirë!... Mos më nxi jetën, bir!... Ç'e duam atë mjaltë që të kërkon kokën, bir, e nuk të kërkon xhokën!*

Duke dëgjuar komisarin sa gjë e madhe ishte, në atë situatë, kalimi i Tomorit, ai përfytyroi e jetoi gjatë gjithë asaj kohe sikur i ngjitej Shkëmbit të Bletës e shumë herë, vetveti, duke harruar ku ishte, i tendoseshin muskujt e krahëve, të këmbëve e të gjithë trupit. «Ja, — mendonte me vete, — sikur t'i ngulësh thonjtë në atë të çarën, nja dy pëllëmbë më lart se atje ku arrita për herë të fundit... Po ku të mbështetësh këmbët? S'ka asnjë të çarë... Dhe po nuk mbështete këmbët... Po sikur të rrashesh, të bë-hesh njësh me shkëmbin, shputat e këmbës t'i kolissësh në gur e të ngjitesh me muskujt e barkut?... Po... Po... në softë se i kalon edhe aty dy-tri pëllëmbë...»

Kur ishte një çast kështu, i kredhur i téri në të tillë përfytyrime, komisari e pyeti:

— Po ti, shoku i rinisë, ç'na thua?

Në tonin e komisarit kishte më tepër dëshirë për një shaka të lehtë për të harruar sado pak atë lodhje aq të madhe, shkaktuar nga të menduarit, se-sa për të marrë një mendim nga ai djalth pa përvojë. Këtë shaka pastaj ai deshi ta bënte, sepse edhe shokëve të tjerë u pati rënë në sy qëndrimi i djalit, gati-gati i përhumbur dhe sikur të mos jetonte në këtë botë.

Bujari shkundi shpatullat, siç bën njeriu kur do

të çlirohet nga një barrë e rëndë në vetëdije e jo në shpinë dhe iu përgjigj:

— Unë them të kalojmë malin.

— Kështu themi të gjithë, — ia priti komandanti me buzën në gaz pa të keq, — po hë!... — dhe ai bëri një lëvizje të kokës për të plotësuar mendi-min «A i bihet malit me kokë?!». Pastaj vazhdoi me ton serioz: — Tomori, or bir, kalohet veç po të jesh shqipe e të fluturosh me krahë. Hë, e kalon dot ti?! Jo! Tjetër, tjetër zgjidhje duhet menduar, or bir!

Fjalët e fundit komandanti i tha jo sikur t'i drejtohej Bujarit, po shokëve të tjerë e si t'u thoshte atyre: «Hajt, të mendojmë shpejt se ç'rrugëzgjidhje duhet t'i japim!» dhe aty për aty u krohdh përsëri në mendime.

Bujari ndjeu t'i dhimbte qafa si atëherë kur ishte fëmijë e qëndronte me kryet lart, duke vështruar nga Shkëmbi i Bletës, i kredhur në èndrrat e shpëtimit nga varfëria. I dha kokës nja dy herë sa djathtas, majtas e vazhdoi:

— Unë them të kalojmë malin. E marr vetë përsipë:. Le ta provojmë njëherë. Pa, edhe në rënça, vdes vetëm një. Kurse, po ta kalojmë, forcat e gjalla...

— Ku ta kalojmë?! Si ta kalojmë?! — pyeti shpejt-shpejt komisari me një pamje të shqetësuar të fytyrës.

Kurse të tjerët po dëgjonin me buzë të mbledhura e duke pyetur heshtazi: «Si ta kalojmë?! Me krahë?!

— Te Shkëmbi i Bletës, — u përgjigj thjesht Bujari. — Unë...

Sytë e tij vajtën te buzët e mbledhura të pjesëtarëve të shtabit, u skuq gjer te majat e veshëve, ndjeu t'i vërvshonte gjaku nëpër gjithë trupin dhe

pyeti me vete me druajtjen e një djali të turpshëm:
«Mos po më marrin për ndonjë aguridh, apo fodull?!» Po zëri i komisarit e shkëputi shpejt nga kjo gjendje.

— Po, — tha komisari dhe, nga mënyra si tundi kryet, Bujari e kupto se edhe ai e dinte vendin ku i thoshin «Shkëmbi i Bletës».

— E pamundur! — foli komandanti, duke i përsëritur tri-katër herë i nervozuar këto fjalë, si të thoshte me nxehjen e tij: «Të mos rrëshqim ujë në havan! Të merremi me propozime që të na vlejnë!»

— Ta provojmë njëherë, — nguli këmbë partizani i ri, me zë të vendosur. — E marr unë përsipër.

— Rri, mor bir! — u dëgjua zëri i trashë i xha Ademit, i cili thartoi fytyrën nga ato që dëgjoi dhe i vuri partizanit të ri përpara një tas me përsesh.

— Rri rehat, — përsëriti ai, — mos fol budallallëke!» Pastaj vazhdoi duke u kthyer nga të tjerët:

— Heu, sa burra janë munduar t'i ngjiten atij shkëmbi dhe s'kanë mundur! Ka qenë një Fejzi nga fshati ynë. Ai e hante kiamet shkëmbin. Djalë i shëndoshë si div. Mendtë nuk i merreshin asnje thërrime. Ai i qe ngjitur Shkëmbit të Bletës, sa qe i ri, disa herë, këtu e gjashtëdhjetë a shtatëdhjetë vjet më parë, por jo më dimër, më verë. Tani atje është kallkani dy pëllëmbë i trashë e rrëshqet si mbi sapun e më keq akoma!

— Ta provojmë njëherë... E marr unë përsipër,
— ngulmoi edhe më i vendosur Bujari.

I zoti i shtëpisë iku i nxehur si për të treguar që nuk i duronte dot mburrkat e atij çunaku, që po u humbiste kohën kët shokëve.

Komisari u mendua një copëz kohë, duke mbajtur ballin me dorë, siç bënte zakonisht kur do-

nte të merrte një vendim. Të tjerët po heshtnin duke u rrekur secili në duhej bërë një provë me këtë djalë apo jo.

— E merr ti përsipër? — e pyeti komisari partizanin.

Partizani e thithi menjëherë ç'i vlonët në tru komisarit.

— Shoku komisar, — tha ai, — unë e marr përsipër! E thashë: në rënqë, një jam unë.

— Ne nuk duam që ti të sakrifikosh, kur s'kemi asnijë shpresë. Jo!

— Shoku komisar... Më lini këtë radhë.

— Si thoni, shokë? — pyeti komisari. — Unë mendoj që ne ta bëjmë një përpjekje për të kaluar këtë djalin matanë Tomorit nëpër «rrugën» nga thotë ky. C'të bëjmë tjetër!?

Duke thënë fjalët e fundit, ai ngriti edhe duart lart. Me atë gjest deshi t'i bindte shokët se ai, nga ana e vet, nuk gjente asnijë rrugë tjetër.

Shokët heshtën të menduar. Urët prej dëllinje që digjeshin në oxhak, bënин «praf-praf» e shkëndijat që shkëputeshin prej tyre, përhapeshin në vatër. Jashtë, një valë e re e fortë, që erdhi nga Qafa e Kulmakut, u përplas mbi muret e çatinë e shtëpisë dhe iku drejt grykës së lumit të Tomoricës, duke lënë pas një shungëllimë si një vajtim.

— Nuk kemi kohë të presim, shokë! Shfaqni edhe ju mendimin tuaj! Tani në dimër një dorë ditë ka. Ora po vete dhjetë.

Toni i komisarit këtë herë që kategorik e nuk linte shteg për ta zgjatur çështjen.

— Ju mendoni të hidhet ky djali matanë. Po pastaj? — pyeti komandanti.

— Unë kam dy variante ndër mend, — tha ko-

misari. — Të hidhet ky djali matanë dhe të shpjerë urdhrin tonë pér batalionin territorial të Nahijes së Beratit, i cili t'u bjerë forcave armike në shpinë. Të hapin zjarr kundër tyre, sa pér t'u prishur mendjen. Sulmi i tyre do të kombinohet me mësymjen tonë, pér të çarë rrithimin. Ky variant mabetet, në qoftë se nuk do të ngjitim dot një kompani nga tonat në-pér Shkëmbin e Bletës, fill pas gjurmëve të këtij djali. Po qe se do të jetë e mundur të ngjitim partizanë nga të grupit, atëherë... Sidoqoftë, të shkojmë njëherë atje në vend.

— Si thua ti, trim? — iu drejtua komandanti i grupit Bujarit dhe ia nguli sytë sikur t'i thoshte: «Mendohu mirë pér të fundit herë, djale, se edhe unë bir i këtyre maleve jam... I njoh mirë unë çdo shkëmb e gérxh... Po ta hëngri syri, mirë. Pérndryshe...»

Bujari u shkrifërua. Trupi i thaticëm i tij u duk sikur po përgatitej t'i qepej shkëmbit në atë çast. Komisarit iu bë sikur e pa majë shkëmbit, si një shqiponjë tek rreh krahët me triumf. Megjithatë djalit, ngaqë ishte i ndërgjegjshëm pér barrën që po merrte përsipër, iu ter goja. Ai donte t'i thoshte më shumë komandantit, që ta siguronte... por iu përgjigj vetëm shkurt:

— Besomani mua ngjitjen e shkëmbit, shoku komendant.

Tha kështu dhe e pa me ngulm.

Pak pas kësaj bisede Bujari filloi t'i ngjitej Shkëmbit të Bletës. Poshtë, rrëzë tij, me kryet lart, qëndronin komisari, zëvendëskomisari, komandanti i grupit dhe një kompani partizanesh të zgjedhur.

Koka e një litari të gjatë qe lidhur në rripin e mesit të Bujarit. Në fillim turra e litarit, në këmbë të komisarit, u shtëlliz paksa shpejt pastaj shumë-shumë pak e më pas, me minuta të tëra, nuk shtëllizej asnjë pëllëmbë. Bujari dukej atje lart me krahë e këmbë hapur, i mbërthyer pas shkëmbit. Komisari e vështronë sikur të mos u besonte syve, ulte kokën te këmbët e tij të shihte nëse lëvizte litari. Dhe, kur ai ngjitej lart ngadalë, shumë herë nga tre e pesë centimetra, zemra i rrihte fort. Që në fillim ai dhe gjithë të tjerët, kur u gjendën përfund shkëmbit, menduan secili me vete: «Është shumë e vështirë». «Veç ndonjë kokëkrisur mund të ndërmarrë një gjë të tillë!», filloi të thoshte ndonjëri me vete. Dikush e quante Bujarin «kokëshkretë». Kurse komisarit, pas atij mendimi «shumë e vështirë», dyshimi përsuksesin erdhi duke iu rritur aq shumë, saqë filloi të shfrynte me vete: «Ku e pata mendjen! E mora më qafë atë djalë!» Kur litari lëvizte e ngjitej sado pak lart, të rrahurat e zemrës i bëheshin edhe më të forta. Shumë herë mendoi t'i thërriste të zbriste, por tanimë ishte vonë, shumë vonë. Për mendimin e tij edhe zbritja kishte po aq rreziqe. Në një çast, kur litari qëndroi pa lëvizur një kohë të gjatë, ai nuk duroi më dhe, pasi vështroi i alarmuar rreth e qark shokët, si për të kërkuar mbështetjen e tyre, i thirri Bujarit:

— Shok, zbrit, shok! Nuk është e mundur!

Asnjë nga të tjerët nuk foli. Por me heshtjen e tyre treguan se edhe ata ishin në një mendje me komisarin.

Bujari nuk u mor vesh a dëgjoi apo jo. Veç pas dy-tri minutash, nga turra e litarit u shkëputën lart edhe dy-tri pëllëmbë të tjera e pjesa e tij e varur u

lëkund fort në ajër. Bujari pati kaluar një shkallë shumë të rrezikshme, por më lart kishte edhe të tjera po aq të rrezikshme, në mos dhe më keq, prandaj komisarin nuk e gjëzoi ajo fitore. Përkundrazi ai goditi litarin me këmbë sikur t'ia kishte ai fajin dhe tha me zë: «E mora më qafë atë djalë!» Dhjetëra sy e vështruan. Nga shikimet e shokëve ai nuk kuptoi nëse e shihnin apo jo me vend ata atë gjyq që i bëri ai vëvetes, veçse në çast ndjeu një mobilizim të të gjithë qenies nga një zë që i thirri së brendshmi: «Besim! Optimizëm! Je komisar!» Megjithatë, sa më shumë kalonte koha, aq më shumë i shuheshin edhe shpresat. Tani nuk guxonte të vështronte nga Bujari, që i dukej si një xhungë e zezë në faqen e shkëmbit, herë i mbledhur sa një grusht, herë me krahët e këmbët hapur. Atij i bëhej sikur nga casti në çast do ta shihte tek do të shqepej nga ajo faqe e lëmuar shkëmbi. Mbante ballin me dorë dhe përsëriste me sytë ngulur mbi turrën e litarit: «E mora më qafë atë djalë! Nuk duhej ta kisha lejuar!» Ndërkohë zëra rreth tij pëshpëritnin: «Do të ngjitet ai! Kur arriti gjer atje, do ta hajë edhe atë pjesë që i ka mbetur! Keni për të parë!» Me bisht të syrit i vështronte ata që thoshin kështu dhe hetonte në ishte një optimizëm i shtirur ky i tyre. Por jo. Në tonin e tyre, në lëvizjet me të cilat shoqëronin fjalët, kishte shumë besim.

Bujari arriti gjer atje ku kishte arritur për herë të fundit para dy vjetësh, para se të dilte partizan, dhe ngeci. Ngeci gjatë. Më gjatë se çdo herë tjetër. Komisari vazhdonte të vështronte vetëm litarin midis këmbëve, i ulur mbi një gur dhe thithje cigare pas cigareje. Një thirrje shpërtheu me llahtari nga të gjithë sa qenë atje e përsëritur disa herë:

— Ra!... Ra!... Ra!...

Dikush ra përmbyss e zuri sytë me duar të mos shihte gjë.

Komisari ngriti kokën dhe pa se partizani mbahej me dorën e këmbën e djathtë, kurse me dhëmbë kishte kafshuar fort një rrënje bredhi. Dora dhe këmbla e majtë i lëkundeshin në ajër e dukej se bënte përpjekjet e fundit të rrasej edhe një herë pas shkëmbit të lëmuar, për të qëndruar atje aq sa do t'i duronin duar e këmbë, pa u lodhur, e pastaj të mbetej përjetë atje dhe në kujtesën e shokëve si një shqiponjë me krahë hapur, në fluturim të përjetshëm.

— E, ç'është, ç'është?! — u foli ai partizanëve me një shprehje të fytyrës, si t'i qortonte: «Asgjë nuk ka për të ndodhur». Dhe në këto çaste nga turra e litarit u shtëllizën më se dy të dredhura; më shumë se çdo herë tjetër. Bujari po kacavirrej akoma si ketër, me thonj e dhëmbë pas shkëmbit.

— Urra! — shpérthyen thirrjet si nga gjoksi i vetë malit.

Komisarit i rrëshqiti vetëtimthi një nënqeshje gjëzimi në fytyrë, pastaj pamja e tij u bë prapë shumë serioze.

Bujari vazhdoi të ngjitej. Litari poshtë shtëllizej pesë, dhjetë centimetra, ngekte, vazhdonte të shkëputej paksa, sa nuk kuptohej; prapë shtëllizej një çikëz më shumë dhe komisari e gjithë sa ishin rrëth tij, me gjak të ngrirë e me zemrat peshë, thërritnin heshturazi që poshtë: «E-dhe pak!... E-dhe pakëz!... Hë!.. E-dhe pak!» Nga mesi i faqes së shkëmbit e lart aty-këtu Bujari linte ca njolla të kuqe gjaku. Gurët e mprehtë, të ftohtët dhe akulli ia kishin bërë thela-thela këmbë e duar.

Më në fund: «Ja...Ja!...Ja!... E-dhe pak! Edhe pak!» Tani këto nuk ishin thirrje të heshtura të zemrave që rrighthnin poshtë, po thirrje me zë. Edhe vetë komisari thërriste më shumë se të tjerët.

Dhe ja! Bujari doli sipër, buzë shkëmbit. Atje hoqi shaminë e kuqe të gushës, hapi krahët (tamam ashtu si e pati përfytyruar komisari në shtëpinë e xha Ademit, kur ai propozonte të kalonin malin, si një shqiponjë që ka cak qëndrimi e fluturimi vetëm majëmalet) dhe i përshëndeti shokët duke thirrur. Po zëri i tij i fuqishëm tretej gjatë rrugës e mezi arrinte gjer aty rrëzë Tomorit, në veshët e komisarit e të shokëve të tij. Dhjetëra zëra, duar e shami të kuqe iu përgjigjën që poshtë përshëndetjes së tij.

— Të lumtë, ore bir! — i thirri edhe xha Ademi, që u duk sikur mbiu nga dheu, sepse asnjeri nuk e pati vënë re kur kishte ardhur. — Djalë guri më je dhe djalë guri e tregove veten! Të lumtë, more bir!

*

*

*

Të nesërmen, forcat armike, të goditura në shpinë e të vëna midis dy zjarreve, u çoroditën dhe e lanë të lirë krahun e majtë të rrjedhës së lumit të Tomoricës. Pas kalimit të Bujarit, si komisari ashtu edhe komandanti i grupit partizan nuk e panë të mundur kalimin e kompanisë matanë Tomorit. Bujari, ashtu siç qe porositur, pasi rroddhi në anën tjetër të malit, mori takim me komandantin e batalionit të forcave vullnetare. Armikut iu zu një karvan i tërë me munitione në Qafën e Dardhës. Municionit shtabi i grupit iu gëzua sa dhe shpartallimit të rrëthimit.

Duke i raportuar, komisari pyeti:

— Ç'u bë ai djali që u ngjit në Shkëmbin e Bletës?

— U plagos, — i thanë, — dhe e shpunë në shtëpinë e tij.

— Pse? Nga është ai?

— Nga këto fshatrat rrëzë Tomorit.

— Sot do të shkojmë ta hamë drekën në fshatin T... — propozoi komisari në fund të raportimit.

— Kam mall për atë fshat. Kam qenë atje mësues katër vjet me radhë, nga 1930 gjer më 1934. Kam shumë kujtime. Kam shumë miq atje.

Kur arritëm në fshat, kryetari i këshillit i priu komisarit ta merrte në shtëpinë e vet.

— Jo, — i tha ai. — Te ti do të vij për darkë. Tani do të vete nga Myftari Krasta.

Kryetari u përtyp e u ndrydh. Pastaj, si të qe penduar, «mirë — tha shpejt e shpejt, — unë atëherë po shkoj përpara t'i lajmëroj».

— Po vjen komisari! — i tha Hysnijes, së shoqes së Myftarit, i cili kishte vdekur katër vjet më parë. — Unë desha ta merrja vetë, por ai nuk deshi.

— Të urdhërojë! — u përgjigj ajo e gëzuar.

— E di kush është apo jo?

— Po komisari është...

— Komisari, komisari, po është ai që ka qenë mësues te ne, Ferdiu.

— Uuu, sa më gëzove! — thirri Hysnija. — Të urdhërojë, të urdhërojë!

Në këto e sipër u dha Ferdiu te trina e oborrit. Rrugës Ferdiu e mori vesh se Bujari ishte djali i Myftari Krastës, dhe kishte kujtar se ai kishte kërkuar të shkonte te Hysnija për të parë Bujarin.

— Motra Hysnije, — i thirri sa e pa dhe, pa e përshëndetur fare e pyeti, — ku e kam Bujarin?

Bujari, që i kishte dëgjuar të gjitha qysh kur kishte ardhur kryetari i këshillit, qëndronte shtrirë në shtëpi dhe i skuqur nga turpi, që nuk ngrihej dot t'i dilte komisarit përpara ta priste. Por, kur dëgjoi zërin e tij, me gjithë dhembjet, u përpoq të çohej në këmbë. Komisari e gjeti tek mbahej pas murit të konakut, si ata fëmijët që porsa ngrihen në këmbë.

— Bujar! — i thirrië embël si t'i thërriste djalit të vet.

— Ah, shoku mësues, shoku komisar!

— Po si nuk më njohe, more djalë?! Si nuk të njoha unë, more Bujar?! Më shëmbëlleve, por... — u kthyen nga Hysnija, më shëmbëllente, motër Hysnije, po... kishim tjetër hall e as që kisha mend ta pyesja.

— Edhe unë ju shëmbëlleva, shoku komisar, por... Shoku komisar, të vilet mjalti te Shkëmbi i Bletës. Spitali partizan ka shumë nevojë pér të së-murët e të plagosurit.

— Ulu, ulu, ulu! — e luti komisari duke e putthur në buzë i mallëngjyer.

Djali digjej nga temperatura. Komisari u ul bri tij, i mbante dorën në ballë e kohë më kohë i ndërronte leckat e lagura me raki, i lagte fytyrën e duart.

Duke i mbajtur ashtu dorën në ballë, komisari shkoi larg në kujtimet e veta...

«...Ora e mësimit të gramatikës me klasën e katërt. Tri klasat më të ulëta bëjnë mësim heshturazi. Ka përpara katër klasa kolektive. Bujari i vogël 7-vjeçar është ulur në bankat e para. I dobët, koc-

kë e lëkurë. Llërët e duarve si kofshë kaposhi. Këmbët e vogla zbatbur. Këmisha, gjithë arna, e shqepur në sup dhe dielli ia ka përvëluar një pllackë lëkurë.

— Shkruani ju të klasës së katërt:

*Unë kam bukë,
Ti ke bukë,
Ai ka bukë,*

*Ndihet gërvishtja e majave të penave me bishta
të sajuar nga vetë nxënësit.*

Ne nuk kemi bukë.

*Nga erdhi ky zë?! Po. Këta nuk kanë bukë dhe
unë... Këta nuk kanë bukë!... «Kush foli?» Bujari
në këmbë, me kokën ulur.*

— Unë, zoti mësues. Ne nuk kemi bukë. Babai
nuk ka ardhur akoma. Ka shkuar të gjejë misër».

Kishte tri ditë që Hysnija e niste Bujarin pa
mëngjes. I jepte vetëm pesë-gjashtë kokrra arra në
vakt, sa për të vrarë urinë. Duke dëgjuar mësuesin,
Bujarit iu zgjua uria, që për një kohë, duke e pa-
sur mendjen të humbur në lexim, i qe dukur sikur
e kishte zënë gjumi në barkun e tij dhe tani filloj
ta kafshonte si me dhëmbë. Ai, krejt i pavetëdij-
shëm, vetvetiu e si të ishte përqart, thirri: «Ne nuk
kemi bukë».

«Po. Këta nuk kanë bukë. Këta i këput uria!
Shiko si u kanë zënë rrëth të zi sytë!»

Pesë a gjashtë fëmijë të agallarëve të fshatit
qeshën.

— Bujar, ti nuk deshe vetë të na prishje qetë-
sinë. — I hedh dorën në kokë dhe i ledhaton flo-

kët e paqethur. Dora jep dridhjet e zemrës në ata flokë.

— Jo, nuk desha vetë, zoti mësues.

— Mirë. Ulu, Bujar. Dhe ju që qeshët, dilni këtu në fund të klasës. Rrini me fytyra nga muri e me duart lart...

Po atë ditë, në drekë, kur u lëshuan nxënësit.

— Bujar, eja pak. Na këtë dollar e jepja nënës, se ia kam borxh për ato vezët që i kam blerë. Hap sytë mos e humbësh! Hap sytë! Thuaji nënës të blejë misër, gjersa të vijë Myftari. Dhe me vete. «Asaj nuk i kam asnje borxh. Po ajo do ta kuptojë».

— Shoku mësues... më fal, shoku komisar.

Komisari u përmend si nga një ëndërr dhe në çast e pa veten pranë Bujarit.

Bujari, duke i folur e duke u zgjatur me vëshitërsi nga dhembjet, hapi kapakun e një sënduku të vogël që kishte pranë, nxori që andej një «parabel» gjerman e një palë dylbi dhe ia vuri para duarve komisarit.

— Merrini, shoku komisar. Ia gjeta me vete oficerit gjerman, atij që më plagosi. Komisari i batalionit tonë, kur ia dorëzova, më urdhëroi t'i mbaja për vete. Por unë dua t'jua dhuroj juve.

— Atëherë, merri dhe ti revolen e dylbitë e mia, — i tha komisari duke e puthur në ballë e duke i shpupuritur flokët, si atëherë kur e kishte nxënës.

Pastaj u panë sy më sy. Komisari deshi t'i thoshte: «Ne do të kemi bukë, Bujar! Ne do të kemi liri, do të kemi punë, begati, lumturi!». Po a është e nevojshme t'ia thotë sot? Bujari nuk është më ai i pësëmbëdhjetë e i dhjetë vjetëve të shkuar. Dhe tek lëkundej në këtë mëdyshje, Bujari nxitoi e i tha:

— Unë nuk i kam harruar, shoku komisar, bise-

dat tuaja rrëth vatrës sonë, që atëherë kur isha sa një çocërr. A ju kujtohet? Më shpupuritnit flokët dhe më thoshit: «Po ti, çocërr, a do të luftosh kur të rritesh?» dhe pastaj vazhdoje me babanë: «...Shfrytëzimi nuk shporret pa revolucion, o Myftar Krasta... Liria fitohet me gjak... Bejlerët, pashallarët, tyxharët, fajdexhinjtë...»

Komisari buzëqeshiëmbël e iu përgjigj:

— Më kujtohen shumë-shumë qartë bile. — Pastaj me vete shtoi: «Dhe nuk e paskam mbjellë atë farë në tokë djerrë».

FILXHANËT PREJ PORCELANI

31 — Nënë, do të nisesh tanë? — e pyeti Mirka t'ëmën, e gjuar, kur pa se ajo i kishte vënë vezët në shportë sërë-sërë e i kishte mbuluar me byk kashët, që të mos thyheshin rrugës.

— Po, xhan i nënës, do të nisem.

— Oh, lumja unë!... Oh, lumja unë!... — filloi të therriste Mirka, duke kërcyer nëpër ~~ashef~~ e duke rrahur pëllëmbët.

— T'u bëftë nëna...! — i tha eëma e dhimbsruar dhe e ndiqte me sy me një gjësim të veçantë në zemër edhe ajo, që mezi iu bë mbarë t'i blinte çupës një fustan të ri pas kaq kohësh.

 Fustani që kishte, i qe bërë rripa-rripa e nuk mbante më as arna. Në një vend, në shpatullën e djathtë, i qe grisur edhe këmisha, e vogëlushes i kishte dalë mishi jashtë e i qe përcëlluar nga dielli. Për dy muaj me radhë, ditë pér ditë, Farija kishte mbledhur vezët e pulave një nga një e ja, tanë qenë

bërë aq sa mund t'i blinte së bijës dy metra basmë e dy metra beze. Mirka, sa herë që dëgjonte Lariskën të kakariste ose Gushëkuqen, rrihte pëllëmbët e gëzuar e shkonte tek e ëma duke gulçuar:

— Nënë, polli edhe Lariska! Sa kokrra u bënë tanë?

Kur ndonjëherë më të rrallë e ëma donte t'i pikte për drekë apo për darkë ndonjë vezë në kaci, Mirka i lutej:

— Jo, nënë, nuk dua. Gjersa të më blesh fustanin...

— Po ti u thave për të ngrënë, moj shpirt i nënës! — mërmëriste ajo si me vete, me zë të dridhur nga dhimbsuria.

Një ditë Farija, bashkë me katër shoqe nga fshati, u nisën për në dyqan, dy orë larg me këmbë. Mirka e kishte zënë për dore e përcollti gjer larg, te Guri i Strehut.

— Kthehu, zemër e nënës, — e luste Farija.

— Ja edhe pak... Nënë, më zgjidh një basmë të bukur, të bukur!

Kështu i thoshte Mirka çdo ditë, qysh kur e ëma i premtoi t'i blinte fustanin e ri. Kështu e porositi kushedi sa herë edhe gjatë rrugës, duke e përcjellë.

— Shumë të bukur, do të ta blejë nëna, o shpirt i vogël.

Fshati ku ishte dyqani, qe përkundrejt e dukej. Rruga tani, nga Guri i Strehut, ku u ndanë nënë e bijë, vinte e tatëpjetë. Pastaj do të hidhnin një lumë e do të ecnin edhe ndonjë orë në të përpjetë.

— Shko tani në shtëpi, — i tha Farija.

— Jo, nënë. Do të rri këtu, në majë të këtij guri dhe do t'ju ruaj gjersa të hidhni lumin.

Gratë nxituan tatëpjetë. Mirka i thirri s'ëmës që pas gjithë merak:

— Nënë, mos nxito shumë, se thyen vezët.

Duke pritur t'ëmën aty, majë gurit, Mirka ëndërronte për fustanin më shumë se ç'kishte ëndërruar për dy muaj me radhë. Lloj-lloj basmash solli në-për mend, nga ato që kishte parë kur vinte dy-tri herë në vit një tregtar shëtitës me dy kuaj të shëndoshë ngarkuar me basma, pëlhirë, sapunë, penjë, rruaza, vathë... I shkarkonte në një shesh, mes fshatit, dhe graria shkonin me vezë në duar, me ndonjë lëkurë keci a qengji për të blerë.

Duke ëndërruar, dy-tri herë u harrua fare dhe iu bë sikur e kishte veshur fustanin e ri. Dhe shihte veten sa djathtas majtas...

Priti kështu gjer vonë, pa hyrë fare në shtëpi. Edhe drekën jashtë e hëngri, nën hijen e zerdelisë që kishin para shtëpisë. Që andej rruga nga do të vinin nëna me shoqet dukej mirë.

Dy orë para se të binte nata, ato u dukën tek ngjitnin të lodhura të përpjetën e fshatit.

— Po vjen nëna... — u thirri shoqeve Mirka.

Pastaj zuri të këndonte:

*Sa e bukur qenka Mirka,
me fustanin pika-pika!
Ia bleu nëna te Xhagjika...*

Kur gratë qenë afruar edhe ca, Mirka nxitoi t'u dilte përpara.

— Mos bridh aq, moj, se do të gremisesh e do të vritesh!

— Po Mirka s'dëgjonte e më shumë u dha këmbëve.

— E zeza unë!... Më hëngërt një mortje mua!...

Mos më zëntë darka!... — mallkonte Farija e bren-gosur tek shihte të bijën duke vrapuar.

Shoqet u drithëruan.

— Mjaft! — iu kanosën. — Mjaft mallkove veten! Një herë tjetër...

Mirka nuk ishte më shumë se njëqind metra larg. Tek vraponte, era ia merrte fustanin rripa-rripa e i dukeshin ata kërcinjtë e hollë ~~si cingla~~.

— Më raftë një pikë! — mallkoi veten prapë Farija e zuri sytë me duar. Nuk i mbajti dot lotët.

Dy nga shoqet e shkundën nga krahët.

— Mos u çmende!? Kështu si bën ti, do të tmerrosh çupën.

Ndërkaoq Mirka e kishte përfshirë për beli e, duke marrë frymë me zor, e pyeti:

— Nënë, ma prure fustanin? I bukur është? — dhe me duart e holla si shkarpa, që i dridheshin nga padurimi, ia mori shportën nga dora e nisi të kërkonte në të.

Farija nuk guxonte t'i hidhte sytë. Ajo po shikonte diku, drejt Tomorrit, si e ngrirë më këmbë.

— Prit, prit, — i tha me zë të butë çupës njëra nga shoqet e Farijes, e zuri për krahun dhe i më-njanoi nga sytë flokët e lagur nga djersa. Pastaj, me cepin e përparëses i fshiu faqet e skuqura.

— Nënë, është i bukur fustani? — s'duronte Mirka.

— Lërna njëherë me këtë fustan, — ndërhyri butë-butë gruaja që e mbante vajzën në prehër. — Po ti paske copëtuar gishtin! Ku e vrave kështu? Për këtë na thuaj njëherë! Pupu, pupu! Ç't'i bëjmë këtij gishti tan!

Mirka as e kishte ndier gishtin. Nga gjëzimi i fustanit as që kishte kohë të bëhej merak për të.

Por, kur vuri re nënën që rrinte me kryet mënjanë e me sy të përlotur, vajti iu ul në prehër e i puthte gushën e djersitur.

— Nënë sëmurë je ti!? — e pyeti e merakosur.

— Jo, o zemër e nënës!

— Po ti!... Po ti!...

Mirka nuk po dinte ç't'i thoshte. Në sytë e saj sa vinte rritej meraku pér nënën e sëmurë.

— Nuk ka gjë nëna, jo! Po nuk gjeti basmë në dyqan pér ty dhe i vjen keq.

Mirka vari kryet, zëri iu mek.

— Nuk kishte basmë, moj nënë!? — pyeti si pér t'u sigruuar më shumë.

Duart e vogla të saj përkëdhelën faqet ngjyrë bronzi të s'ëmës, sikur kërkonte falje që, ndërsa nëna ishte e sëmurë, ajo i kërkonte fustan. Pastaj ajo zuri t'ia fërkonte e t'i ankohej me fjalët gjysma-gjysma, me èndërrën e gëzimin e vrarë e duke iu mbajtur goja nga ngashërimet.

— Po... po pse, moj noke, po... po pse, nuk kishte hiç, hiç, hiç fare!?

Dy pikë lot rrrodhën në faqet e nënës.

Shoqet, tek e panë ashtu, iu kërcëuan me sy ta linte të bijën në gënjeshtren e tyre.

Njëra prej tyre nxitoi e iu përgjigj Mirkës:

— Nuk kishte, moj xhan, asnë lloj basme.

— Nuk kishte?!

Në pyetjen e vogëlushes nuk u ndie asnë fije dyshimi, po vetëm dhembje e keqardhje që kishte mbetur pa asnë top basme një dyqan aq i madh, siç e kishte parë ajo dikur dyqanin e Xhagjikës.

— Të ka blerë nëna një gjerdan të bukur e një palë vathë, — e qetësoi ndërkaq Farija të bijën.

— Oho!...

Mirka zuri tē hidhej pupthi.

— Ku i ke, nënë? M'i jep.

— E krisur! E sheh sa lehtë gënjehet fëmija?

Farija psherëtiu thellë e iu përgjigj shoqes, pa e parë në fytyrë, si tē fliste me dikë që s'ishte aty, pér tē mos kuptuar gjë çupa:

— Gënjehet lehtë, po kurrë, kurrë nuk harron lehtë.

Duke thënë këto, hapi një kuti prej kartoni, brenda në shportë, nxori që andej gjerdanin e vathët e deshi ta mbyllte shpejt e shpejt.

— Çfarë ka tjetër aty? — e pyeti Mirka dhe me duart e vogla mbërtheu fort shportën e s'po e lëshonte.

— Nuk ka gjë, moj xhan, nuk ka gjë, — i thoshte si me tē lutur.

Në kuti kishte gjashtë filxhanë porcelani me pjata. Pér ata filxhanë Farija helmoi zemrën e vajzës. E la lakuriq edhe pér dy a tre muaj tē tjerë. Pse ua tregoi ai i mallkuar Xhagjika!? «Pa shikoni ç'kam prurë... — kujtoi fjalët e dyqanxhiut dhe riprohoi në trurin e saj gjestet e tij. — Merrni, se nuk më kanë mbetur veçse dhe pak... M'i ngritën... Kushedi sa më janë lutur: Aman, Xhagjikë, më ruaj, gjashtë copë njëri, dymbëdhjetë tjetri, pér dy ditë, sa tē bëjë paratë. Edhe këta që më kanë mbetur, i kam tē shitur, në paçi pér tē pyetur...»

— Tregoja, moj çupës, t'i gëzojë!

Mirka rrëmbeu njërin nga filxhanët në dorë. Në dorën tjetër mbante shtrënguar gjerdanin e vathët.

— Nënë, sa tē bukur!

Filxhanët ishin me vija ngjyrë ari në buzët e

në fron. Midis vijave kishin lule plot ngjyra, si të vërteta.

— Nënë, moj, sa të bukur!

Sytë e Mirkës shkëlqyen nga vërvshimi i një drite gëzimi të sinqertë. Duke thirrur, ajo shtrëngonte pas faqeve në njérën anë filxhanin në tjetrën gjerdanin, që i varej nëpër gishtërinj.

— Më ngjan mua, korba, — u tha shoqeve plot drithërimë Farija. — Kaq e vogël dhe ka sevda për shtëpi!

Sytë e nënës panë me mirënjojje nga e bija, sepse me gëzimin e saj ajo sikur ia lehtësoi pak atë lëmsh që i qe mbledhur në lugth, e rrudhat që i qenë sajuar në ballë nga ai mundim i brendshëm, sikur nuk ishin më aq të thella.

Farija ishte shumë merake për shtëpi. Kur kishte ardhur nuse, s'i kishte gjetur gjë të shoqit. Bli një herë një gotë, një herë tjetër një pasqyrë, pastaj prapë një gotë, një pjatë... dhe e kishte bërë shtëpinë, siç thoshin graria, si drita në dritë. Dy përdhese me një korridor në mes kishin, po ajo i lyente me gëlqere brenda e jashtë. Ishin të këputur, në ditë të hallit, por me thonj e me dhëmbë, duke tharë edhe shpirtin, me vezët e pulave ajo ia mbushi shtëpinë të shoqit. «I ka ato duar flori! — thoshin për të. — Ka bërë gjithë ato zbukurime! S'ka lënë qypa e teneqe të vjetra e ka mbjellë lule në to, ka mbushur penxhere e oborr, aq sa, kur i vete në shtëpi, të prehet xhani!»

Gishti i vrarë Mirkës sa vinte e po i dhembte më shumë. S'ëmës nuk i tregoi, por, kur u ngritën

të ktheheshin në shtëpi, nuk kishte si e fshihe. Zuri nënën nga dora e, duke shkelur me thembër, mezi po çapitej.

— Të dhëmb shumë, moj zemër?

— Pak, nënë.

Pas çdo dhjetë-pesëmbëdhjetë hapash hidhte dorën në veshë, si të kontrollonte a i kishte vathët varur apo jo. Dhe mendonte q'do të thoshin shoqet kur t'ia shihnin. Si do ta vinin në mes, si do t'i luteshin t'ua jepte në dorë t'i shihnin, t'i mbanin varur edhe ato pak. Me këtë gëzim harroi edhe dhembjen. Kur arritën në fund të brinjave, meqë rruga ishte e përpjetë e plot murriza, Farija e mori kalipeç.

Me të arritur në shtëpi, Mirka iu lut s'ëmës të nxirrte filxhanët. Farija hapi kutinë, nxori një nga një filxhanët e pjatat, të mbështjellë me letër e tallash zdrugu, me një kujdes aq të madh, sikur, sapo t'i shtrëngonte paksa, do t'i mbeteshin në dorë. I shpështolli e u fshiu pluhurin me përparëse.

— T'i zë një cikë me dorë, nënë?

— Zëri, të keqen, zëri. Shikoji, po hap sytë!... Hajde t'i lajmë tani.

Dhe të dyja u ulën në fund të ashefit. Farija, me një tas me ujë përpara, i lau një pér një e i fshiu me përparëse. Pastaj i vuri radhë në sergjen.

— Sa bukur dukeen!

Ëmë e bijë, në këmbë, i vështronin nga larg e u gëzoheshin.

— Bukur rrinë, të keqen, bukur.

— Nënë, ku janë bërë këta? Kush i ka bërë?

Mirkën më shumë e habitnin lulet që ishin vizatuar në ta. Format e ngjyrat e tyre ajo i kishte parë lëndinave e livadheve, te lulet e bajames, të mollës, të zerdelisë, të qershësë, që sapo kishin celur.

«Si i kanë bërë këto lule!», habitej Mirka me vete. «Kush i ka bërë?»

— Janë bërë jashtë, xhan.

— Ku jashtë?

— Kushedi... — Farija u mendua paksa, — në Itali... — tha pastaj si e menduar e me mëdyshje, në ishin bërë vërtet atje, dhe në fund shtoi: — I ka bërë frëngu, xhan.

— Ç'është ky frëngu?

— Njeri është.

— Është larg kjo Italia?

— Larg posa, matanë detit.

Atë mbrëmje, me gjithë dëshirën e madhe që t'u tregonte shoqeve për filxhanët me pjata, për rruate e vathët, Mirka nuk doli përjashta; pa e kuptuar fare, që errur e në atë kohë nuk do t'i gjente dot.

Si hëngrën darkë, Farija mbushi një xhezve me qumësh dhe e zjeu. Pastaj mori dy nga filxhanët e rinj, i mbushi një për vajzën, një për vete, u ul shtruar dhe i tha Mirkës:

— Ti je e zonja e shtëpisë, unë jam mikesha që kam ardhur te ti. — Dhe ngriti filxhanin të uronte.

— Hajde, — vazhdoi Farija me dorën në zemër, — mirë se të gjeta, për gëzime të ardhsha... Ngrijë edhe ti filxhanin e thuaj. Mirë se na erdhe, shyqyr që jeni mirë...

Mirka u gajas së qeshuri. Qeshte dhe mendonte: «Pse e bëri nëna këtë? E ka nga gëzimi i filxhanëve?» Asaj nuk i hiqej nga mendja fytyra e saj atje, në rrugë, kur doli ta priste, nuk i hiqej nga mendja as ai kuvendim me sy i shoqeve me të.

— Nënë, — i tha, — mirë bëre që nuk ma bleve fustanin këtë radhë... Ne do të mbledhim prapë vezë dhe...

Sytë e saj flisnin më shumë. Ata luteshin: «Nënë, unë e di, ti pér filxhanët... Po jo, nënë, jo! Unë tani nuk kam aq dhembje tē madhe që s'ma prure fustanin.»

Vonë ranë tē flinin.

Izet Bregu, i shoqi i Farijes, nuk'ishte në shtëpi. Kishte ikur që më tē hyrë tē marsit e dalngadalë po mbushej muaji. Kështu bënte ai mot pér mot; disa muaj tē vitit iktë nga shtëpia pér tē zënë ndonjë lek. Kishin pak tokë e nuk siguronin dot as shtatë-tetë muaj bereqet. Shkonte herë nga fusha e Korçës, herë ku bëhej ndonjë rrugë e re. Këtë radhë kishte shkuar në skelën e Durrësit pér tē ngarkuar e shkarkuar.

Mirka u ngjesh pas kraharorit tē s'ëmës, i hodhi duart në qafë dhe e pyeti:

— Nënë, si thua, do tē gëzohet edhe babai kur t'i shohë filxhanët?

— Si nuk do tē gëzohet?

Krahët e hollë tē së bijës e shtrënguan edhe më fort.

Në fund tē ashefit ishte një derickë, nëpér tē cilën hyje në kasollen e gjësë së gjallë. Atje mbyllnin ato pesë dhi që kishin, gomarin e lopën. Në kasolle vërriti fort njëra nga dhitë. Katër prej tyre kishin pjellë që më dy javë shkurt, po shyta kishte marrë kec kërthinjë dhe pritej me natë e me ditë. Farija kërceu nga dysheku, gjeti me dorë nëpér terr kandilin që e mbante te koka, e ndezi me një urë që mori nga vatra e hyri në kasolle.

— Çfarë kishte, nënë? — e pyeti Mirka, kur ajo u kthyte.

— Asgjë. Janë vrarë me njëra-tjetren. Ajo Bala s'i lë shoqet tē hanë gjeth.

Farijen e zuri gjumi shpejt. Mirka, me sytë hapur, mundohej të vështronë nëpër terr sergjenin ku qenë sëritur filxhanët. Një mi brodhi nëpër qepra. Diçka ra nga çatia poshtë në plakat e gurta të dyshemesë. Sytë e maces, në fund të ashefit, shkëlqyen e në çast u ndie zhurma e saj në hatulla. Mirka u drodh e tëra. Po sikur të hipte macja ose miu në sergjen e të thyenin filxhanët!

— Nënë, nënë!

Farija u zgjua e trembur.

— C'ke!? — tha ajo e përgjumur. — Uh, c'më bëre merak, moj çupë, — tha pastaj ajo e, duke psherëtirë, i hoqi filxhanët, i vuri në sënduk e ra prapë të flinte.

Dhe kështu bënë ngahera. Ditën i vinin filxhanët në sergjen dhe në darkë i mblonin në sënduk.

2 Nuk kishte kaluar as një javë, kur një ditë mëngjesi u gdhi i bukur, me një diell të shndritshëm e ajër të tejdukshëm, sa padashur të lindte një dëshirë të kishe krahë e të silleshe nëpër qiell, si ata larashët që ishin çuar herët e i vinin luginës kryq e tërthor, pa ndier lodhje kurrë. Ujërat gurgullonin; përrenjve, mbushur me shelgje, bilbilat çaheshin së kënduari; era e barit të njomë dhe e luleve i kishte dhënë ajrit një aromë dehëse; pyje e pemë qenë veshur me gjethin e ri. Pranvera kishte përtërirë çdo gjë e dukej se i thërriste njeriut: Gëzomu! Nëpër ara qenë zënë pendët, dhe thirrjet: «Aha, Shegan! Aha, Murrash!» ishin si një ngazëllim që u shtinte njerëzve në tërë damarët një qetësi të dëshiruar, duke u dhënë ngushëllimin se ja, po mbillej buka e re, rrënja e jetës.

Edhe fëmijët i gëzoheshin diellit. Lodra i kishte rrëmbyer aq shumë, saqë në fillim nuk u bënë merak kur dëgjuan një grua, duke thirrur në krye të shkallëve, pastaj një tjetër e një tjetër në oborr, në kopsht... «Korba, korba, korba!» «E zeza, c'na gjeti!» Lebetitjet erdhën gjithnjë duke u rritur, si t'i bënin jehonë njëra-tjetrës.

- A e more vesh, moj e Zalos?
- E mora, moj korbë Gjyrxhi, e mora!
- Të zezat, të zezat ne, c'na gjeti!
- Qyqja, qyqja, po na vjen Italia!
- Po a bëhet, moj ditëzezë, me frëngun në vatër!

Aq sa e bukur qe dita gjer aty afër drekës, aq u prish e u vrenjt moti më pas. Mbi çukën e Tomorrit sa vinte grumbullohej një re e zezë, e dendur. Re të tjera, po aq të zeza, shpërndarë sa mbi Ostrovicë e Koshnicë, zunë të shtyheshin e të bashkoheshin. Dielli aty zihej, e mbi fshat dukej sikur kishte ardhur muzgu i mbrëmjes, aty dilte përsëri. Nga pylli, kohë më kohë, vinte një oshëtimë e shurdhër, që kalonte valë-valë e mbushte qiellin. Po vinte shtrëngata.

- Të zezat ne!
- Mos e pruftë kokën dushmami!

Burrat zbërthyen qetë në ara në mes të ditës. Me kryet ulur, të lodhur jo nga puna, po nga një rëndësirë në shpirt, u grumbulluan te sheshi në mes të fshatit.

— Dihej kjo punë. Na kishte shitur qeni me kohë.

Fëmijët i lanë lodrat. Dhembja sikur ngrihej nga dheu, e madhe, e rëndë, si ato retë e rënduara me shtrëngatë, që zunë diellin e që u rrin maleve përsipër.

Mirka vajti me një frymë në shtëpi. Po nëna i

kishte thënë se ata filxhanët e bukur... Ata njerëz që kishin bërë ato lule në filxhanë... Sikur kishin tjetër zemër...

Farija nuk e ndjeu çupën kur u dha në derë. Mirka, tek e pa me atë fytyrë tē prishur e sy që shprehnin llahtarë, ngriu te pragu. Hapi krahët e u mbajt në tē dyja anët e derës. Nëna nuk po kujtohej pér tē. Pér një çast Mirkës iu duk si një e largët, e huaj, sikur ta kishte harruar krejt. Ndjeu tē përkundrej mbi këmbët e veta e u lëshua drejt s'ëmës.

— Nënë, nënë, thuaj: ç'na ka gjetur ne!? — Zëri i dridhej nga ngashërimet. Dhe u mblodh grusht në kraharor tē saj.

— Mos ki frikë, moj zemër!

Vërvuan pyetjet:

— Po pse, nënë, pse nëna e Esmasë?... Pse ti?...

— Nuk do t'i lëmë ne, moj xhan, jo.

— Po pse tē na vrasin? Pse vijnë ata këtu?

— Mos e prufshin kokën!

Dhe Mirka herë i shihte italianët si njerëz «të bukurive», që kishin bërë ata filxhanë me lulet më tē bukura, herë si bisha tē egra, me dhëmbët përashta, tē gatshëm pér tē kafshuar...

Burrat shkuan tē luftonin e u kthyen. Në ballët e tyre kishte stuhi, si atë ditë që erdhi lajmi, e qenë mbledhur në mes tē fshatit tē vendosnin ç'do tē bënin.

Pas shtatë-tetë ditësh erdhi edhe Izeti. Kishte luftuar edhe ai. I kishte parë me sy fashistët. Shtatë herë u kishte zënë këmba dhe fashistëve, e shtatë herë i kishin hedhur përsëri në det. «Of», bënte edhe Izeti, si gjithë burrat në fshat. E trembur, e hutuar, Mirka dëgjonte babanë e shokët që erdhën në shtëpi: «Dushmani në vatër... Dushmani zot...» Po si

do të ishte zot? Si do t'ua zinte vatrën? «Mbret qeni mori floririn e iku prapa diellit...» Pse iku ai? Pse i la pa fishekë, pa bukë. Dhe u bë e heshtur. «Ne do t'i luftojmë... Ne nuk do t'i qasim... Ne do t'u rrimë me grusht hundëve...» Po «dushmanët» akoma s'i kishte parë, si ishin, si do të bëheshin zot, si... si... E më në fund si do t'u rrinimi me grusht hundëve?

Një mëngjes fshati gumëzhiu. Kishin ardhur karabinierët fashistë. Kërkonin armë... Burrë për derë duhej të shkonin në mbledhje.

Fshati Kodras ishte i vogël. Tridhjetë shtëpi kishte, ngritur mbi shkëmbinj e gurë. Shtëpinë nga shtëpia e ndante një rrugicëz me kalldrëm, një copëz gardh, një shkëmb, një mur i thatë me gurë. Kaq i mbledhur ishte: «A e ke sigruar?» «E kam sigruar». «Po s'pate vend të sigurt, kam unë». Dhe pastaj, pas këtyre pëshpëritjeve burrat e fshatit nisezin për në mbledhje. I kërkonte togeri fashist. Me ta ishte edhe Xhemil beu i krahanës.

Fashistët qenë veshur me rroba të reja. Me çizme e këpucë që u vetëtinin. Komçat e verdha të xhaketave të tyre të vrисnin sytë.

Mirka në fillim u habit. Kureshtare, duke ecur e -druajtur brinjazi pas murit të kopshtit të Dudisë, ajo bënte tre-katër hapa e ndalej, pastaj dy-tre hapa të tjerë, gjersa t'u afrohej sa më shumë. Ja një karabinier, zdap e i bëshëm, gati sikur do t'i çuhej xhaketa në mes të shpatullave, me mustaqe e mje-kër të zezë, lëshuar poshtë... Po edhe ai, me atë trup ariu, nuk dukej i egër. As në sytë e tij bojë deti nuk dallohej egërsi. «Mjerë kush bie në thonjtë e armikut!» rikujtoi Mirka e i hodhi sytë menjëherë nga duart e zdapit të bëshëm. Duar të mëdha, të

bardha, me ca qime të zeza midis nyjeve të gish-tave. Duart e babait të Mirkës ishin të çara, të çara si zhapë lisi e të ashpra.

Mirka u afrua edhe ca. Dielli binte mbi strehët e zeza të kapelave të karabinierëve e reflektuhej mbi mure, mbi çatitë e shtëpive, e njolla e dritës lodron-te sa herë që ndonjëri kthente kryet. Vogëlushes i lindi dëshira të vinte në kokë ndonjë prej atyre kapelave. Donte t'i zinte me dorë ato komça të vetë-titura e digjej nga dëshira të kishte të paktën një prej tyre e ta vinte në fustan, paçka se e kishte të vjetër. Pastaj, kur t'i blinte nëna të riun, atëherë... Heu, kush do të ishte si ajo, sikur të kishte edhe një komçë të atillë! «Të egër dushmanët!... Gjakësorë!...» Po ata nuk po bënин gjë. Qeshnin. Dhe faqet e tyre të kuqe, të mbushura, të rruara taze, rrudhe-shin hijshëm. Burrat e fshatit rrinin me kryet ulur e ballëngrysur. Dikush thithte llullën e prapa tymit fshihej e dilte prapë në shesh një fytyrë e parruar që prej dy-tri javësh, me gropat e faqeve futur the-lle e mollëzat të kërcyera si dy bunga. Ishte Izeti. «Pse rri kështu babai, — mendoi me një farë keq-ardhjeje për të Mirka, — pse nuk u bën muhabet këtyre që kanë ardhur? Shiko, këta...» Po si i ati bënин edhe të tjerët. Heshtnin e shihnin me urrejtje karabinierët. Ja, Ali Zani shkulte fije bari, babai i Nerënës ngulte shkopin në tokë, sikur përpinqej të hapte atje një brimë, xha Brahimi vështronët nga Tomorri, sikur të ishte fill i vetëm e s'i bëhej hiç vonë se pas shpine i rrinin karabinierët, që përpinqeshin të hynin në bisedë me të. Kryeplaku, Xhemil beu, togeri e marshalli ishin ulur paksa si të veçuar mbi ca flokëse të kryeplakut e bisedonin nën hijen e manit.

Dikur brofi Xhemil beu, brofi edhe togeri e dolen në krye të rredhit të burrave të fshatit.

— Flisni, — u tha Xhemil beu burrave, — do të dorëzoni armët apo jo? Togeri më tha se asgjë nuk do t'ju bëhet... Le t'i japim me të mirë... Këta nuk janë njerëz të këqinj. Por, ama, si t'i sillesh të sillet tjetri... Atëherë, këta s'na kanë faj, fajin do ta kemi vetë. Togeri nuk ju pret më!

— Thuaja zotit toger edhe një herë se ne s'kemi armë. Ku i gjetëm armët!? Na lini të shkojmë të zëmë qetë, se, po nuk mbollëm sot, nuk kemi ç'të hamë mot, bej. Thuaja togerit, bej.

— Ty, Izet, të dëgjuam një herë. Do ta shohim atë punën tënde, ke apo s'ke armë. Po lëru radhë të tjerëve të flasin. S'të kanë lënë ty veqil ata, — tha beu me ton kërcënues.

Çdo fjalë e tha me një theks ligësie, pa u druajtur aspak ta fshihte atë.

— Ja tek janë, le të flasin, — Izeti zgjati krahun e bëri një rrëth në ajër, për të treguar burrat e fshatit, — nuk ua mban njeri gojën!

Kundërshtimi i të gjithë burrave u dëgjua njëherazi si një murmurimë:

— E tha Izeti.

— Ne s'kemi ç'dorëzojmë.

— Kush ia ka ngenë dyfekut!

Xhemil beu, me veshët nga burrat e sytë nga togeri, i përkthente këtij të fundit ç'dëgjonte.

— Mosni, bre burra, se do të merrni veten më qafë, më thotë togeri. Ky ka informata...

— Kush ka kallëzuar? Ti...

— Kush foli? — pyeti beu kot, sepse e dëgjoi mirë kush foli.

Gjaku i vërshoi në fytyrë e ia ngjyrosi atë me

një të kuq të errët. Pështyu fort në shami e pastaj,
si e palosi, pastroi me të mustaqet.

— Kush foli, thashë!?

U përpoq t'i jepte zërit dhe fytyrës një pamje
prej babaxhani, të një njeriu të drejtë, plot dhimb-
suri në shpirt.

— More vëllezër, edhe unë shqiptar jam... Por
unë ua dhashë timen... — Fjalët ngjanin sikur i bi-
nin nga dhëmbët. — Këta s'na marrin vesh ç'themë,
shyqyr zotit, se s'na e dinë gjuhën, por, ama, të
themë atë që është... tani për tani, duam s'duam,
ne jemi të shtrënguar t'i themi derrit dajë. Kushedi,
më pas... mbretëri u thonë këtyre...

Fliste e shikonte gjoja si me frikë, si i trembur
gjer në palcë, sikur dyshonte mos, kushedi, ndonjëri
nga italianët dinte shqip është bënte veten. Pastaj...

— Dhe dyfeknë, po ke topat zotrote, bej.

— Ç'topa more!? Ç'topa more!? — u çmend
Xhemil beu. Nuk e kuptoi romuzin. Pati një çast
ngurrimi dhe me sy të çakarritur zuri të shikonte sa
nga togeri, nga karabinierët, sikur t'u lutej: «Mos e
besoni, mos e besoni! Unë s'kam...».

— Topat që të pruri Duçja, — ia priti Izeti.

— Po të të duhen më, më të sjell ai. Po neve mos na
bjer më qafë, të kemi rixha. Na lini në hallin tonë,
në keni besuar perëndi!

Xhemil beu kërceu përpjetë.

— Ti, Izet Bregu, ke armë!

— Në kam, urdhëro e merre zotrote.

Fjalët u ashpërsuan. Togeri fashist, një buku-
rosh me faqet tul e të pudrosura, që kur vinte buzën
në gaz me ironi i bëheshin dy gropëza, ndoqi grin-
djen me gatishmëri dhe priti për një kohë t'i thoshte
beu, po pastaj urdhëroi:

— Hidhini prangat!

Karabinierët e vunë në mes Izetin e i lidhën duart.

Mirka e kishte dëgjuar sa herë të atin të thoshte: «ne do t'u rrimë armiqve me grusht hundëve»! Po ata qenë shumë.

— Baba! Baba!... — u lebetit vogëlushja e, duke vrapuar të shkonte pranë t'et, u rrökullis nëpër këmbët e karabinierëve. Ata e shtynë me majat e çizmeve. Një karabinier, që asaj i qe dukur zemërbutë e shpirt-njeriu, e kapi me neveri me maja të gishtave dhe e shtyu aq fort, sa e përplasi me hundë përdhe. Pastaj urdhëroi kryeplakun:

— Largoji këta pisa! — tha edhe përfëmijët e tjerë.

Mirka u çua dhe tani, ata sy që pak më parë i qenë dukur aq të ngrohtë, ishin skuqur nga zemërimi e qenë egërsuar si sy bishe. Ja edhe duart e tij, që mund të kishin bërë ato lule në filxhanët, Mirkës i ngjanin si putra ariu.

— Nënë, moj! Babanë!... — thirri ajo fort.

Nga dyert e dritaret u dëgjuan zëra grash:

— Mos u tremb, mos u tremb! — Pastaj shtuan:
— Të keqen do na marrin!

Armë nuk u dorëzua asnje.

— Të fillojë kontrolli.

Kështu tha togeri dhe nxori një listë emrash. Karabinierët u ndanë nga pesë e nga pesë në katër grupe.

Zdapi i bëshëm me mjekër ishte në krye të grupit që shkoi për kontroll në shtëpinë e Izet Bregut. Me ta ishte dhe karabinieri që e plasi Mirkën përdhe me aq neveri.

— Nënëëëë... po vijnë!

— Le tē vijnë, xhan i nënës.

«Me grusht hundëve», iu kujtua Mirkës e pa grushtet e saj tē vogla mbledhur. Pa edhe duart me lëkurë tē ashpëruar tē nënës. Po ku dëgjonte zdapi i bëshëm nga ato grushte!

Çdo gjë u përmbyss në shtëpinë e Farijes. Ajo, më këmbë, me vajzën pér dore, shikonte si thyheshin poçet me lule, si plaseshin përtokë sahanë e kusi... Sytë iu mjegulluan.

Në fund zdapi deshi tē kontrollonte strehët. Hipi mbi sënduk e rëndoi me duar buzë serjenit, që u shqye sakaq, sikur tē qe ngjitur në mur me baltë e jo sikur qe mbërthyer me gozhdë. Gjithë ç'qenë në serjen, ranë përdhe e u bënë copë e çikë. Farijes atë kohë iu bë sikur i ra njeri me forcë në shesh tē kokës.

E përmendi zëri me tasari Mirkës:

— Nënë, filxhanët! — dhe u shkëput nga dora e s'ëmës, mbushi duart me qelqe tē thyera e copëra filxhanësh e ia plasi syve zdapit. Duart e saj tē vogla u çanë nga xhamat e rrodhën gjak.

Zdapi mbuloi fytyrën me duar, u thye më dysh, si i këputur në mes dhe, duke u rrotulluar rrëth vetes, zuri tē ulërinte në gjuhën e vet:

— Ajuto!... Ajuto!... Ajuto!...¹⁾ Më vërbuan!... I mjeri unë!...

Në tullat e ashefit u bë një rrëth gjaku.

Të gjitha këto ndodhën në një çast. Karabinierët e tjerë ishin duke kontrolluar në kasollen e gjësë së gjallë. Farija e kuptoi rrezikun. Rrëmbeu Mirkën, doli në oborr, e pati mendjen sa t'u mbyllte derën nga jashtë fashistëve dhe me çupën në krahë u bë erë mur më mur e gardh më gardh, pér t'u larguar sa më shumë nga fshati e pér t'u fshehur...

1) Ndihmë!...

... Larg fshatit, e fshehur me çupën në një përrua, Farija i lau asaj duart dhe me një rrip lecke që grisi nga fundi i linjës, filloi t'ia lidhte.

— Nënë!

— Bijë e nënës!

— Karabinierët tanë u bënë zotër të shtëpisë sonë?

Mirka fliste me atë gjuhë, si kishte dëgjuar të flisnin të rriturit, e ngashërohej. Buza i qe bërë si lulja e manushaqes e i dridhej.

— Jo, zemër. Shtëpia është jona. Ne nuk do t'i lëmë.

— Ata na i thyen të gjitha!

Dhe solli ndër mend çastin kur zdapi kishte shkelur me këmbë një nga filxhanët që pati shpëtuar pa u thyer. «Kërrr» kishte bërë filxhani. Mirkës i qe dukur atë çast sikur krisën eshtrat e saj nën atë këmbë aq të madhe. Pikërisht atëherë ajo qe shkëputur nga pëqiri i s'ëmës dhe i qe sulur fashistit.

— Do të të blejë nëna jote të tjerë, moj shpirt.

— Kur do t'i blesh?

— Kur t'i përzëmë fashistët.

— Po babanë ata na e lidhën me hekura, moj nënë!... Ata lidhën gjithë ata burra!

— Do t'i këputin zinxhirët, edhe babai, edhe të gjithë burrat e tjerë, moj zemër e nënës.

Në shpatin përkundrejt u dukën karabinierët fashistë, që po iknin nga Kodrasi pér në fshatrat e tjera. Varg, njëri pas tjetrit, në njëshkolonë, ata du keshin sikur kushedi sa qenë. Nga rruga tjetër që të çonte pér në qendrën e komunës, ku qe edhe komanda e postës lokale të karabinierisë, u panë shtatë burra të fshatit, të vënë edhe ata në njëshkolonë e me karabinierë përpara e pas. Ata po i çonin në burg.

Duke ecur, Izeti u pëshpëriti shokëve:

— Një burrë i lidhur, nuk është as sa një fëmi-jë, or vëllezër.

— Drejt e ke, po si të bëjmë, o Izet!?

— Kur të hyjmë tek ahet e Çamos, unë do të arratisem.

— Do të të bien që pas!

— E kam bërë atë hesap. Do të dredhoj te Shtegu i Qarrit. Pas pesë çapësh atje futesh nën gurët e çarë dhe, po arrita të futem atje, më bëjnë mashalla.

Farija dhe Mirka i panë burrat që nga larg. Çupa e vogël e njoihu të atin. U drodh e tëra dhe zuri nënën nga duart.

— Nënë, e morën babanë!

— Babai do të vijë prapë, mos ki merak.

— Do t'i këpusë hekurat babai, nënë, do t'i këpusë! — përsëriti vogëlushja fjalët e Farijes, me po atë besim që i pati thënë e ëma dhe i nguli sytë në ata të Farijes.

— Po, moj zemër, do t'i këpusë, — i thanë përsëri sytë e nënës.

ZEMRA TË MËDHA

n o v e l ë

I

*Citjanezezat me tumba,
zemërrahurat me plumbë;
Citjanezezat me pika,
zemërrahurat me thika.*

POPULLI

Një njeri i shtrirë në kurriz në mes të konakut. Nën të nuk di q'i kanë shtruar. Kokën ia kanë mbështetur në jastëk. Mbi të i kanë hedhur diçka të kuqe, — nuk di në ishte jorgan apo ndonjë velenxë, — që e mbulonte nga maja e mjekrës e gjer në fund të këmbëve. Fytyrën ia mbanin gjysmë zbuluar dhe sytë e tij, të hapur përgjysmë, të vështronin me ngulm, pa i prapulizur qepallat, gjë që të fuste fri-

kën. Nëna qante dhe ulerinte me kryet mbështetur mbi kraharorin e njeriut të shtrirë. Kohë më kohë ajo ia zbulonte krejt ftyrën, ia lante me lot; i zbulonte kraharorin e ulerinte: «Vëlla, ku i ke plagët, të t'i shohë motra!» Rreth e qark konakut plot gra, të ulura shesh, veshur me të zeza e me nga një çember të bardhë, hedhur në kokë e të lidhur nën gushë, qanin kush me zë, kush shkrihej vetëm në lot. Herë pas here ndonjëra tregonte me kokë time ëmë e urdhëronte: «Hiqeni korbën, se plasi!» Atëherë ngriheshin dy-tri prej tyre, i shkonin pranë duke fshirë lötët, e zinin nga krahet e i luteshin: «Mjaft, mjaft, moj korbë!» Po nëna nuk ishte e mundur të shkulej nga njeriu i shtrirë në mes të konakut. Përbys mbi kraharorin e tij, ajo ulerinte e lutej: «Më lini, më lini t'i lehtësoj plagët! Më lini t'i lehtësoj dhëmbjet!» Pastaj vajtonte. «Si nuk u tha ajo dörë që të goditi, o vëlla! Si nuk u bënë ujë ata plumba që të shpuan trupin e bukur, o vëlla! Ty motra të kishte gjetur nusen, o vëlla! Ty motra do të të martonte e do të të gëzonte, o vëlla! Ti do të më bëheshe me një vatër fëmijë, o vëlla! Dora që të vrua ty mos mbajtë fëmijë në prehër kurrë, o vëlla! Në atë shtëpi mos u tundtë djepe kurrë, o vëlla! mos u bëftë dasmë kurrë, o vëlla! Mbettë shkretë e këndofshin kukumjaçkat mbi gërmadhat e saj, o vëlla!» Erdhën dy-tri herë me radhë edhe burra për ta shkulur nënën nga trupi i vëllait të shtrirë në mes të konakut, por edhe ata nuk mundën, gjersa një plakë që rrinte në kënd u tha më në fund! «Lëreni, lëreni korbën motër të qajë divin!»

Unë isha e vogël. Sa vjeçë mund të isha, nuk e di, por duhet të kem qenë shumë e vogël, sepse përvèç këtyre nuk mbaj mend asgjë më tepër. Nuk

mbaj mend si erdhi mandata në shtëpi, nga ç'rrugë kaluam për të vajtur te dera e babës së nënës, nuk mbaj mend varrimin. Vetëm mbaj mend si rrija në këmbë te dera e konakut ku ishin gratë, si qaja duke parë nënën që ulërinte dhe se si nuk kujdesej asnjëri për mua të më largonte e të më pushonte nga të qarat.

Përpara kësaj ngjarjeje nuk mbaj mend asgjë e nuk kam asnjë kujtim tjetër të ëmbël, ose të hidhur, të fëmijërisë sime. Dhe që nga ajo kohë nënën e mbaj mend vetëm duke qarë. Edhe tani që jam nënë vetë, pyes shpesh me vete: «Ku i kishte e shkreta nënë gjithë ato lot?!» Babai ngruhej që me natë e shkonte në punë. Ai kthehej në darkë vonë. Vëllai, sa ishte i vogël, rrinte më shumë përjashta me shokët. Kur u rrit ca, e merrte babai me vete, ose shkonte ruante lopën apo kecat. Gjyshja shkonte nga kopshti. Kur ngrihesha unë, nëna ishte vetëm në shtëpi, herë duke tundur kosin, herë duke gatuar në magje, herë duke larë rroba, apo duke arnuar. Dhe, duke punuar, qante. Qante pa zë e lotët i shkonin çurg, i mblidheshin në majë të mjekrës e prej andej i pikonin përdhe. Herë-herë e dëgjoja tek vajtonte ngadalë: «Vëllai i motrës! Divi i motrës!», ose tek mallkonte: «U thaftë ai krah! U nxiroftë ajo shtëpi!» E shikoja ashtu e më dhimbsej. Më bëhej një ngulç në grykë, një lëmsh i rëndë plumb në fund të kraharorit. Kisha shumë uri kur ngrihesha nga gjumi, por edhe oreksi më pritej, duke parë nënën në atë gjendje, dhe strukësha në ndonjë vend e vuaja, duke mos ditur ç'të bëja e si ta ndihmoja. Për një kohë nuk dija as shkakun e atij të qari e mblidhesha sa një grusht e pikëlluar. Duke punuar e duke ardhur rrëth, më në fund nëna më vinte re, fshinte lotët, nganjëherë edhe më për-

gëzonte, më vinte përpara sahanin me përshest me dhallë, ose me trahana, po të ishte dimër, dhe më thoshte: «Ha, shpirti i nënës, ha». Kur nuk më vinte re, duroja sa duroja, e pastaj, nga dhimbsuria për të, ia kërcisja edhe unë të qarit. Atëherë ajo, me të më diktuar, më vinte pranë shpejt e shpejt, më merrte me të mirë, më pushonte duke folur me vete: «Qaj, moj e zezë, qaj edhe ti për atë dajo që kishe!» e, pasi më jepte mëngjesin, më thoshte: «Shko, shpirti i nokës, shko përjashta, loz.»

Dilja jashtë e shkoja drejt e te gjyshja në kopsht. E gjeja duke punuar me bel, duke mbjellë, duke prashitur, apo duke harrur barërat e këqija. Kjo varej nga stina. I shkoja pranë, e kapja nga pëqinjtë e i thosha: «Nokja po qan!» Ia thosha këtë që ajo të dhimbsurohej e të shkonte ta pushonte. Gjyshja drejtonte trupin, njérën dorë e vinte në bel, me tjetrën mbështetej pas belit ose shatit, e treste vështrimin diku malit përkundrejt, nxirrte një psherëtimë të thellë dhe më fliste pa më vështruar, si një të madheje.

— E di, moj bijë, e di, po ç't'i bëj?! Ajo nuk duhet lënë vetëm, se, po ta lësh, atë zanat do të bëjë! U shkri, e zeza, u shkri!

Shumë herë gjyshja e linte punën e shkontakte brenda.

— Mjaft, se zvetëtove fëmijët! Nuk të vjen keq për këtë foshnjë?! E pse bën ti kështu, a fiton gjë! Jo!

Por në raste të tjera, kur kishim radhën për të ujitur, kur qepët e hudhrat duheshin prashitur medemos sa më parë, se u kishte hipur bari, kur fidanët e domateve apo të lakerarmeve duheshin mbjellë një orë e më parë, gjyshja më dëgjonte, ofshante

me një dhimbje e rënkim të thellë, diçka mërmëriste me vete, por nuk e linte punën.

Vazhdoi kështu mjaft kohë, gjersa një pranverë doli edhe nëna të punonte kopshtet; jo se prishi zinë, sepse unë në fëmijérinë time kurrë nuk e mbaj mend të ketë kënduar, por se e këshilloi babai një mbrëmje, kur ishin ata të dy vetëm në hajatin përpara shtëpive, dhe unë i isha ulur nënës pranë pëqinjve: «Ajo, — babai e kishte fjalën për gjyshen, — ti e sheh vetë që nuk ka më fuqi. Kopshti është qilari i shtëpisë, o grua!»

Nëna ishte e gjatë, gati bojë e parë. Shtatin e kishte të bukur. Belin e kishte të hollë si për rrithunaze. Kur ecte, i kishte aq hije, saqë gjyshja, tek e shihte të vinte me dy shtëmbat në duar e me njérën në kokë, thoshte gjithë admirim: «Po vjen sorkadhja e nënës». Sytë si bajame i kishte të zinj sterri. Vetullat të holla, edhe ato të zeza e të harkuara si çark. Faqet të kuqe flakë e lëkurën e fytyrës të bardhë qu-mësht. Kishte dy fëmijë e nuk ishte prishur fare. Babai nga shtati ishte sa dhe nëna i gjatë, po nuk ishte i bukur si ajo. Ai kishte eshtër të trashë. Unë, e vogël, e zija me të dyja duart në qafën e dorës dhe gishtat e mi nuk puqeshin. Ishte leshtor. Vetullat të trasha, mjekrën të dendur e të ashpër si drizë. Nofullat të mëdha. Kur rrinin të dy me nënën në hajat, i vështroja e, megjithëse babai, siç thashë, nuk ishte i bukur, më kujtohet si tani, nuk e di pse gëzoja që nokja ime aq e bukur kishte një burrë si babanë, që nuk i shëmbëllente asnjë tjetër nga burrat e fshatit. Gjyshja ishte eshtake dhe ajo, asaj i ngjante babai; më tepër ngjante si burrë se si grua. Kur vinin miq, shtrohej në raki me burrat. Piste e ngrinte dollitë si ata dhe ia thoshte burrërishte:

*O Memet, deli Memet,
gjashtë plagë mbi vezmet!
Këto çupat e Përmetit
prenë leshin e gërs hetit,
për t'i zënë gjakun Memetit.*

.

Kurrë nuk e pata dëgjuar të këndonte si gratë. Edhe kur ishte midis tyre, u bënte hije të gjithave. Po të fliste ajo, asnjë tjetër nuk guxonë t'ia priste fjalën në mes. Fjala e saj, në biseda të ndryshme, ishte «kapak floriri»; kështu thoshin të gjithë për të në fshat. Dhe mençuria e saj hynte thellë në shpirtin e njerezve. Me time më kurrë nuk i pata dëgjuar të grindeshin apo të haheshin ndonjëherë me fjalë. Të dyja edhe e donin, edhe e nderonin shoqja-shoqen. Sa kohë që nëna ishte e përzishme e nuk doli përjashta për të punuar, gjyshja nuk i tha asnjë gjysmë fjale. Edhe prapa krahëve të saj kurrë nuk e pata dëgjuar të ankohej sadopak, vetëm se në çdo rast shprehte dhimbje për të, siç bënte edhe kur e kishte përparsa syve.

Atëherë ne ishim në gjendje të vështirë. Toka nuk na mjaftonte për bukë. Vinte prilli e maji e misri na mbarohej. Gjersa binte drapi e korreshin të lashatat, jetonim sa me hua, sa duke shitur ndonjë bagëti të imtë, që i kishim të pakta, dhe blinim misër në pazar. Megjithatë, edhe pse i varfër, babai ishte burrë me hije në fshat. Të gjithë e nderonin. Kur mblidhej fshati për të caktuar ditën që do të lëshonin bagëtitë në kullotat e përbashkëta, për punë të tjera të këtij lloji, ose kur i duhej dhënë përgjigje qeverisë

për kërkjesat e saj, që nuk kishin të mbaruar kurrë: taksa për bagëtitë, taksa për malin, për rrugën automobilistike Berat-Çorovodë, që nuk u bë kurrë, fjalë e babait ngrinte peshë dhe, pa folur ai, nuk merrjej asnjë vendim.

Babai ishte njeri i ndershëm. Kurrë nuk shante njeri prapa krahëve. Ç'kishte, ia thoshte tjetrit në sy. Vëllanë e kishte vëlla, shokun shok, mikun mik dhe linte edhe kokën për ta, kur e donte puna. Një kile misër, apo pesë lekë po të kishte në xhep, i ndante me shokun e mikun, po t'i shihte ngushtë. «Aliu, po të kesh litarin në grykë, ta pret e nuk të bën sehir», thoshin për babanë kur binte fjalë. Njeri i sherrit në vëllazëri e në fshat nuk ishte. Përkundrazi, po të hynte ai në mes, do të mbyllej në paqe çdo sherr nga të dyja palët që grindeshin. Fjalën e dhënë nuk e dredhonë kurrrë. Borxhet që merrte, ose do t'i shlyente në ditën e caktuar, ose nuk kishte si bëhej ndryshe. Pastaj, ai ishte edhe njeri me kurajë të madhe e trim. Kur ishte rreziku i shovinistëve grekë, pas ngritjes së flamurit në Vlorë, e kur ishte nënprefekt Mihal Gramenoja në Çorovodë, ai la bagëtinë në mal, rrëmbeu pushkën e shkoi me shokët të luftonte. Dy-tre vjet më vonë, kur erdhën andartët grekë përsëri në Shqipëri, ai vetë i dhjetë zuri Qafën e Gostrënckës, luftoi atje, u plagos, dhe andartët, që ishin më se njëqind e pesëdhjetë vetë, nuk bënë dot më këmbë. Me Riza Cerovën, Muço Kapinovën, Myrto Cerovën e të tjerë, ai ishte moshatar. Ata e kishin dashur si vëlla. Me ta pati mbrojtur punimet e Kongresit të Lushnjës, luftoi në Vlorë më 1920-ën për të hedhur Italinë në det, në Shkallën e Tujanit, në dhjetor të 1924--ës, kur forcat e Ahmet Zogut hynë në Shqipëri. Pastaj, ai e të tjerë i strehuan Riza Cero-

vën e Muço Kapinovën ilegalë gjashtë muaj me radhë, gjersa më në fund ata vendosën të arratiseshin jashtë e i përçolli gjer në kufi. Por për këto ai kurrë nuk hapte gojë. Prandaj, edhe pse kishte pleq në fshatin tonë, fjala e babait do të ishte gjithnjë guri i qoshes.

Disa ndodhira me babanë.

Kur erdhi Zogu në Shqipëri e u bë mbret, krahët e bejlerëve u ngrohën nga e mërdhishura që u pati hyrë më parë. Asokohe bejlerët e fshatit tonë, fsheherazi e me ndihmën e gjykatësit e të nënprefektit të Çorovodës, nxorën tapitë me dëshmimtarë të rremë dhe e hodhën malin mbi vete, e bënë pronë të tyre, kurse në të vërtetë, mali ishte pronë e fshatit. Kur erdhi vera, bejlerët na ndaluan të kullotnim gjënë e gjallë në mal. U mblodhën fshati dhe thirrën edhe bejlerët. Erdhën më plaku i tyre e disa të tjerë. U hengrën e u grinë me fjalë, porse bejlerët nuk hiqnin dorë. «Mali është yni denbabaden. E kemi me tapi,» cirrej e ngjirej beu i madh. Babai nuk kishte folur asnjë fjalë gjer në këtë kohë. Më në fund u ngrit e i tha beut: «Ku i ke ato tapitë, or bej, na i nxirr t'i shohim, që t'ju besojmë». Beu futi dorën në xhep e nxori dokumentet. Babai atëherë iu afrua e i tha: «M'i jep t'ua këndoja këtyre shokëve, që të bindemi të gjithë». Dhe, pa pritur që beu t'ia jepte vetë, ia rrëmbeu nga dora, i bëri copë e çikë, i shkeli me këmbë, pastaj u kthye nga fshati: «Ne, vëllezër, sot do të ngjitim gjënë e gjallë në mal. Bejlerët, po të duan, le të vijnë përsëri të na i përzënë». Që nga kjo kohë, kur binte fjala, të gjithë në fshatin tonë thoshin: «Në kemi

mal sot, këtë e kemi nga Ali Vigani, se, po të mos qe ai, për pak e na rrëmbyen bejlerët».

Kur m'i tregonte gjyshja këto e të tjera të ngjashme, si ai rasti kur kapteri i xhandarmërisë i kishte marrë lopën me viç të njomë nga katoi xha Kasëmit, sepse nuk kishte paguar taksat, e babai i kishte dalë përpara, i kishte rrëmbyer kapterit lopën nga dora, unë, e gëzuar, i bija gjurit tim me grush-tin e vogël e thërrisja: «Hë, sa mirë ua ka punuar!» Gjyshja atë kohë m'i ngulte sytë si të zbulonte tek unë diçka të re, që s'i kishte rënë në sy më parë.

Në këtë kohë nuk isha aq e vogël, sa të mos i kuptoja shumë gjëra. Tani e dija se ai njeriu i shtrirë në mes të konakut, mbi të cilin qante atëherë nëna me aq ulërima e kujë, ishte daja im, i vogli, që e kishin vrarë bejlerët ditën që kishte mbushur njëzet vjeç. I kuptoja tani edhe lotët e pashtershëm të nënës, ashtu sikundër e kuptoja edhe përsë ajo, kur binte fjala për bejlerët, nuk ua zinte kurrë në gojë emrin, por thoshte për ta «ata të sterrosurit». E kuptova edhe pse e mbylli përgjithmonë dritaren e shtëpisë sonë, që shikonte nga shtëpitë e bejlerëve të fshatit. Megjithëqë nuk ishin ata vrasësit e dajë Qemalit, për nënën «të gjithë derrat një turi kishin», dhe emrin bej e fytyrë beu ajo as donte ta zinte në gojë, as donte ta shihte me sy.

Kështu, dhimbja aq e madhe për noken, tek e shihja që qante me aq ngashërimë, tani më pati ndezur një urrejtje po aq të madhe për bejlerët, sa ishte edhe vetë dhimbja. Sepse lotët e saj nuk kishin rënë në tokë e nuk i kishte pirë dheu, po kishin rënë në zemrën time të njomë, kishin mbushur plot hidhërim atë e gjakun tim, në një kohë kur unë doja të më merrte nëna në prehër, të më puthë,

të më përgëzonte, t'u gëzohesha atyre syve të bukur të saj. Por unë nuk i shijova dot këto. Prandaj, vuante, edhe për mua, që nuk më ngrohu në foshnjërinë tîme me frymën e nënës së gëzuar, edhe nga plaga e pambyllur e vëllait.

II

Isha goxha e rritur atëherë, kur iu luta gjyshes të më tregonte si e përse e vranë bejlerët dajë Qemalin. Ishim ulur të dyja në fund të kopshtit. Unë kisha marrë domate të freskëta e gjizë të njomë e po haja me uri, kurse gjyshja po çlodhej pas prashitjes. Ishim ulur nën hijen e një fiku. Qielli ishte i kaltër si xham. Dielli, që i ishte afruar kupës së qiellit, ngrohte me forcë. Mua se si më shkuam sytë nga mali i Koshnicës, prapa të cilit ishte fshati i nënës. M'u kujtua gjithë ajo që më ishte ngulitur kur dajë Qemali i vrarë qëndronte në mes të konakut, lotët e nënës që ndoqën tërë fëmijërinë time, dhe mendova se rast më të mirë nuk kisha për të mësuar shkakun e vrasjes.

Gjyshja më vështroi plot sytë e me ngulm për

një çast. Ajo dukej sikur pyeste me vete: «A është bërë kjo fëmijë sa t'i tregoj fije e pér pe?» Kushedi ç'iu kujtua. Ndofta fëmijëria e saj. Më fërkoi kokën ashtu si dinë vetëm gjyshet dhe, pasi më vështroi përsëri plot sytë, më tha: «Ti nga bukuria i ngjan sat ëme, po nga të tjerat më ngjan mua». Mënyra si m'i tha këto fjalë, më kujtohet si tani, më bëri të kuptoja se me to donte të më thoshte: «Ti je bërë tani tamam e unë do të flas sot me ty si me një të madhe». Pastaj filloj:

— Ishte vjeshtë, moj bijë, si tani. Ja, më njëzet të këtij muaji mbushen plot pesë vjet që është vrarë i ziu yt ungj, Qemali.

— Gjyshe, unë e mbaj mend.

Ajo u mendua pér një çast me shikimin në zbrazëtirë. «Pooo, — tha me zë të zgjatur, — i vogli mban mend shumë». Pastaj vazhdoi:

— Ishte koha që do të mbillej gruri, moj bijë. Gjyshi yt në Arrishtë pak dhé kishte pér bukë. Gjysmat e arave ishin të beut të Arrishtës. Asllan beu i kishte dërguar lajm tët gjyshi të mos i punonte arat e tij, se ia kishte dhënë një tjetri. Yt gjyshi i tha: «Kemi katër-pesë breza, or bej, që e punojmë këtë tokë. Gjysmën që të takon, ta kemi dhënë në rregull vit pér vit. Përse të më përzësh tani nga malli? Me se do t'i ushqej fëmijët unë?»

— Po pse donte ta përzinte, gjyshe?

— Ashtu ishte një punë dhe Asllan beu kishte marrë inat me tët gjysh e tët ungjër, — ma preu shkurt.

(Atë ditë e pér disa vite me radhë, unë nuk e mësova shkakun e inatit të beut. Shumë më vonë ma tregoi po gjyshja: «Tezja jote, ajo më e vogla, ishte e bukur, t'i rrëmbeje kokën. Asllan beut i

kishte vajtur syri në të. Mirëpo i hasi sharra në gozhdë dhe nga ai inat vendosi ta nxirrte nga malli tét gjysh.»).

Unë e kuptova se, sado të ngulja këmbë, gjyshja nuk do të më fliste më shumë pér punën e inatit të beut. Ia dija mirë zakonin. Po të thoshte «jo» një herë, ishte e kotë t'i luteshe. Dhe e lashë të tregonte.

— Atë ditë që u vra, i ziu yt ungj, u ngrit që në mëngjes, bëri gati qe e farë dhe do të nisej të mbillte. Yt gjysh ishte i sëmurë. E thirri të mjerin Qemal atje në konakun ku ishte rënë. «Po të thashë, or bir, edhe mbrëmë! — i tha. — Mos shko të mbjellësh. Prit sa të ngrihem unë. Ta shoshitim punën me beun, pastaj...». «Baba, éshtë kohë zjarri tani. Shokët i kanë mbjellë gjysmat e të lashtave. — Ia priti i ziu djalë. — Pastaj, dëgjo, baba, kaq ta bëjë dhëmbin beu, ne nuk dalim nga malli. Kemi borxh t'i japim gjysmën që i takon. Kemi dyqind vjet që e punojmë atë mall. Më shumë kemi derdhur ne djersë në ato ara, sesa ka rënë shi në to.» «Mirë, or bir, mirë, të drejtë ke, — i tha yt gjysh, — po hap sytë se éshtë ballësamar ai qen». Shkoi djalit në arë, mbrehu qetë e mbolli gjer afër drekës. Në këtë kohë, Asllan beu, që kishte dalë pér gjah atij krahu, e kishte parë që larg dhe i vete të ziut Qemal në arë. «Zbërthe qetë!» — i sokëlliu djalit. «Pse t'i zbërthej, o bej?» «Psenë e di unë!» «E di ti, po dua ta di edhe unë». I ziu Qemal e dinte shkakun e zemërimit të tij dhe kishte kohë që e hante nëpër bark pér të shfryrë dufin. «Zbërthe qetë, harbut i m...!» — e shau beu. «Unë nuk i çmbreh qetë, — ia pret i mjeri djalë. — Ti, po ta mbajti, çmbrehi! Ja ku janë!» Dhe, «oha, Kazil! Oha, Balash!», —

u thërret qeve e ata heqin përpara. Beu çmendet nga inati. «Një copë harbut të më bëjë mua zhele!» U del qeve përpara. Çiften e ka në krah dhe koburen tetëshe austriake në brez. «Hapu rrugën qeve, mor qen bir qeni!» — i thërret Qemali dhe i lëshohet me hosten në dorë. I jep një të goditur dhe beun e mbulon gjaku. Ishte djalë i shëndoshë, i ziu Qemal. Katër burra nuk e vinin dot poshtë. Po ta kishte marrë mirë herën e parë, ose po t'ia kishte arritur ta godiste edhe një herë, e mposhti beun e shkoi e vate, megjithëse dhe ai nuk ishte i pakët, si derr ishte. Mirëpo beu, sa ia arriti, u tërhoq praptazi e nxori koburen. E goditi një herë, dy, tri... I ziu Qemal nuk binte lehtë. Me tri plagë në gjoks e prapëseprapë e ndjek me hosten në dorë. Beu tërhiqet akoma praptazi e vazhdon t'i bjerë. Tetë plagë në gjoks djali dhe akoma në këmbë. Kur mori të nëntën, atëherë iu prenë fuqitë, bëri edhe tri-katër çape, hoqi qylafin, e vuri nën kokë e u shtri në brinjë, në mes të arës, si ndonjë div, sikur do të flinte...

Gjer në një farë pike unë durova, po pastaj fillova të qaja me «ëhe». Gjyshja nuk më tha as «qaj» as «mos qaj». Vetëm si kishte mbaruar së treguari, më fërkoi kokën e më tha: «Ngrehu tani, shpirti i gjyshes, të harrim këto nenë, se i kanë zënë frymën kopshtit». Dhe, kur e pa se unë harrja e qaja, më tha për të më ngushëlluar: «Do t'ia marrim hakun tët ungji, do t'ia marrim».

* * *

Që nga ai çast unë fillova të kuptoja shumë gjëra: Kushedi sa herë kisha vënë re që babai hum-

biste ditë të tëra me radhë. Ikte në mes të natës nga shtëpia. Herë-herë pasi hante edhe darkën. Qëllonte që, nga ara ku punonte, nuk kthehej fare në shtëpi, po dërgonte lajm: «sot nuk do të vij» dhe humbiste. Shumë herë, para se të largohej, ose do të trokiste dikush tri herë në dritare natën, ose do të dukej te ne ndonjë nga njerëzit e nënës pesë minuta në këmbë e do të ikte. Ndodhë që vinte dhe ndonjë tjeter, që unë nuk e njihja. Kur pyesnin nënën apo gjyshen, në këso rastesh, njerëz të lagjes ose nga fshati: «Ku është Aliu?», ato përgjigjeshin: «Ka vajtur të nxjerrë pishë në mal», «Ka vajtur të bluajë në mulli», «Ka vajtur në pazar», «Kemi mbetur pa bukë e shkoi të gjejë ndonjë çikë misër hua», e të tjera si këto. Unë e shikoja se, kur kthehej, po natën gjithmonë, dimër ose verë të ishte, babai vinte me gunën hedhur krahëve dhe, para se të hynte brenda, dilte nga prapa shtëpisë e trokiste tri herë. Në atë kohë ngriheshin nëna ose gjyshja, i hiqnin llozin derës e ai hynte i ngrysur. «Nuk bëtë gjë?» Gjithmonë këtë pyetje i bënin, pa u pëershëndetur fare. Dhe ai përgjigjej: «Nuk futet kollaj qeni në pritë», ose: «Na shpëtoi gjarpri edhe këtë radhë». Pastaj, si hante bukë me uri, si i babëzitur, nëna e gjyshja e pyesnin dhe unë që poshtë mbulesës dëgjoja shprehje të shkëputura: «...E ruajtëm tetë ditë e tetë net mbi çatinë e shtëpive të Selmanit, kishim hapur nga një mazgallë dhe, nuk do të na shpëtonte, po nuk dilte qeni!» «...Dy prita i bëmë, po nuk kaloi andej nga e pritëm». Një herë e dëgjova që tha: «...Këtë radhë ia zumë mu mbi shtëpitë. Mirëpo nuk del pa rënë dielli mirë. Edhe kur del, lëshon qentë më përpara, e kontrollojnë ata mi-rë vendin, pastaj del.»

Pasi hante bukë, babai ngrihej, merrte maliherin e shkurtër, që e varte nën gunë gjithmonë dhe, pasi e mbështillte me një mushama, e fuste në një kërcu lisi të bërë si govatë, mbyllte të dyja pjesët e kërcurit, i mbërthente me gozhdë dhe nuk kuptohej asgjë.

Pra, po të humbiste babai nga shtëpia, unë e dija që ai do të ishte në pritë bashkë me gjyshin e dajat e tjerë. Duke e pritur të kthehej, nuk më zinte gjumi natën. Heshturazi prisja që ai të hynte i qeshur e të sillte sihariqin: «Mbaroi qeni». As nënës, as gjyshes nuk guxoja t'u thosha se i dija të gjitha, se i kuptoja të gjitha. Kur mungonte babai, edhe ato bëheshin të heshtura me njëra-tjetren. Po unë as me tim vëlla, Bashkimin, që ishte pesë vjeç më i madh, nuk guxoja të hapesha. Edhe ai më kishte kuptuar që unë tanë kisha rënë në erë të çdo gjëje, por nuk e hapte gojën. Një ditë prej ditësh guxova e i thashë: «Bashkim, unë e di pse erdhi dajë Kamberi mbrëmë e ku kanë vajtur». Ai më shikoi me ca sy, sikur do të më përpinte të gjallë e më kërcënoi: «Po e hape gojën, ta pres kokën me këtë sëpatë!». Pastaj vajti e u tregoi nënës e gjyshes. Nëna m'u shkreh: «Shtrigë!» Po gjyshja i doli përpara dhe i tha: «Lëre çupën! Ajo është tamam tanë. Kur isha unë kaq sa kjo, e dija edhe të mirën edhe të ligën». Me kaq u mbyll çdo gjë. Në më ka mbetur aq e dashur e shkreta gjyshe për shumë e shumë gjëra, një nga ato është për besimin që shfaqte ndaj meje, edhe pse isha e vogël.

Po atë ditë, kur donte edhe dy-tri orë pa të perëndonte dielli, erdhi babai me një kalë, ngarkuar me misër. Kaloi përmes fshatit, doli në krye të lëmit dhe që atje i bëri një shenjë me dorë nënës,

që ishte duke punuar në kopsht. Nëna la belin, mblo-dhi pëqinjtë e brodhi, hyri brenda me vrap, iu hodh gjyshes në qafë e që të dyja zunë të puthnin njëra-tjetrën duke qarë. Erdhi babai në oborr, shkarkoi kalin e hyri brenda. Mua dhe Bashkimin nuk na la të hynim në shtëpi. Pasi futëm kalin në katua, *nxituam prapa* shtëpisë e po përgjonim nëpër një të çarë të dritares. Me të hyrë babai në konakun e zjarrit, nëna iu lëshua si shqipe e po i puthe duart. Gjyshja e përqafoi fort. Ai qëndronte në këmbë me një hije burrërore, që edhe sot më ka mbetur ndër sy.

— E qëruat halenë?

— Nuk e di, o nënë. I ramë të katër njëherësh. «Më vranë!», thirri vroma dhe pela e tij u bë veri. Pusinë ia kishim zënë afër. Megjithëse ishte errë-sirë, pus, nuk besoj të na ketë shpëtuar.

— Pse nuk i ratë prapë? — pyeti nënë.

Babai, duke folur gjithnjë me gjyshen, vazhdoi:

— Nuk i ramë dot pér së dyti, sepse e largoi pela shumë dhe ajo e shkreta patickë e Qemalit bën shumë flakë. Pas flakës së saj, trimat e beat u hodhën menjëherë, zunë nga një gur e na e dhanë «pam, pam». Nuk duhej zgjatur. U ngritëm e ikëm, veçse ai qeni nuk ishte më mbi pelë, se ku kishte rënë e, në ra i gjallë apo i vdekur... — Babai nuk e mbaroi fjalën, vetëm u mjaftua të shfaqte dyshimin, duke ngritur supet.

— Po tani si do të bëhet? — pyeti gjyshja. Në pyetjen e saj nënkuptoheshin masat e qeverisë.

— Nuk kanë q'na bëjnë. Unë, pas «dasmës», shkova te Rushiti në Gramsh, e ai dhe e gjithë vëllezëria e tij do të vërtetojnë se unë kam qenë tek ai mbrëmë pér darkë, ku hëngrem, pimë e kënduam

gjithë natën. Unë, «që kisha vajtur tek ai për një qase misër hua», u ngrita sot në mëngjes, ngarkova misrin në kalin e Qamilit e erdha në mes të ditës në shtëpi.

— Po për ata të mitë në Arrishtë? — pyeti nëna.

— Për ata do të vërtetojë gjithë fshati se kanë qenë në shtëpi. Do të thonë se tek yt atë mbrëmë ka pasur gosti, për t'i vënë emrin djalit dhe se gjysma e fshatit kanë qenë për darkë atje. Janë marrë ato masa, — tha babai më në fund. — Nuk na e vërtetojnë dot. Do të na thérresin, mund edhe të na burgosin, po nuk do të kenë prova. E ç'do të bëjnë më në fund? Do të na lirojnë.

— Kanë qeverinë me vete ata katilë, — tha gjyshja.

— Ehu, moj nënë, — thirri babai, — sa hasmë ka Asllan beu! Tërë dynjanë! Pse, tërë botën do të dënojnë!? Po nuk e dimë a ngordhi apo shpëtoi, për këtë kam merak unë tanë.

Nëna i vuri përparrababait të hante. Unë e Bashkimi hymë brenda. Nuk na thanë gjë. Babai qe ulur tamam në atë vend, ku nëna, duke tundur kosin, qante e qante e më dukej se ai kënd nuk do të lagej më nga lotët e saj.

Trokiti dera dhe, pa pritur t'ia hapte njeri, Selman Tahiri hyri brenda.

— E morët vesh?

— Çfarë? pyeti babai, pa ngritur sytë nga buka e duke u përtypur.

— Asllan beut, mbrëmë, më dy të natës allaturka, i kanë bërë pritë te Qafa e Gjokës, i kanë rënë katër pushkë e ka marrë tre plumba. Është plagosur rëndë dhe për tërë natën e kanë dërguar në spital.

— Kushedi, — foli babai, — mundet. Ai ka qelbur dynjanë e tërë, sa hasmë ka ai!

— Jo «kushedi», jo! E di mirë unë, tani sapo më erdhi nipi nga Berati dhe kishte takuar trimat e Asllan beut rrugës me beun në vig, as i gjallë, as i vdekur.

— Epo, qenka e vërtetë atëherë, — tha babai me aq qetësi, sa edhe sot habitem.

Selman Tahiri tregohej me gisht në tërë fshatin që ishte trastë fjalësh, merrte e shpinte fjalë sa andej-këtej. Me bejlerët e fshatit e kishte grurë. Ç'bëhej e ç'thuhej në fshat, ua shpinte të ngrohta dhe ata i jepnin ndonjë kockë. Prandaj babai nuk ia zgjati.

Të nesërmen erdhi te ne një i afërm i Muço Kapinovës. Hëngri drekën, u fjalosën me babanë kokë më kokë e pasdite iku.

Duke kërkuar kutinë e sheqerit e të kafes në dollap, dëgjova babanë që i tha mysafirit:

— Të më besosh si veten, o vëlla, se ti e di që unë ty nuk të kam ndarë nga Riza Cerova, nga Muçua yt e nga ata që di ti e unë, se i kemi lidhur plagët njëri-tjetrit ne. Po ta kishte vrarë një i dorës sonë kunatin tim, nuk do të luftoja t'i merrja hakun. Edhe vjehrrin e kunetërit nuk do t'i lija t'i kërkonin gjakun. Por ama ndaj atij gjakpirësi... Si na thoshte Riza Cerova, a e mban mend? «Vëllezër, pa qëruar bejlerët...» E si të bëja unë, më thuaj?! Ata po na nxjerrin nga tokat, ata po na vrasin... dhe unë të bëja sehir?!

— Or, po mirë ia bëre gjarprit, po ç'e do që s'e ngordhët dot fare!

Pas dhjetë ditësh Asllan beu vdiq.

S'kaluan pak ditë, kur erdhën xhandarët dhe e

morën babanë, por të zgjidhur. Në postëkomandën e xhandarmërisë e pyetën, ku kishte qenë atë natë që iu bë prita Asllan beut. Pastaj e lanë të lirë. Pas dhjetë ditësh erdhën përsëri. Ç'llahtar! Më përpëlitez zemra në kraharor, si ai zogu i zënë në leqe. Gjer në çastin që i hodhën prangat, unë nuk mund ta merrja dot kurrë me mend që babai, babai im, t'i shtrinte duart prapa vetë, dhe xhandarët t'ia lidhnin pastaj qetë-qetë me zinxhirë të trashë e t'ia mbërthenin me kyça të mëdhenj. Çdo gjë mund të besoja: edhe se mund t'i vriste xhandarët bashkë me kapterin që i shoqëronte, edhe se mund t'i vinte zjarrin shtëpisë, se mund të ngjitej sipër në mal e të rrëzonte shkëmbinj që andej me uturimë si atëherë, kur bien lerat me dëborë, por jo se mund ta lidhnin, pa bërë ai asnje përpjekje.

— Nënë, shiko shtëpinë, — e porositi gjyshen, — unë nuk do të vonohem.

— E di, bir, — ia priti gjyshja krenare. — Mish nuk kanë për të të ngrënë. Shpejt do të kthehet, pos! Mos ki merak për shtëpinë.

Nëna nuk doli përjashta për ta parë kur e nisën. Ajo e ndoqi me sy nga dritarja, gjersa kaptuan Bregun e Qarrit e nuk dukeshin më.

Unë, kur e pashë që e vunë përpara xhandarët, ia krisa të qarit. Bashkimi ishte bërë i verdhë si limon në fytyrë, por nuk derdhi lot. Përkundrazi m'u kanos: «Shtrigël!» Kurse gjyshja m'i fshiu lotët me cepin e çemberit e më tha «ti nuk qenke çupa e gjyshes!» Pastaj shtoi: «Mos qaj. Aliu pa bërë muajin do të vijë në shtëpi».

Të nesërmen erdhi përsëri ai burri, kushërimi i Muço Kapinovës.

— Xhixho Këzja, për çdo gjë që të kesh nevojë,

gjersa të të vijë Aliu në shtëpi, më ke mua gjallë,
— i tha gjyshes.

Kështu, në fëmijërinë time, po të më kujtonin
bejlerë e qeveri, për mua ishte njëlloj si të më tho-
shin: vdekje, zi.

III

Burgosja e babait e zymtoi edhe më shumë shtëpinë tonë. Ranë në burg edhe gjyshi me dy dajat. Keq ne, keq edhe ata. Ne ishim gjashtë gojë për t'u ushqyer: babai, që donte edhe ai të hante në burg dhe pesë ne të tjerët: gjyshja, nëna, unë, Bashkimi, vëllai i vogël dy vjeç, Ylli. Tre muaj më pas nëna lindi edhe një djalë tjetër e u bëmë shtatë gojë. Toka duhej punuar. Fill pas mbledhjes së fasuleve, duhej prerë misri, duhej këputur e duheshin futur brenda misri e misërishtet, sepse ushqimi i kafshëve për dimër ishte po aq i domos-doshëm, sa dhe buka jonë. Gjeth për dimër, për ato pak dhi që kishim, duhej nxjerrë. Bar në mal për ato pesë dhen duhej korrur. Pastaj duhej mbjellë ai çikë hasëll e grurë. Pa edhe arrat duheshin shkundur. Ehu, sa punë e halle kishte shtëpia! Të gjitha

i bënte babai; po tani kush do ta mbante shtëpinë? Ne prit baba, e baba s'ka. Nga burgu i Çorovodës atë e shpunë në burgun e Beratit. Letra prej tij nuk merrnim. Për ta takuar, nuk na linin, se nuk kishte dalë ende në gjyq. Lajmet që merrnim, ishin njëri më i hidhur se tjetri. Familja, djemtë dhe e shoqja, ia kërkonin qeverisë Asllan beun në radhë të parë tek Ali Vigani, pastaj tek i vjehrri e te kunetërit. Sepse, pa Ali Viganin, atë nuk e hanin dot arrishtarët. Nganjëherë merrnim edhe lajme të mira: «Aliu e vjehrri me kunetërit nuk kanë pranuar (megjithëse i kanë shtrënguar gjer ku nuk mban më) që e kanë vrarë beun. Qeveria e bejlerët e Arriştës nuk ua provojnë dot vrasjen. Nuk kanë ç'bëjnë. Dëshmitarë nuk kanë. Të gjithë ata që janë pyetur, kanë mbajtur anën e të burgosurve. Do japid e do japid e më në fund do t'i nxjerrin në gjyq e do marrin pafajësinë». «Po pse po e zgjatin? Pse nuk po i nxjerrin në gjyq?» «Eh! e bëjnë me qëllim. Kanë miq bejlerët. Edhe me prefektin e Beratit çoc kanë të bëjnë». Që qeveria ishte me bejlerët e që bejlerët kishin miq të fortë, kjo na trembte se, megjithëqë nuk kishin prova, mund t'i dënonin. «Po me sa?» «Kryesorin ndofta me varje ose më e pakta me njëqind e një». Dhe kryesorin bejlerët kishin babanë.

Kaluam kështu, në ankthim e pritjes e të frikës së dënimit me varje, një vit. Në krye të vitit të akuzuarit dolën në gjyq. Burri i hallës së madhe na solli lajmet: «As Aliu, as të tjerët nuk pranuan. Me dhjetëra dëshmitarë vërtetuan se ku kishin qenë ata natën që ndodhi vrasja. Dëshmitarë kishin edhe bejlerët, po ata ngatérroheshin. Avokati i Aliut e i vjehrrit të tij, një djale i ri, shpuzë nga goja, i ho-

dhi poshtë thëniet e dëshmitarëve të bejlerëve». «Po pse, paska zënë avokat Aliu? — pyeti gjyshja. — Kushedi sa para do të duhen pér të!» «Rri, o e zezë, rehat!, — ia priti burri i hallës, — se ka edhe njerëz të mirë në botë». «Po mirë, — pyeti nëna, — pse nuk i liruan, kur gjyqi nuk u ngarkoi dot gjë?» «Emine, o motër! Nuk i liruan se vlon hatëri! Vlon padrejtësia! Avokati i bejlerëve kërkoi të bëhen he-time të reja. Se ku gjeti një shqekëz në ato ligjet e kësaj qeverie, që nuk i merr vesh as dreqi, dhe kërkoi të shtyhet gjyqi».

Një vit pa babanë. Në ditët e para çdo gjë që merrnim me mend pér të ardhmen ishte e zezë. «Po të zgjasë burgu i Aliut, — i tha një darkë gjyshja nënës, — do të shtrëngohemi të shesim ato pesëmbëdhjetë dhi e ato pesë dhen. Edhe lopën. Edhe gomarin. Veç... veç... oh, mos ardhëtë ajo ditë sa të prishim qetë e parmandës, se pastaj na piu e zeza! Kur të vijë djali, me se do të lërojë. Kurse, po të kemi ato...» «Nënë, — ia priti im më, — unë e kam bërë tetë: Do t'i vë krahët shtëpisë e do t'i rrit këta fëmijë, moj, sikur të përmbyset bota! Dhe do ta mbaj hapur e me ndër derën e atij burri, gjersa të më kthehet!» Nënës iu drodh buza, në dritën e kandilit unë pasqë pika loti në sytë e saj.

Fasulet i mblohdhëm vetë, se shkonim në ara gjyshja, nëna, Bashkimi dhe unë. Misrin e korrën nënëa dhe Bashkimi. Pér ta këputur shkonim të katërr... Bashkëfshatarët na ndihmuani pér disa punë që donin shpatulla burri: Kur shkonin në mulli pér vete, merrnin bluanin edhe pér ne. Kur shkonin pér dru, merrnin e ngarkonin me dru edhe gomarin tonë e na e sillnin në shtëpi. Misrin e misërishtet na i mbartën me kafshët e tyre, na vunë

edhe mullarët. Kur shkonin për dushk, merrnin edhe Bashkimin, Kushëriri i Muço Kapinovës na pati dërguar lajm me djalin e vet që në ditët e para: «Për ushqimin e Aliut në burg, mos bëni asgjë, se e ka të sigruuar nga unë derisa të lirohet». Këto ndihma nga miqtë e shokët, shumë herë edhe nga të panjohur vazhduan gjatë gjithë vitiit e vazhdonin gjithnjë.

Mirëpo erdhi maji e duhej mbjellë prapë misri, që ishte një punë e rëndë, punë çifciu. Kush do të na ndihmonte? Xha Hyseni i pati thënë gjyshes: «Këze, për ugaret të dërgova djalin, po për të mbjellat, tani që s'e kam djalin, me të mbaruar të miat, do të vij të të ndihmoj vetë». Po kështu edhe të tjerë: pasi të kishin mbjellë arat e tyre. Kishin të drejtë. Ishte koha. *Vakt maji, vakt zjarri për bujkun,* kështu thotë populli.

Më një maj gjithë fshati zuri pendët. Atë mëngjes edhe nëna nuk i lëshoi qetë. Që në mbrëmje ajo i grazhdoi si për punë. Në mëngjes u ngrit herët e i grazhdoi prapë, tamam ashtu siç bënte babai, kur kishte për të lëruar. Në mbrëmje përgatiti edhe farën.

— Ç'bën ashtu, nuse?

Në tonin e gjyshes vibronte dhembje. Ajo e pa se ç'bënte nokja. Pyetja, ashtu si e bëri, ishte e kotë. Ndoshta do të duhej ta pyeste se kush do të lëronte, kush do ta ndihmonte. Po edhe kjo ishte e kotë. Të gjithë kishin premtuar për më vonë.

— Ç'bën ashtu, nuse!? — vibroi përsëri dhembja e gjyshes.

— Nënë, — iu drejtua nokja, — një herë e dy mund t'i bihet më qafë tjetrit, po kjo (e kishte fjalën për kohën e burgut të babait) vajti gjatë. Edhe

tjetri thotë: bëhu një herë ti i zoti për veten tënde, atëherë të jap edhe unë një dorë dhe bëhemë barabar.

Nëna kishte vendosur t'i mbrehte qetë e të mbillte vetë atë pranverë.

Gjyshja nuk i foli më nokes, vetëm e dëgjova që përsëriti me vete me zë:

— Bëhu i zoti për vete...

Nëna mbathi shallvaret shajak të babait, veshi edhe setrën e tij dhe me Bashkimin përpëra, që ngiste qetë, e gjyshja e ne të tjerët pas noxes, shkumam në fund të Ligatës, kështu e quanim arën tonë. Atje nokja u vuri qeve tevligat në qafë, qepushinat sipër zverkut, u hodhi zgjedhën (qetë i bindeshin pa bërë asnjë lëvizje) dhe i mbrehu në parmendë.

— Oha, Murrash!

Dita qe e bukur. Dielli ngrohte ëmbël, ëmbël. Toka, paksa e mardhur nga të ftohtët e natës (sepse andej nga ne është malësi e fshati ynë është një mijë e dyqind metra mbi nivelin e detit) thithë rrezet e diellit me tërë etjen e avullonte aromën e saj, përzier edhe me atë të luleve e të gjethit të ri. Cdo gjë të dehte e, mbi të gjitha, tek e shihja noken time ashtu si burrë, si një drenushë, me aq hije, që ia jepte siguria që kishte ajo në vetvete, ndieja të tillë hove shpirtërore, saqë edhe tani nuk di si t'i them. E çfarë nuk më pillte mendja! Merrja me mend veten kur të rritetë. Po, si nokja do të bëja edhe vetë, po ta donte puna! Ato çupat që patën bërë mrekullira në përrallat e gjyshes, ja tek i shihja tani, te nokja ime.

Nëna lëronte. Bashkimi hidhte farën pas. Unë e gjyshja, pas tyre, hiqnim rrënjet e krisjeve e i grumbullonim.

— Këto, — më tha gjyshja për krisjet, — e djegin misrin, duhen qëruar. Pastaj, janë ushqim i ëmbël edhe për qetë. Kur t'i çmbrehim do t'ua hedhim t'i hanë.

Gjyshja punonte dhe nanuriste:

*Hidhet turku tra më tra
e thërret: — Baba Feta,
ç'bëka motra për vëlla!
Arnautkë, mos më vra,
të të jap një thes para!*

— Për vatan e për vëlla,
s'lahesh dot, turk, me para,
po me gjak a ezhdërha!

Këte këngë gjer atë ditë nuk ia kisha dëgjuar ndonjëherë. Me siguri, ia kujtoi gjesti i nokes, që u vesh si burrë...

— Gjyshe...

— Hë, bijë.

— Këte këngë...

— Këte këngë, bijë, ia kanë ngritur një çupe nga Dedegjoni i Skraparit. Turqit i vranë vëllanë. Vëlla tjetër s'kishte e ajo u vesh si djalë, bëri një çetë dhe bamp këtu e bamp këtej, e rrëthoi oficerin turk...

— E vrou?

— Po, bijë.

— Pse thërriste turku tra më tra?

— Nga frika. Donte të fshihej në tavan, po ajo e gjeti dhe mu atje e qëroi...

Isha e vogël. Në atë moshë kuptoja aq sa mund të kuptohej. Po kureshtjen e kisha të madhe.

- Gjyshe...
- Hë, bijë...
- Për vatan e pér vëlla... ?
- Po, moj bijë...

Dhe ja, mbledh krisje dhe bluaj ndër mend: «për vatan e pér vëlla». Hedh sytë e i gëzohem nokes sime tek lëron. E veshur burrë. E gjatë sa babai. Shtatin e saj aq të bukur, tek ecën me dorakun e parmandës në një dorë e me hostenin në tjetrën, e përfytyroj edhe sot aq qartë, si ta kem parë dje.

* * *

Më kujtohet si tani një mëngjes i po atij maji, që nuk do të më harrohet përjetë. Si çdo vit, në atë kohë, mbetëm pa bukë. Morëm një brokë misër hua dhe e bluam. Po ja, e mbaruam dhe atë, ç'do të bënim pastaj? Kur një mëngjes, sapo u ngrit e doli, nokja vuri re dy thasë, sipër njëri-tjetrit, mbështetur pranë portës. Vuri dorën mbi ta dhe e kuptoi që qenë me misër. Ishin nja dy qase. Dy qase, njëqind kilogramë, do të thoshte që ne të siguronim, domosdo me kursim të madh e duke ngrënë edhe lakra, si zakonisht, afro dy muaj bukë.

— Nënë! — i thirri nokja gjyshes.

Thirrja e saj nuk ishte e zakonshme.

— Ç'ke?! — iu përgjigj gjyshja e trembur dhe brofi nga dysheku. Rrëmbeu sëpatën në fund të konakut e sakaq doli jashtë. Në çast edhe unë e Bashkimi u gjendëm te porta.

— Shiko! — i tha nokja gjyshes, duke i treguar thasët.

— Sa më trembe, moj e zezë! E ç'kanë brenda?

— Ajo e preku njérin thes. — Misér paskan, — tha me zë tē qetë dhe tē dyja u panë sy më sy. — Kush do ta ketë lënë?!

Nëna ngriti supet.

— Dhe pse ta ketë lënë?

— Mos ndonjë nga njerëzit tanë tē largët eshtë nisur pér në mullirin tonë, ka ndonjë punë në fshat dhe vjen e ngarkon përsëri?

— Ashtu do tē jetë, — aprovoi nëna.

— Mirë. Lëre aty! — urdhëroi gjyshja. — Do vijë ta marrë i zoti.

Pritëm, po nuk erdhi njeri. Aty nga dreka gjyshja tha: «Ta futim brenda». Pastaj se ç'i shkrepit dhe e zgjidhi grykën e thesit që ishte përsipër. Një habi tjetër më e madhe: Brenda kishte një letër tē shkruar dhe një napolon.

— Bashkim, or bir, pa shiko!

Bashkimi atë vit bënte klasën e parë. Siç ishte mbështetur pas këndit në vatër, u zbeh në fytyrë, ia rrëmbeu letrën nga dora dhe lexoi me mundim:

Nënë Këze,

Ju lutemi shumë, pranojeni këtë misér dhe këtë napolon. Nuk janë sadaka, po ndihma që i bëjnë familjes së Aliut shokët e tij.

Pasi ta lexoni letrën, griseni. Dhe mos i thoni askujt. Ju lutem edhe një herë, mos e merrni pér sadaka këtë ndihmë. Kur tē dalë Aliu nga burgu, do ta merrni vesh edhe se kush jemi ne.

Gjyshja ishte shumë krenare. Ajo nuk i përulej kurrë armikut. Aq sa krenare dhe e egër ishte ndaj hasmit, po aq e ciltër dhe e përzemërt ishte ndaj mikut. Megjithatë, edhe ndaj mikut, ajo nuk e bënte veten sa t'i zgjaste dorën. Kur e mbaroi së lexuari letrën Bashkimi, ajo ngriti duart lart e me një zë

që nuk ia pata dëgjuar kurrë, thirri: «Bir, sa miq e shokë më paske pasur!» Pastaj nënës: «Nuse, e dëgjove? «*Ju lutem, mos e merrni pér sadakà?*» Atëherë nuk e kuptova përsë u skuq nëna aq shumë, si nuk e kisha parë kurrë gjer atëherë dhe si nuk e pashë kurrë gjatë gjithë jetës. Nëna nuk iu përgjigj gjyshes, veçse, kokulur, mori fshesën në dorë e bënte sikur fshinte.

Gjer në një farë moshe kishte shumë fjalë e shprehje që i dëgjoja e nuk ua merrja vesh kuptimin. Për shembull: vinte ndonjëri nga pazari dhe dikush e pyeste: «A e poqe filanin?» Dhe unë vrisja mendjen me vete: «Si ta piqte?» Sepse «të pjetur» kuptoja mishin, bukën, po njeriu si mund «të piqej?»!

Tani, që isha rritur ca, nuk vuaja aq shumë për të tilla gjëra, po prapë kisha plot të tjera që nuk i kuptoja. Kështu nuk e kuptova edhe fjalën *sadakà*, që thuhej në letrën e atij të panjohurit. Pyeta gjyshen, dhe ajo ma shpjegoi.

* * *

Një vit pa babanë, po ne nuk vuajtëm si shtëpi pa mashkull të rritur brenda. Nuk shitëm asnjë dhi e asnjë dele, siç trembeshin në fillim gjyshja dhe nëna. «Nëna të lë jetim, babai të lë fukara», përsërisht shpesh gjyshja, se ato kohë ishin shumë të vështira. Vinin njerëz për vizitë te ne dhe unë dëgjoja: «Ç'pyet, moj xhixho Kézja! Ka ardhur fundi. Ky është bishti i jetës!», ngulte këmbë mysafiri. Dëgjoja edhe që thoshin: «Po si nuk u bëka një luftë, xhanëm! Ja të ndreqet, ja të vithiset fare!» Atëherë zija e thosha me vete: «Si lutet të bëhet

luftë ky njeri!» dhe më rrëqet thej mishi. Gjyshja më kishte treguar për gjithë ato vuajtje të kohës së luftërave e për gjithë ata të vrarë. «E sheh atë shtëpinë atje, që është bërë gërmadhë, — më tregonte gjyshja, — ajo u shua në kohën e zisë së bukës. Njëmbëdhjetë frysë kanë vdekur atëherë nga ajo shtëpi». Dhe si shtëpia e Saliko Kulës kishte edhe të tjera në fshat, të mbeturë shkretë nga zia. Përveç zisë së bukës, në kohën e luftës kishin bërë kërdinë në fshat edhe sëmundjet. Kishin rënë kolera, lia, lëgnjyeri.¹⁾ «I solli askeri i huaj, moj bijë... dhe u mbyt ky fshat në vaj e lot! Në ato kohë kemi shitur edhe ne Xhyvillin për tri qase misër. Po ta kishim Xhyvillin sot, nuk do të vuanim për bukë, se bën njëzet qase misër ajo arë! Xhyvillin e shitëm e yt gjysh vdiq se vdiq! Kishte ditë të tëra pa ngrënë bukë, pérveç se këlkëzë, lakra të ziera e misërishte të bluara në nulli. Dhe, kur ra në bukë, e zuri buka, e preu barku menjëherë dhe vdiq». «Mirë, moj gjyshe, po pse nuk e shitët më parë Xhyvillin?» «Ah, moj çupë, po këta katilët që e blenë, — dhe ajo bënte me kokë për nga shtëpitë e bejlerëve të fshatit tonë, — nuk donin. «A na e jep për dy qase?» i thoshin tét gjyshi. Pastaj mezi e blenë për tri qase. Ato kohë Aliu, yt atë, moj bijë, kishte mbetur kockë e lëkurë. «O grua, — më tha yt gjysh, — po na ikën djali nga duart. Atë Xhyvill pér këtë djalë e doja. Po më iku djali, ç'e dua Xhyvillin!» dhe i shpëtuan ata lot breshër. U ngrit, mori shkopin dhe, duke ecur ngëc-ngaç, se nuk i kishte mbetur pikë fuqie, për një orë e gjysmë u vajti bejlerëve në shtëpi...» «Një orë e gjysmë,

1) tifo e zorrëve.

moj gjyshe?» Unë pesë minuta e bëja që nga shtëpitë tona gjer tek ato të bejlerëve. «Ah, çupë, çupë, po ai kishte mbetur kockë e lëkurë, moj zemër! Kaq sa, kur vdiq pas tri ditësh, ishte rrëgjuar gjithë ai burrë sa një mishtrishte misri, se edhe kocka i qe tretur. Dhe kur e hodhëm në arkivol...» Gjyshen e mbytën ngashërimet e nuk po fliste dot më. «Ç'm'i lëndove të nëmurat plagë, moj bijë!» — u ankua, pa m'u zemëruar.

Pra, megjithëse kishin hequr të zitë e ullirit, prapë kishte njerëz që luteshin: «Po si nuk po pëlçet një luftë! Kush të mbesë, le të mbesë, po ama të rrojë si njeri!» Këtë s'e kuptoja. Dhe një ditë e pyeta gjyshen.

Ajo vuri buzën në gaz. Pastaj më pa e menduar. Unë po e ruaja në buzë, se pyetja që i bëra më mundonte shumë. Para se të më përgjigjej, fytyna e saj mori një shprehje kërcënuese dhe më porositi me ton të rreptë:

— Moj kërcure, çfarë të të tregoj unë; ç'dëgjon ndonjë fjalë nga ata që hyjnë e dalin te ne, mos i gojos përjashta!

U mblodha sa një grusht.

— Unë kurrë, gjyshe...

— Ashtu bijëz...

Këtë radhë zëri i saj ndryshoi krejt, se iu dhimbса tek e pa që nga hija e saj u bëra dhé.

— Njerëzit, — filloj të më shpjegonte, — nuk lusin për një luftë, si ajo që na pruri zinë e bukës, kolerën... Jo. Ata lusin që të ngrihet mileti e ta rrëzojnë atë qenin që rri në fron atje në Tiranë, Ahmet Zogun, që mban në burg tët atë. — Pastaj vazhdoi të fliste me vete, duke tundur kryet kërcënueshëm: — Sa kohë që do të marrë frymë ai

katil, për popullin nuk do të ketë ditë të bardha, me litar në grykë do të jetë, sot e mot.

— Po mirë, o gjyshe, — i thashë, — pse të lusin njerëzit? Le të ngrihen...

Qeshi gjyshja në fillim, e pastaj m'u drejtua si të kuvendonte me një të rritur:

— Do të ngrihen ndonjë ditë, moj bijë!... Po nuk është aq e lehtë, jo!...

Pas këtij kuvendimi, unë shpeshherë thosha me vete, e nisur gjithnjë nga përrallat e gjyshes: «Sikur të ngrihen ata divat, ata njerëzit që kanë lindur dragonj, dhe të venë ta mbysin mbretin atje tek rri në fron, në pallat! *Ti ke pirë gjakun e popullit!* *Ti, katil, i ke lënë njerëzit të vdesin urie!* *Xhanda-rët e tu u kanë marrë bagëtitë nga katoi fukarenjve e u ke tharë lugët e dhallit fëmijëve!*... *Na tani!*...» Dhe pasi t'i kishin bërë këtë gjyq, fap të nxirrin jataganët e t'i prisnin kokën mbretit si asaj kuçedrës. Shpeshherë merrja me mend sikur të ishim im atë, nëna, gjyshja, unë, vëllai ata që do t'i bënim gjyqin mbretit e t'i prisnim kokën.

Ditën e pazarit, kur fshatarët ktheheshin nga Berati, gjyshja dilte e i priste në krye të lëmit. Atje ishte një man. Ajo i vinte shpatullat trungut të tij dhe, kushdo që vinte, do të kthehej vetë, ose do ta kthente gjyshja: «Pa hajde, mor bir, na fjalos, ç'kemi atij Berati e atij pazari?» «Xhixho Këzja, ç'të kemi! T'i zësh njerëzit në majë të hundës, u del shpirti. I ka vajtur thika në eshtër këtij mileti!» «Sa vajti misri?» «Ç'pyet! Në helm! Kur e shesim atëherë në vjeshtë, e japim për shtatë e dhjetë lekë qesenë. Këtë javë vajti edhe pesëdhjetë lekë qeseja. Mos u hëngërt, i shkreti! Të rrëqethet mishtë, moj xhixho Këzja, kur e sheh këtë burrë që e kë-

put pikën e lotit kaq pér një thërrime misër!» Dhe i tregonte gjyshes mollëzën e gishtit të madh pér madhësinë e lotit, që e kishte bërë t'i «rrotullohej barku». «Po gjë e gjallë, si shkoi këtë javë?» «Mbërdhe, moj xhixho Këzja, mbërdhe! Tërë mileti janë në shitje tanë dhe, kur fshatari ka pér të shitur, malli i tij nuk hiqet fare».

Kishte disa kohë që ishte hapur shkolla në fshatin tonë, kur unë dëgjova pér herë të parë fjalët bolshevik e bolshevizëm. Sheshi ku mblidhej fshati, ishte afër shtëpive tonë dhe ne, fëmijët e lagjes sonë, atje mblidheshim e luanim çdo mbrëmje. Çdo ditë, sidomos në mbrëmje, do të gjendeshin të pak-tën dy-tre burra e djem duke biseduar dhe mua më rrëmbente veshi: «Pse e zgjat, o vëlla, po s'u bë ashtu si thotë mësuesi, bolshevizëm, nuk ka shpëtim pér ne». Një mbrëmje Dike Karafilit diç i kishte ndodhur dhe, duke ecur përmes fshatit me shatin në krahë, i nxituar, po shante e po mallkonte. «Ç'ke, o Dike?» — e pyeti dikush, duke nxjerrë kryet mbi gardhin e oborrit. «Mjaft më, na ka vajtur thika në eshtë! Blloshevizma, blloshevizma i lan hesapet, po ku eshtë se!» Ai si duket nuk e thoshte dot, ose ia kishte zënë veshi shtrembër fjalën bolshevizëm. Pyeta gjyshen, kur e dëgjova pér herë të parë atë fjalë e ajo m'u përgjigj: «Ku e di unë, o bijë! Këtë fjalë e kam dëgjuar hane qëkur nga Riza Cerova, Muço Kapinova, Myrto Cerova... Rizai i thoshte den-dur këto fjalë. Po ku e di unë, o bijë».

Mësuesi thoshin se nuk u kishte shkelur bejlerëve kurrë në derë. Kurse të gjithë nëpunësit e tjerë tek ata e kishin si në shtëpinë e tyre. Dhe e shtronin me raki, mishra të pjekura e bakllava. Si hanin e pinin si derrat e si ngopeshin me gjumë,

dilnin pastaj përjashta, nën hijen e pemëve dhe shtin-
nin me nishan «pam-pum», kush të thyente gurët
e bardhë, që kishin ngritur në rripën kundrejt shtë-
pive.

IV

Gjyshja jonë dinte shumë përralla, legjenda, gjë e gjëza, histori e ngjarje të vërteta, që ose i kishte jetuar e parë vetë me sy, ose ia kishin treguar të tjerët. Dhe tregonte aq bukur! «Tani, — më thoshte ajo, — do t'i lëmë këtu të Bukurën e Dheut dhe atë djalin që kishte zënë sevda me të e do të hidhemi te mbreti, që e kërkonte djalin për ta vrarë, sepse ai ishte trim, nuk pyeste fare për të, ishte bërë me popullin, ia sillte vërdallë tërë ushtrinë dhe vetë bëhej erë e nuk e zinin dot. Dha e dha mbreti dhe, si e pa që nuk kishte ç'i bënte, mblodhi gjithë të besuarit e vet në sarajet e u tha: «Ose do të më sillni kokën e tij, ose ju preva kokat të gjithëve! Para ju jap sa të doni, vetëm të ma sillni këtu të gjallë, ose të më sillni kokën e tij. U ngritën bes-

nikët e mbretit dhe...» Prapë tregonte e prapë kthehej prapa, gjersa mbaronte përralla.

Kur zinte nga ngjarjet e vërteta, më tregonte: «Shahin Matraku, moj çupë, ishte kaçak. Ai kishte dalë në mal, se e ndiqte Turqia, ngaqë donin ta merrnin ushtar. Ai nuk vajti, se Turqia i gremiste andej nga Jemeni e Tarabulluzi, ku piqet buka në diell, e i mbante nga shtatë e nëntë vjet, nganjëherë edhe më shumë, kur kishte trubullira në mbretërinë e saj. Papo shumica e atyre që shkonin ushtarë nuk ktheheshin më. Ja vdisnin nga të nxehjtë e sëmundjet, ja vriteshin në luftëra. Edhe ata të paktë që ktheheshin, vinin të sakatosur». «Sa mirë paska bërë Shahini!» — ia priste Bashkimi, që e ruante gjyshen në gojë. «Po ku rrinte, gjyshe?» «Kaçak maleve. Në dimër futej te një plakë që nuk kishte as djalë, as vajzë. Në verë, majë më majë, qafë më qafë e stan më stan. Për të ngrënë i jepte populli». «Kishte shokë Shahini?» «Plot kishte. Të gjithë ata që prisheshin me qeverinë, me Shahinin shkonin e bashkoheshin». «Gjyshe, po ai Serveti që ka qenë nga fshati ynë?» «Ah, mor fëmijë, c'ma kujtuat atë Servet! Për atë të mos kishte vdekje kurrë... Po ai ishte komit. Komitet lanë shtëpi e katandi, mall e gjë, nënë e baba, grua e fëmijë dhe dolën maleve pér të përzënë Turqinë. Abetaren që keni ju sot, ai Servet e ka sjellë në fshatin tonë, që kur ishte turku këtu e i priste kordha në të dyja anët. Gjyshi juaj kishte shkuar kushedi sa herë me çetën e tij. Serveti e mësoi edhe atë të shkruante e të këndonte shqipen. Se ishte djalë me shkollë, i ziu Servet. Pa u bërë njëzet vjeç, la shkollën në Berat e doli komit. Kur ishte nxënës, u futi shqiptarëve patriotë të burgosur në burgun e Beratit ca lima. Dhe u arra-

tis pastaj bashkë me ta. Që atëherë i ngritën edhe këngën:

*Ishe me brucë,
u bëre me gunë,
bir, ore Servet,
ç'u prishe me punë.*

*Mauzerin në krahë,
librat nën gunë,
pritmë, o Servet, pritmë,
do të vij dhe unë.*

Mbaj mend se një nga ato që më ka tronditur më shumë, sa isha e vogël, ka qenë edhe legjenda e «Detit nën Tomor».

Ishte fundi i majit ose fillimi i qershoret. Babai e nëna prashitnin misrin në Sheshet e Marës. Në drekë unë e gjyshja shkuam t'u shpinim bukën. Atë ditë gjyshja kishte bërë një lakror të trashë me lëpjetë, domosdo me miell misri, se miell gruri atëherë ne s'kishim. Ua shpumë drekën e ata hëngrën të uritur. Si mbaroi, babai nxori kutinë e drodhi një cigare. «Po s'të mbajnë këto të shkreta lakra, moj néné, jo! — u ankua ai. — Ja, pi pak ujë dhe të bëhet barku fiful. Do bukë robi, ajo të mban, ajo të zë vend!» Gjyshja psherëtiu thelle.

Si mbaroi cigaren e parë, babai drodhi të dytën, e piu atë gjer në gjysmë e pastaj, me të në buzë u ngritën të dy me nënën të prashitnin. «Ti, nënë, mblidh ato bitra që kemi shkulur, — i tha ai gjyshes, — qëro anëve edhe ato kulpra e brushtulla që kanë mbirë, se e ndezin misrin për ujë dhe pas-

taj, po deshe, mblidh edhe ndonjë dorë shkarpa
andej nga korija». Me gjyshen punova edhe unë.

Kur mbaruam, donte edhe ndonjë orë të errej.
Filloi puhia e mbrëmjes. «Sa të çlodh kjo erë! —
tha gjyshja si e rinuar. Përkundrejt kishim Tomorin,
që me të dy majat e tij më të larta, njërën nga
jugu e tjetrën nga veriu, dukej sikur kishte zgjatur
dy krahët e yet e thoshte: «Unë jam zot i qiellit»!
Nga çasti në çast ndryshonte ngjyrë e nuk dukej
si një masiv gurësh, po si një masë xhevahiri, pu-
qur me qiellin. Erdhi te ne edhe xha Kasemi. Nuk
di se ç'po bisedonin po unë dëgjova që gjyshja i
tha: «E di ti, Kasem, që thonë se nën Tomor është
një det?» Ai tundi kokën, duke nxjerrë një shtëllun-
gë tym duhani që ia mbuloi fytyrën dhe pohoi:
«Si nuk e di, oj Këze! Po ti e mban mend kur tho-
shte i mjeri xha Laska: *Një rruhdhë sikur të bëjë
ai det, bie tërmët. Një herë po të ngrejë dallgët,*
bëhet kiamet. Pooo, ashtu thoshte, ashtu. Edhe im
atë, ndjesë pastë, ashtu thoshte. Gjithë këto ujëra
që burojnë rrëth Tomorit, edhe ujérat e fshatit tonë,
atje e kanë kokën, atje, në atë det», i dha fund bi-
sedës xha Kasemi. Se ç'ishte tërmëti, unë e dija,
sepse dy muaj më parë pati rënë aq i fortë andej
nga ne, sa nuk mbeti shtëpi pa ndonjë faqe muri
të plasur. Bile, një shtëpi ishte bërë shesh fare dhe
zuri brenda një plakë e dy fëmijë.

E pyeta gjyshen atë mbrëmje. «Po mund të
lëvizë deti nën Tomor?» «Kushedi, edhe mund të
lëvizë».

Shpesh më bëhej në èndërr sikur pëlcisnin ujë-
rat nga Tomori dhe njerëzit, bashkë me ta edhe unë,
sikur bridhnim e uji na ndiqte pas. Nganjëherë tho-
sha me vete: «Le t'i ngrejë dallgët deti nën Tomor,

po të mbyten vetëm bejlerët e qeveria, asnje tjetër». Atë ditë që erdhën xhandarët dhe e morën babanë të lidhur, unë u luta gjithë ditën e gjithë natën, gjersa më zuri gjumi: «Ja, Abaz Ali, aman, jepi urdhër detit nën Tomor t'i ngrejë dallgët! Le të bëhet kiameti!» Po kiameti nuk u bë dhe unë vonë e mësova kuptimin e asaj legjende. Jo, atij «deti» nuk duhej t'i trembesha, po të lutesha ditë e natë që ai të ngrinte «dallgët».

V

Filloi viti i dytë i shkollës. Pas disa ditësh, në shtëpi erdhi mësuesi e bisedoi me gjyshen: «Bashkimi mëson shumë mirë... Do ta mbaj nja dy muaj në klasën e dytë dhe pastaj do ta kaloj në të tretën... ai është i rritur, ka hedhur edhe shtat shumë». Ndërsa për mua, mësuesi tha se, po të shkoja mbarë gjatë tre muajve të vjeshtës, dhe për këtë ai qe i bindur, në dhjetor do të më kalonte në klasën e tretë. Kështu që edhe unë do të kaloja dy klassë në një vit.

Mësuesi ynë ishte i ri, rreth të tridhjetave. Kishte një pamje serioze e rrinte gjithmonë i menduar. Fliste pak e pa u nxituar. Rrallë e vinte buzën në gaz. Zemrën e kishte xhevahir. Me njerëzit ishte shumë i dashur. Ne, fëmijët, na donte shumë. Kishte durim të madh e kurrë nuk nxehet. Një vit të tërë

ai nuk i hoqi asnje fëmije një pëllëmbë. Kurse gjyshja më kishte treguar se mësuesit në shkollat turke të shqepnin në dru. Tërë fshati e donin mësuesin tonë. Ai u shkonte për vizitë në shtëpi, bisedonte e merrte pjesë në hallet e secilit si të ishte bir shtëpie. Flinte në shkollë, në një dhomë fare të vogël. Atje mblidheshin shumë nga të rintjtë e fshatit dhe ai bisedonte me ta gjer vonë. U lexonte gazeta e libra, u fliste për historinë, gjeografinë dhe i bëri të mësonin shkrim e lexim. Ardhja e mësuesit dhe hapja e shkollës qenë për fshatin tonë një ngjarje shumë e dëshiruar. Për çdo rast do të dëgjoje: «A e ke pyetur mësuesin?» «Po mësuesi a e ka marrë vesh?» «Po mësuesi si thotë?» «Të pyesim mësuesin, pa pastaj...». Te sheshi ku mblidhej fshati shpeshherë kisha dëgjuar të thoshin për mësuesin: «Vetëm ky ua theu hundët bejlerëve. Ai sikur të jetë lindur e rritur këtu me ne... Flet edhe kundër mbretit... veç duhet ta ruajmë, se mos e spiunojë ndonjë i poshtër...» Zieja përbrenda si t'ia thosha mësuesit të ruhej nga spiuni, po nuk ishte e mundur dhe shkoja i thosha gjyshes: «Gjyshe, thuaji ti...» Ajo queshte: «Po jo, moj bijë, mos u tremb, se ai është i zoti të ruajë botën, e jo të mos dijë të ruajë veten». Megjithatë unë kisha frikë për mësuesin. Që kur kishte ardhur ai, në shtëpinë tonë hyri si një gjë e prekshme besimi se *babai do të lirohej, se atë nuk do ta gjente gjë*. Dhe për çdo gjë gjyshja shkonte këshillohej me të. Sigurisht ajo ia tregonte edhe ato që i thosha unë, se shpesh më porosiste: «Po të dëgjosh gjë për mësuesin...» Ai na u bë një mbështetje e madhe për hallin që na kishte zënë. Kur shkonte në Berat, vente takonte babanë në burg, bisedonte me të gjatë e gjerë e na sillte gjithë ato lajme. Neve na bëhej sikur na kishte ardhur

babai, aq shumë gëzoheshim, kur mësuesi na thoshte: «Më ka porositur Aliu: filan arë të mbillet misër. Në qoftë se dhia shytë nuk merr kec sivjet, ta therni për pastërma për dimër. Lopën e madhe ta shitni, se nuk ju del ushqimi për dimër. Të mbani vetëm mëshqerrën, meqenëse ka marrë viç e pjell tamam në kohën që duhet dhalli». Si duket babai do t'i kishte thënë edhe se e kishte marrë malli për ne, sepse mësuesi, për ta çmallur babanë, kur u nis një herë për Berat, mori edhe Bashkimin me vete. As nëna, as gjyshja nuk donin, sepse «djalit i duheshin lekë të hante, të flinte», por mësuesi i tha: «Nënë Këzja, shpenzimet janë mbi mua» e, duke folur gjithnjë me atë çiltërsi e ngrohtësi që i buronte nga shpirti, vazhdoi: «Ti, nënë Këzja, vetëm mbaj mend që, kur të piqen ky mani e ajo qershia atje, të na e shpërblesh me një tas mana e qershi». Pastaj i hodhi krahun Bashkimit dhe e pushtoi. Më ka mbetur i gjallë e i mallëngjyer ai çast, sepse m'u bë sikur Bashkimi papritur u bë me një vëlla të madh. Mësuesi e përqafroi dhe i tha: «Do ta bëjmë bashkë rrugën gjer Berat këtë radhë, more trim». Sa zili e pata tim vëlla që do të vente te babai.

* * *

U bë edhe gjyqi për herë të dytë dhe as njerëzit e nënës, as babai nuk dolën nga burgu. Atëherë gjyshi bisedoi me djemtë e tij e me babanë dhe u thotë: «Unë plak jam. Bejlerët kanë qeverinë me vete. Prandaj kam menduar të dal e të them se unë e vrava Asllan beun. Kështu, liroheni ju të tjerët, se kjo punë shkoi gjatë e do të shkojë akoma më gjatë; kurse neve po na prishen shtëpitë. I kemi lënë

vetëm me gratë e me foshnjat. Na kanë ndihmuar miqtë e shoqëria, po gjer kur? Sa do të na ndihmojnë edhe ata?! Sa të kalbemi katër burra në burg, është më mirë të mbetet vetëm një. Me vdekje nuk më dënojnë dot. Në e paça jetën të gjatë, një ditë do të dal edhe unë. Në vdeksha në burg, vdes një, po jo dy shtëpi». E mendojnë gjatë e gjerë këtë fjalë të gjyshit dhe vendosën të këshilloheshin me avokatin.

Atë ditë që morëm letrën, me të cilën babai na lajmëronte se gjyqi ishte shtyrë përsëri për në një datë të pacaktuar, m'u bë sikur shtëpinë tonë e mbuloi një vel i zi, njëlloj si atë ditë që e arrestuan. Ishte mbrëmje kur na erdhi letra. Të gjithë ishim në shtëpi. Nëna e gjyshja po tirnin ca lesh për t'u bërë babait e Bashkimit nga një palë shallvare dhe neve të tjerëve çorape, se po hynte dimri e ishim lakuriq. Nënë dhe ti, grua, shkruante babai në letër, *mos u mërzitni*, se na zuri kjo e keqe dhe do ta heqim. Po ju hapni sytë, shikoni fëmijët, qetë, lopën, bagëtinë. Thonë se sivjet do të bëjë dimër i madh, prandaj nxirrni ca dushk për dhitë dhe sigurojuni kasollen, të jetë e ngrohtë, se shtien nga të ftohtët. Kam merak, nënë, gjumi natën nuk më zë. Me trup jam këtu, po me shpirt jam aty. Ditën bëj si bëj, se e humbas mendjen në biseda me shokët, po, kur vë kokën në jastëk e kam më keq. Se mendoj për ju. Tani do të jenë duke ngrënë darkën, them. Po a u del buka? Po për gjellë si bëjnë? Po zahirenë e dimrit për vete e për gjënë e gjallë a e kanë mbledhur?... Kur erdhi te fjalët e fundit Bashkimi, m'u sos durimi. Në kraharor ndjeva një shtrëngim të fortë, zemrën e ndjeva sikur ma shpoi një thikë, në shpinë ndjeva djersë të ftohta dhe ngashërimin e lotët që më ishin mbledhur lëmsh në grykë nuk po mundja t'i përbaja. Atë kohë, sic

isha duke dëgjuar fjalët e letrës, e kërrusur e me sytë përdhé, ngrita kryet e vështrova sa nga nëna nga gjyshja. Ato të dyja m'u dukën atë çast si dy copa shkëmbi me trajtat e njeriut tek prisnin rrufetë, që shkarkoheshin mbi to, të papërgjunjura, të vendosura të qëndronin ashtu sa të ishtejeta. Gjyshes edhe thinjat i rezëllinin zemërim për shkaktarët e vuajtjeve tona. E kuptova që, po t'i hapja rrugë atij ngashërimi të brendshëm, t'ia krisja vajit, gjyshja do të më qortonte: «nuk qenke çupë e gjyshes, ashtu siç të kam ditur!», prandaj shtrëngova dhëmbët, ngula thonjtë në postiqen ku qeshë ulur, mblodha shuk dy tufa lesh në grushtet e mia të vogla dhe dëgjova me durim vazhdimin e letrës: *Nënë, kam shumë merak, a keni hedhur ndonjë dru zjarri për dimër, se kam halin e fëmijëve mos plevitosen e bëhen me cen përjetë. Aman, nënë, shikoni fëmijët! Shitni edhe ndonjë gjë të gjallë, vetëm ata të mos na bëhen me cen...*

Kur Bashkimi pushoi së lexuari, gjyshja e pyeti:
— Shkruan gjë tjetër?

Ngrita sytë dhe e shikova. Mu si tani më kujtohet që atë çast thashë me vete me një farë gëzimi të fshehtë: «Nuk qenka ngurosur gjyshja!»

— Jo, — iu përgjigj Bashkimi.

Gjyshja i zgjati dorën.

— Nëma tani, — i kërkoi letrën e, si e mori, e palosi dhe e futi në gji.

Unë e dija se, gjersa të vinte letra tjetër, ajo do të më merrte pranë në kohën kur s'do të kishte punë, do të fuste dorën në gji, do ta nxirrte letrën me pshëritëma dhe do të më thoshte duke e shpalosur: «Pa këndoma edhe një herë këtë letrën e tyt eti». Dhe ajo do të më ndiqte pa i hequr sytë prej saj, me një merak se mos kaloja ndonjë rresht a fjalë.

Si e futi letrën në gji, i tha nënës:

— Nuse, shtrona atë sofër të hamë darkën. — Dhe ngriti shpatullat sikur hodhi prapa krahëve një të keqe të madhe. Zëri i saj këtë herë doli më kumbues, sikur me atë mënyrë donte ta çirrte copë e çikë e ta mblidhët shuk atë vel zie që na kishte mbuluar e ta flakte jashtë, tatëpjetë brinjës që kishim pas shtëpisë.

— E kujt i hahet bukë! — tha nëna pa lëvizur nga vendi dhe brodhi sytë sa nga ne fëmijët, rrëth e qark ashefit, sikur kërkonte një gjë të humbur.

— Ngrehu shtro sofrën, të them! — e kërcënoi me ton të butë gjyshja. — Të gjithëve na hahet! — Dhe sytë e saj u fiksuan në ata të nënës, duke shkar-kuar një varg qortimesh: «Pse mërzit fëmijët!? I ke mendtë në kokë apo jo!?

Sofra u shtrua dhe të gjithë u ulëm rrëth saj. Po kush futi bukë në gojë atë darkë! Sa kishim thyer kafshitat e para, Ylli zuri të fërkonte sytë. Nuk po e kuptionim pse qante.

— Po babai pse nuk erdhi? Po babai pse nuk erdhi?

Ai ishte në atë moshë që isha unë, kur u vra dajë Qemali.

* * *

Njëzet e tetë muaj e mbajtën babanë në burg. Pritja djeg si zjarri e neve na dukeshin ditët muaj e muajt vite. Unë e shihja vazhdimisht babanë në ëndërr: Njëherë sikur thirri që përjashta: «Emine, Emine moj, dil e mbyll këto që, se janë dërsirë». Njëherë sikur kishte ardhur, ishte ulur këmbékryq në shtëpi e po hante bukë shumë i uritur. Një herë tje-

tër sikur na kishin ardhur dajat mysafirë e babai ia thoshte:

*Me një degë borziloku
hapa perden e penxheresë,
ti më flije me leshrat derdhur
mu në prehrin e nënesë.*

Dhe më të shumtën e herës e shihja sikur vinte në shtëpi, më ulej pranë jastëkut ku flija e, duke më fërkuar ballin e flokët më thoshte: «Të mori malli pér babanë ty, të mori?»

Ëndrrat ia tregoj gjyshes e nënës. Ato më dëgjognin me vëmendje. Kur dëgjon krismë dyfeku, është *haber i mirë*. Edhe gostia në shtëpi, del gasti. Kur e *sheh* të zemëruar, del e kundërta, është i *gëzuar*, shpjegonte gjyshja. Pastaj: «Si e pe ti, si e pe?» «Ja, gjyshe, sikur kishte ardhur, ishte ulur nën manin te kreu i lëmit...» «Hair, hair! Ja, dëgjomëni mua, sikur ka ardhur Aliu këtë javë, kiameti gjer nga fundi i muajit...», përfundonte gjyshja. Pastaj ato të dyja i tregonin njëra-tjetrës. Ëndrrat që kishin parë vetë, shumë herë me zë të lartë. Po në mjaft raste edhe me zë të ulët, që të mos i dëgjonim ne fëmijët. Vetëm Bashkimi nuk tregonte.

Njëzet e tetë muaj ne jetuan me shpresën se vjen babai sot e vjen nesër dhe me sytë gjithmonë nga rrugët, gjithmonë nga dera.

VI

Kur erdhi babai, ora ishte tre pas mesnate. Kish-te trokitur në dritaren e konakut ku flinim, por ne s'kishim dëgjuar. Bënim gjumë të thellë, si të vdekur; ishim të lodhur e të këputur nga punët e ditës që të gjithë. Më në fund e ndjeu gjyshja, si nëpër ëndërr në fillim, pastaj, si e kuptoi se me të vërtetë trokitnin, pyeti:

- Kush është?
- Jemi ca miq.
- Miq në këtë kohë?!
- Miq jemi, po dil hiqi llozin derës.
- Si zë miku më duket, po, në jeni vërtet miq, thuajeni.

Nga ky dialog u zgjuam të gjithë. Nëna donte të ndizte kandilin, po gjyshja nuk e la, madje e kërcënoi: «E marrë! Po në dritën e kandilit ta mban tjetri në lule të ballit!»

— Hape, Këze, hape!

— Babai! — thirri nëna. — Babai! — dhe po dridhej e tëra. Ajo njohu zërin e të atit.

— Hapeni, hapeni e mos bërtisni!

Zëri i dytë ishte i babait. Zëri i babait, që nuk e kisha dëgjuar pér aq kohë, veçse në ëndërr.

— Ali, bir! — thirri gjyshja.

Nëna u hutua më keq, po nuk bërtiti. Ndofta pse nuk bënte të bërtiste nga gjëzimi pér të, prandaj edhe u hutua.

— Ne jemi, po mjaf! Dilni na hapni derën!

Zëri i babait dukej sikur ndrynte me sforçë të madhe mallëngjimin e brendshëm. Ajo mënyrë të foluri, si të kishte qenë në arë apo në mulli e po kthehej pas një dite mungese, ishte e shtirur.

Hyri i pari gjyshi, pastaj babai e më në fund daja i vogël. Dera mbeti e hapur e ne po pritnim me vështrimin pyetës.

«Po të tjerët?» Ankthin tonë e preu në mes babai me urdhrin që i dha Bashkimit: «Mbylle atë derë!» Ishte e kuptueshme. Nuk kishte pse të pyesnim. Dy dajat, i madhi e i dyti pas tij, nuk ishin kthyer.

— E zeza unë, — fliste gjyshja e mallëngjyer.

— Po si nuk pashtë një ëndërr tërë këtë javë! Më përpara nuk kishte natë, më ngrinin ëndrrat, më ngrinin! Papo ngridhesha vetë, ngridhja edhe nusen e fëmijët: «Priteni Alinë, kam parë ëndërr, ai sikur ka ardhur». Kurse tërë këtë javë...

Unë isha aq e pushtuar nga mallëngjimi në ato çaste, saqë nuk po e mblidhja dot veten. Më dridhej tërë trupi, dhe në lugth më dukej sikur diçka më hidhej pupthi. Babanë e mbaja mend me fytyrën ngjyrë bakri, të thatë, me forma të dukshme të koc-

kave në fytyrë, kurse tani ai kishte marrë një ngjyrë të bardhë, shumë të bardhë, që të fuste frikë në zemër. Pastaj, fytyra e tij tani vinte e mbushur, por jo me tul, më tepër si e buhavitur, si me mish të huaj. Dhe ishte zbardhur shumë. Po ta kisha parë ditën papandehur, me siguri do të dyshoja: «Është babai im ky, apo jo?» Ndofta as nuk do ta njihja, po të mos më fliste ai i pari.

— Hajde, — na ftoi babai dhe në njërin gju më mbante mua, në tjetrin Yllin.

— C'e mban atë, — i buzëqeshi nokja, — nuk e sheh, ajo është rritur, është zgjatur si shufër ari-xheshke! Nuk është tani për t'u mbajtur në prehër!

Babai më vështroi. Koka ime barabar me të tijën. Edhe vetë u turpërova. Me të vërtetë, tani nuk isha më për t'u mbajtur në prehër, po nga ta dija këtë, kur gjer në atë çast nuk më kishte marrë kush në prehër, si më merrete babai. I fërkova faqet me të dyja duart, siç bëja kurdoherë, por, sepse ndjeva si llahtarë në zemër, sikur ato të mos ishin faqet e babait tim. Më vonë vura re se edhe si karakter ai kishte ndryshuar. Nxehej shpejt e shumë herë për hiçmosgjë. E pashë nënën që qau një ditë. Nuk e di përsë i kishte folur, por, kur hyra brenda, e dëgjova që po i kërkonte falje: «Më ka shkatërruar ai i shkretë burg». «Mirë, mirë, — iu përgjigj nëna, — po unë ç'faj kam! Mos kujton ti se unë këtu e kisha xhenet?! Të dy si në zjarrin e xhehnemit kemi qenë këto kohë!»

Pasi ishin ulur e pëershëndetur, pasi pyetën edhe për miqtë e shokët, babai i tha nënës: «Ma ndiz pak atë kandilin tjetër». Ai u ngrit, e mori në dorë kandilin e ndezur që lëshonte një dritë të mekur dhe u nis nga dera. Unë i shkova pas. «Ku vete?» më kër-

cënoi nëna. U stepa menjëherë. «Jo, jo, le të vijë», foli babai. Doli në oborr e u drejtua për nga katoi i qeve. Sa u fut brenda, i fërkoi nga koka, nga zverku, nga shpatullat, u shkoi dorën mbi kurriz tej e tej e i përgëzonte, kur ato ia bënin nganjëherë «fuuu» me fejet e hundës dhe e shtynin me turi: «Na, ore Kazil!» Në atë kohë m'u kujtua legjenda e kurbetliut që ma kishte treguar gjyshja: Kurbetliut i patën thënë në rrugë: «Qeni ngordhi». «Pse?» «Se hëngri mish shumë». «C'mish hëngri?» «Mishin e mushkës». «Po pse?» «Se mushka ngordhi». «Po pse ngordhi mushka?» «Ngordhi se u lodh së mbajturi stranica». . . Dhe, duke kujtar legjendën, u gjëzova që babai i gjeti qetë në shtëpi. Pasi përkëdheli disa herë edhe gomarin, shkoi atje ku mbyllnim dhitë. Aty u rrudh. Gjysmat e dhive i kishim shitur për bukë. Nga dhentë na kishte mbetur vetëm edhe një. Atë mot ajo kishte bërë dy qingja, një femër e një mashkull, dhe gjyshja thoshte vazhdimisht: «Mashkullin do ta mbajmë, ta therim kur të na vijë Aliu». Edhe dhitë na kishin pjellë të shtata dhe i kishim mirë. Bala e Lariska na kishin bërë nga dy keca. Kur i pa, babai psherëtiu: «Gjene mirë!» Atë kohë mora kurajë e i thashë: «Qengjin mashkull të Bejkës, gjyshja ka thënë se do ta therim kur të vije ti, baba». Ai qeshi, më mori kokën në të dyja duart e tij të buhavitura, që tani në dritën e dobët të kandilit kishin një bardhësi më të frikshme e ma priti: «Ta therim pos, dhe një kofshë ta hash ti, një Ylli». Unë nuk fola vetëm i putha duart. Po ato duar unë nuk i doja të bardha, të buhavitura, doja duart e babait që përcolla, që vinin erë dhë. . . të ashpra, me plasatitje e kallo që më çirrnin faqet. Dhe erdhi e m'u bë një komb në grykë. «Po pulat?» pyeti babai. «I

kemi, — iu përgjigja me gjësim. — Kemi shtruar edhe tri klloçka. Na kllongjisë edhe dy të tjera. Me vezët e pulave bëri edhe nokja fustanin që ka veshur. A ia pe veshur? Një muaj ka që e ka bërë. Ja, sot që erdhe ti e ka veshur për herë të parë. Kishte mbetur me një fustan copë-copë!» Më puthi, duke e mbajtur kandilin larg që të mos më digjte flokët, e unë, me duart lidhur pas qafës së tij, nuk doja t'i shqitesha.

— Mirë ishin qetë, — tha babai, duke u ulur, pa e pyetur njeri se ku kishte qenë. — Edhe gomari mirë ishte. Dhitë mirë m'u dukën, të mbushura nga gjinjtë. Lopa m'u duk e dobët ca, po tanë behari është përpara. — Për ato që mungonin, ai nuk tha asnjë fjalë.

— Ali, o bir, shyqyr që më erdhe ti, — i tha gjyshja si për ngushëllim për dhitë e dhentë që kishim shitur e që ne nuk i kishim shkruar për të mos e dëshpëruar.

— Nuk të thashë gjë, moj nënë, jo.

— Bir, shyqyr dhe kaq! Nuk e pandehja, jo, nuk e pandehja! Dhe lusja: veç qetë, veç qetë e robt të më gjejë djali kur të vijë, pa të tjerat...

* * *

Ne nuk fjetëm gjersa ra, dita. Ndaj të gdhirë, nëna mori vedrën e qumështit, moli dhitë, delen e lopën. I shpejtonte duart si s'e kisha parë ndonjëherë. Dy vrushkujt e qumështit binin me zhurmë në vedër e bënин shkumë. Vedra u mbush gjer afër buzës. Unë i rrija në krah me njérën dorë në supin e saj dhe e pyesja: «Noke, noke... a u gjëzove për

babanë?» Ajo thoshte si me vete: «Burri është çadra e gruas, moj bijë!» Nuk ua dija atëherë kuptimin këtyre fjalëve, po edhe ta pyesja, ajo nxitohej e nuk do të më jepë shpjegime. «Po pér gjyshin, u gëzove?» «A u gëzove ti pér tët atë?» «Shumë, noke, shumë!» «Po edhe unë e kam baba atë». «Po dajat që i mbajtën atje, në burg, a do t'i lirojnë shpejt?» Lërmë, çupë, se dy thika i kam akoma në mushkëri!» Po vetëm se nëna tani më dukej, dhe ashtu ishte, më e shkathët, më e gjallë. Ajo, siç e kam thënë, ishte e bukur, shumë e bukur. Gjatë kohës që ndenji babai në burg, nuk i iku bukuria. Punonte, lodhej e sfilitet, keq hanim, por asaj sikur edhe uji i bëhej gjak. Dhe e shihja si përpinqej t'i fshihte hiret jo vetëm kur dilte, qoftë edhe gjer në oborr, por edhe brenda në shtëpi. Shaminë e zezë lidhur gjer mbi vetulla e hiqte vetëm kur binte të flinte. Po ashtu edhe çemberin që mbante hedhur. Por ajo shamia mbi vetulla sikur e zbukuronte edhe më. Gjyshja, kur e vinte re, psherëtintë pér të e fliste me vete: «Ruaju, moj korbë, ruaju syve të botës, se ti më je hëna pesëmbëdhjetë! Nuk gëzove të ri në nusëri, moj e zezë, pér kokën e hasmit!»

Me atë qumësht bëmë përshest e hëngrëm të gjithë. Vetëm nëna nuk u ul në sofër. Ajo u betua se nuk i hahej. Dhe, tek vinte rreth me atë fustanin e ri, pa çember e me atë shami që unë nuk e pashë kur e si e kishte nxjerrë nga sënduku, atë shami të verdhë me oja të kuqe, mua më bëhej t'i hidhja duart në qafë e të mos i shqitesha kurrë nga kraharori. Sa bukur i shkonte ajo shami në atë fytyrën e saj të bardhë, me mollëzat e faqeve gjak të kuqe.

Gjyshja, që më parë s'e kishte vënë re ndryshimin e nënës, e uroi me zë të ulët, sa ta dëgjonte ve-

tëm nëna: «Paç uratën, bijë! Paç uratën, bijë! Kaq më paç: sa thinja kam unë në kokë, aq të mira për ty, për tët shoq e fëmijët tuaj. Sa lule ka Tomori, aq të mira për këtë shtëpi!...» Atëherë, megjithëse nuk isha fare fëmijë, prapëseprapë nuk munda ta kuptoja pse e uroi gjyshja nënën. Atë mëngjes nëna kishte prishur zinë dhe gjyshja, e dëshiruar, mezi kishte pritur ta shihte atë të zbuluar.

Ca nga ca, si ra dita, m'u mësuan sytë me babanë e ndryshuar aq shumë. Tani më dukej sikur ai nuk shkonte me nënën aq të bukur. Shikoja fshehurazi me ç'sy e shikonte ajo atë, a ndiente edhe ajo atë sëmbim që ndieja unë në zemër për ndryshimin e tij, po nuk më binte asgjë në sy. Përkundrazi, ajo fluturonte nëpër shtëpi, megjithëse e shihja që bënte përpjekje ta fshihte gjëzimin. Kot që e gënjenjet veten. Kurse babait i qeshte ftyra kur i hidhte nga njëherë sytë shkarazi.

Pas mëngjesit, gjyshi, me duart mbështetur në flokësen e kuqe që i kishim shtruar, iu kthyte gjyshes në fillim, pastaj babait, e tha duke u bërë gati të çohej:

— Epo, me leje tani.

— Ku do shkosh?! — e pyeti gjyshja, e habitur.

— Në shtëpi! — tha ai me një shprehje të tillë në ftyrë, që donte të thoshte: «Edhe unë të doja të rrjaja, ti të mos më mbaje!»

— Kur të qaj djalin nuk të lë! — u betua gjyshja.

— Bobo, moj Këze, ç'be që bëre, se të tre djemtë bashkë nuk më bëjnë sa ky Ali!

— Mos luaj!

Toni i gjyshes qe sa lutës, aq edhe urdhëruar.

— Po presin, moj Këze, presin! Pa shiko si u gjëuat ju!

— E kam menduar. — Gjyshja i kishte fjalët tē pakta. — Sa tē lëshojë Bashkimi bagëtitë me rojkat e fshatit, tē shpjerë edhe qetë e lopën gjer te Bregu i Sheros dhe do ta nis pér te ju tē shpjerë sihariqin. Ju do tē hani edhe drekën, pa tē niseni. Bashkimi pér tri orë ka vajtur e ka ardhur.

— Rri, o Demir, — i tha babai, — se nëna na ka ruajtur një gjengj pirës e do tē na e therë.

— Ku e di ti? — e pyeti nëna me një zë përkëdhelës, që nuk ia kisha dëgjuar kurrë.

Babai më mori kokën e ma ngjeshi në prehër tē tij. «Kam unë, — tha, — kush m'i tregon tē gjitha».

Kur gjyshja thirri Bashkimin ta niste, babai ngriti dorën e foli në një mënyrë që s'pranonte kundërshtime:

— Jo! Jo djali!

U panë një grimë sy më sy me gjyshen e aty pér aty u morën vesh pér gjithçka.

— Po, — tha gjyshja. — Po shkoj tē dërgoj djalin e Käsemrit.

— Pse, baba? — pyeti Bashkimi i mërzitur dhe ngriu në këmbë në fund tē dhomës.

— Kemi punë, tē keqen nëna, — iu përgjigj gjyshja në vend tē babait. — Unë harrova, po qengji do pjekur, po një cikëz raki duhet gjetur hua nëpér fshat, një cikë sheqer pér ëmbëlsirën do marrë në dyqan te Kiçua.

E kuptova që gjyshja s'tha tē vërtetën. Diku gjetkë do ta kishin hallin, po s'i jepja dot udhë.

Pér drekë thirrëm edhe mësuesin. Kur vajti Bashkimi e i dha lajmin, ai e kishte puthur nga gëzimi. Me babanë, gjyshin e dajën u përqafuan fort, si miq tē vjetër. Ata pak fshatarë që e morën vesh,

— të gjithë kishin ikur me natë, ishte kohë të mbjellash, — erdhën për urim. Babai i mbajti për drekë, po nuk ndjenjën të gjithë. Aty nga ora njëmbëdhjetë ia arriti ai kushëriri i Muço Kapinovës.

— E paske marrë telegramin?! — i tha babai sa e pa dhe u përqafuan me mall.

— E mora, Ali. Me të lexuar «Djali u shërua», i thirra gruas: «Shpejt ato rroba e bëmëni gati mushkën!» E mori vesh edhe ajo si ishte puna.

Telegramin ia kishte bërë Thomai, xhokaxhiu. Kështu e kishin bërë me fjalë. Po pse «Djali u shërua» e jo «Aliu u lirua»? Edhe këtë nuk po e kuptoja.

Gëzimin e asaj dreke nuk mundem ta përshkruaj as tani, ashtu si e ndjeva dhe e jetova. Babai këndoi, domosdo. Po këndoi edhe gjyshi, edhe daja; kushëriri i Muços po ashtu, të tjerët ca më shumë. Më kishte marrë malli për këngën e babait:

*O kjo an'e lumit,
ka bilbila shumë,*

.....

*Fusha na bën baltë,
mali bën furtunë.*

.....

*Nepërk'e shullërit,
rriturë pa ujë...*

Babai kishte zë të ëmbël, kumbues dhe të rrëmbente... Ai zë dukej sikur të hynte në çdo qelizë, ta bënte trupin të lehtë, të conte peshë, humbisje, s'dije ku ishe... Me zérin e tij mbushej shtëpia e jonet e këngës dukej sikur shpërndaheshin, shpërthenin ç-

ttnë e përhapeshin mbi kopsht, mbi pemë e pjergulla... saqë të dukej në ato çaste se çdo tingull e zhurmë tjetër ishte shuar. Këngët e tij ishin rënkim e gëzim, uturimë e shushurimë, edhe mallkim, edhe kërcënim, edhe mall, edhe brengë...

Kur këndoi gjyshi, nëna qau. Pastaj ajo i teri shpejt e shpejt lotët e nuk e bëri veten. Ndofta i qe kujtuar dajë Qemali, se dëgjova gjyshin kur i tha babait: «Mbama, o Ali, se këtu në shtëpinë tënde, jo në timen, më takon...» Kuptohet, ai donte të shton te: «...ta prish zinë e atij djali, që më përvëloj shpirtin».

Sa nevojë kisha për këtë gëzim! Sa nevojë kishim të gjithë. «Tani e tutje do të jemi të gëzuar», mendoja. «Babai na erdhi. Nëna e prishi zinë. Babai për ndihmë ka tani edhe Bashkimin...»

VII

Gostia u shkreh vonë. Mua më erdhi keq që u mbaruan këngët e vallet, ato biseda të përzemërta, ato urime. Në përcjellje e sipër babai i pëshpëriti gjyshit: «Me mend!» Dhe ai i tundi kokën lehtë-lehtë, si t'i thoshte: «Rri i qetë». Po pse?!

Mësuesi e kushëriri i Muço Kapinovës nuk ikën. Babai mori një rrobë, e shtroi prapa shtëpisë e u ulën atje të tre. U ula edhe unë. Babai, nuk ma hiqte dorën nga koka, që e mbaja mbështetur te gjuri i tij. Ata bisedonin.

Babai: — Siç e dini, donin të na helmonin, derrat. Kishin paguar një gardian që të na hidhte helm në ushqime.

Kushëriri i Muços: — Të mos qenkësh ai xhандari nga anët tona...

— Babai: — E pimë ne! Shkuam për dhjamë qeni. Na tha ai: «Çdo gjë që ju vjen nga dorë tjetër, goftë edhe një cigare duhan, nuk do ta vini në gojë. Vëtëm ato që do t'ju bie unë». Dhe na bënë mاشalla.

Kushërirri i Muços: — I jemi shumë borxhli atij djali.

Mësuesi: — E kemi tonin atë.

Babai: — Ai na informoi edhe para se të dilnim nga burgu: «Bejlerët kanë paguar njerëz që, kur të liroheni, apo dy-tri ditë para se të liroheni, t'i njof-tojnë. Ndofta kanë ndër mend t'ju bëjnë ndonjë pri-të rrugës, prandaj hapni sytë. Mund t'ju qëllojnë edhe brenda në pazar njerëz të futur prej tyre». Prandaj e lamë edhe atë parullë bashkë, — i tha kushëririt të Muços, — që Thomai të të thoshte në telegram: *Djali u shërua*.

Kushërirri i Muços: — Po, po. Dhe bëmë mirë. Kanë këlyshët e tyre ata edhe në Çorovodë, edhe ngado. Po nga erdhët ju?

Babai: — Kur dolëm nga burgu, na priu përpara ai xhandari. Shkuam në han. Atje hëngrëm dy kafshita bukë më këmbë. E qëroi mirë vendin ai xhandari, se kishte edhe shokë të tjerë ai, nuk ishte vetëm. — U kthyen nga mësuesi: — Apo jo, zoti mësues? Ma ha mendja se...

Mësuesi: — Për daljen tuaj nga Berati ishin marrë të gjitha masat. Vazhdo, vazhdo.

Babai: — Dhe kështu, që thoni ju, si hëngrëm dy kafshita bukë më han, **morëm bukë edhe përrugës; dhe me atë djalin** më mes, — e kishte fjalën përxhandarin nga anët tonë, — i ramë përmes pazarit të bulmetit, dolëm të Tri Furrat, përpjetë, në qafë

të kalasë, në Shëndëlli, përmes Gërricës, te Lisi i Langores e pastaj, duke bërë rrugë pa rrugë, herë mbi udhë, herë nën udhë, dolëm te Qafa e Pazjanit. E lamë atë më të djathët se dyshonim atje, ia therëm pastaj përpjetë... Nata na zuri pa kaluar Qafën e Dardhës...

* * *

Dalngadalë po filloja të kuptoja shumë gjëra. Tani e tutje bejlerët do të përpinqeshin të shtinin mbi babanë. Dhe jo vetëm mbi babanë. Ata mund të shtinin edhe mbi Bashkimin. Për një çast m'u përfytyrua vëllai i shtrirë në mes të shtëpisë, si dikur dajë Qemali. Sa tmerr! Ndaj kisha dëgjuar kushedi sa herë gjyshen që, tek rrinte, fliste si me vete:

*Hallet e mia me mijë,
vallë, si unë kush mundohet?!
Edhe nepërka të pijë
prej gjakut tim, helmohet.*

Prandaj, — mendoja me vete, — prandaj tha babai: «Jo! Jo djali!», kur donte ta dërgonte gjyshja në Arrishtë. Prandaj i tha ai edhe gjyshit, kur e përçolli: «Me mend!» Mirë «me mend», po a mund t'i ruheshe hasmit?! Duke më treguar gjyshja ato historitë e vërteta, a nuk më pati thënë sa herë: «Lumi fle, hasmi s'fle, moj bijë.» Sa ruhej Asllan beu, po, më në fund... Pastaj bejlerët kanë para dhe...»

Bashkfshatarët që patën qëndruar për drekë te ne, erdhën aty ku **bisedonin** **babai** **me** **mësuesin** **e** kushëririn e Muços.

— Kujtuam se do të flinit, se ishit pa gjumë, — i thanë babait, — po kur ju pamë...

— Nuk kam gjumë, po kam mall, — tha babai, — e i mbajta këta miqtë. Bëtë mirë që erdhët.

— Ta kishim ditur, nuk do të kishim ikur as ne.

Pas tyre kushdo që kthehej nga puna, me ta marrë vesh, frymën te ne e mbante. Hapnin krahët që atje tej e përqafoheshin me babanë, pa u shkëputur nga krahët e shoshoqit. Ca nga ca pothua u mblo-dhën gjithë fshati. Burrat jashtë e gratë brenda. Të gjithë të rriturit nëna i qeraste me nga një filxhan me sherbet sheqeri (Ku kishim kafe ne atëherë!) Fëmijëve u jepte nga një pafkë sheqeri.

U krijua një gjendje e gëzuar. Më rrëmbeu ai gëzim dhe e harrova brengën time. Po kohë më kohë prapë më shkonte mendja e lutesha, po si me gjysmë zemre: Ah, sikur të shpërthejë ai deti nën Tomor! Për një çast më dukej sikur deti do të shpërthente vërtet dhe e penduar thosha: Babai na erdhi. Tani me babanë ne... Përsëri e humbisja mendjen nga gëzimi. Shoqet më puthnin të mallëngjyera. Nuk më rrihej. Nuk më mbante vendi. Gjeta rast e i pëshpërita nënës: «Noke....» Ajo më pa me ngulm. Kushedi si isha prerë në fytyrë. «Budallaqe — më tha. — Po pse, aq i pazoti është yt atë, sa ta vrasin?! Nuk është aq i humbur ai, jo! Shko moj, loz me shoqet!» E pashë se ato fjalë nuk qenë vetëm sa për të më ngushëlluar mua. Ato nënës i dilnin nga shpirti dhe tregonin besimin që kishte ajo te babai. U futa në turmë më e lehtësuar shpirtërisht, por gëzimi i madh i paraditës m'u plagos e sikur e shihja herë pas here tek prapulizoj si diçka konkrete, tamam si ajo pula kur i pret kokën.

VIII

Babai ruhej. Në mëngjes ngrihej nëna e para, kontrollonte rrëth e rrotull shtëpisë, mos diktonte gjë, pastaj dilnin babai e Bashkimi. Ne ishim ngushtë pér bulkë e nuk mbanim dot as qen. Me se ta ushqenim? Por tani na duhej. Na dhanë në fshat një qen të fortë, që e lëshonim natën vonë e në mëngjes herët e lidhnik. Sa herë largohej nga shtëpia, babai nuk i tregonte kujtdo se ku do të shkonte. Revolen e hiqte nga brezi vetëm kur binte pér të fjetur. Edhe atëherë e vinte gjithmonë nën jastëk.

E vërteta është se prita rrëth shtëpisë nuk kishim diktuar. Babanë ë mbronte i gjithë fshati. Një gjë të vogël të dyshimtë po të diktonte ndokush, qoftë edhe një fëmijë, do të vinte e ta njoftonte babanë: «Ki mendjen se kam parë dy vetë me gunë», «Qeni im ka lehur shumë mbrëmë dhe lehte më njeri».

Gjyshi, kur erdhi një herë, i tha: «Ai njeriu që di ti, thotë se djemtë e Asllan beut nuk kanë ndër mend të shtien. Na e mori hakun qeveria, thonë. Dy vetë po kalben atje në burgun e Burrelit. Ata nuk dalin më të gjallë. Kështu thonë. Sidoqoftë mendjen duhet ta kemi. Nuk dihet ç'zien nën lëkurën e tyre, ia priti babai e gjyshi pohoi me kokë «po, po».

* * *

Ditët mezi kalonin. Kaq me plogështi ecte koha, saqë të hipte një mërzi e padurueshme. Fjalët që dëgjoja ishin: «krizë! qesatllëk!» Unë as që i kuptoja këto dy fjalë. Pastaj vazhdonin ankimet: «Jemi keq pér bukë!», «Shtrenjtësi e madhe!» Kur ishte puna pér të shitur prodhimet, fshatarët ankoreshin: «Lirësi, kiamet! me se ta zëmë lekun!» Kur bëhej fjalë pér krizën, vazhdonin qarjet: «Nuk ka punë gjëkund! Lidhet burri pér një lek! Një lek nuk e tërheqin dot as një pendë buaj!» Pa vinte dhe taksidari çdo dy-tre muaj. «Nuk kemi! — thoshin fshatarët. — Në keni urdhër të merrni shpirt, merrni!» TakSIDARI, sa herë vinte, dy xhandarë do t'i kishte me vete. Disa herë edhe postëkomandantin. «Mbanani gjer nesër në mëngjes, — u thoshin atyre fshatarët, — mbanani sa të doni, ne nuk kemi. Po na vdesin fëmijët pér kafshatën e bukës e pér lugën e dhallit!»

Pastaj fillonin sekuestrimet. Kujt i merrte taksidari një gjym, kujt një kazan, kujt të gjitha enët e bakërtë që kishin një farë vlere. Ndonjërit lopën apo kaun e parmandës. Atëherë fillonin ulërimat e fëmijëve e bërtitjet e grave.

Nuk kishte as një muaj që ishte liruar babai,

kur na erdhi edhe neve taksidari. S'kishim as dy ja-vë që kishim ndarë kecat nga dhitë. Qumështin në-na e zinte kos dhe tundte nga pak çdo ditë. «Të mbledhim një thërime gjalpë, ta shesim e të bëjë yt atë ndërresa», më thoshte nëna. Dhe unë nuk i kër-koja as dhallë, se dhalli duhej bërë gjizë. E haja bu-kën me domate, me qepë e kripë, që të mund të mblidhnik pak gjizë për dimër. Nënës i vinte keq e në dy-tri ditë na bënte përhesh me dhallë. Kur erdhi taksidari e hapi defterët, të parin thirri baba-në. Kështu, ato dy a tri kile gjalpë që ishin mble-dhur për këmishën e babait, u shitën për të paguar një pjesë të taksave, sa për t'i myllur gojën taksi-darit. «Korba unë, ju thava ju për një lugë dhallë dhe tani vjen e na e merr taksidari!» më tha nëna. Pastaj ngriti kokën nga qielli e thirri: «O zot, helm bëjua! O zot, mos durofsh e na marrsh hak!» Në atë çast desha të rrëmbeja një gur e t'ia vërvitja taksi-darit atje, te sheshi ku ishte ulur mbi një shilte këmbëkryq e përbysë mbi ata registrat e mëdhenj.

Bashkë me vajza e djem të tjerë, moshatarë me mua, shkonim ruanim kecat apo kullotnim lopët. Nëpër pyll gjenim kaçe. Ato në rrënëjë kishin nga një kokërr sa një lajthi e disa herë pak më të madhe. I shkulnim me kujdes, i pastronim me dorë si mundnim e i hanim. Njëherë një shoqja ime më thotë: «Di një lloj luleje që ka mjaltë. Më ka mësuar nëna». Kërkuam një ditë të tërë, po nuk gjetëm. Ditën e dytë i lëshuam kecat në një krah tjetër. Andej kishte plot lule të tillë. I këputnim e i thith-nim në fund. Me të vërtetë na vinte në gojë një bulëz ëmbëlsirë. Po merreni me mend sa mund të na e shuanin ato urinë. Edhe një mijë copë sikur të thithnim prej tyre, nuk mbushej, mendoj, as gjysmë

luge kafeje me atë lëng të ëmbël. Në vjeshtë ishte ndryshe. Atëherë gjithandej «kullotnim», se kishte pylli plot manaferra, lajthi, arra, mollë të egra, gorrica, lerushk dhe e bënim barkun «pipëz», siç thoshim atëherë. Kur kthehesha në shtëpi, në mbrëmje, i gostitja me kaçe edhe dy vëllezërit e vegjël. Hiqja mënjanë për ta njëzet-tridhjetë kokrra. Po nganjëherë, kur më grinte uria, gjer në mbrëmje i gjysmoja edhe ato. Kurse në vjeshtë u mbushja duart plot. Tek më shihte gjyshja, thoshte: «Eh, ç'është motra për vëllanë!» Në kohën e manaferrave kisha edhe gjyshen për t'i dhënë. Madje ajo ishte e para, se i pëlgente shumë. «Janë pak si të athëta, — thoshte, — dhe më mbledhin shpirtin».

Babai luftonte si e si të nxirrte lekun. I vetmi burim ishte salepi. Ai bëhej në mal e shitej shtrenjtë. Por, që të mblidhje një kile salep të thatë, duhej të dërsije ditë të tëra. Nganjëherë, babai merrte me vete edhe Bashkimin në mal. Rruga gjer te gropat ku bëhej salepi, mbante nja dy orë të mira dhe ata ose ktheheshin natën vonë, ose gdhiheshin atje net me radhë.

Mësuesi, tani që kishte ardhur babai, na vinte shpesh në shtëpi. Bisedonim të dy me orë të tëra, gjer vonë, herë me zë të ulët, herë normalisht. Lekxonin ndonjë gazetë që sillte mësuesi. Njëherë, nuk di ku e kishin fjalën, po dëgjova që mësuesi i tha babait: «Ali, pse thoni që nuk di? Juve...» dhe buzëqeshi. Edhe babai ia ktheu po duke buzëqeshur: «Zoti mësues, po pate bërë burg, i di ligjet në majë të gishtave, sepse atje s'ke tjetër punë vetëm se: *me sa u dënone ti, me sa ai, c'en të zuri ty e c'en zuri atë...* Mësuesi qeshi sa vuri duart në ije. «Si, si the? Para se t'ia priste gjyqi ndonjërit dënimin, ia

caktonit ju më parë?» «Po, po. Njëri nga Sulova na u zemërua keq. Ma ndollët ju, tha, prandaj më dënuan kaq rëndë».

Një ditë ata po rrini prapa shtëpisë. Akoma nuk ishte errur. Babai nxori tri copa letre nga xhepi. «Zoti mësues, do të më flasësh drejt, se dua ta di kujt t'i jem mirënjojës. Nëna ka ruajtur këto letra...» Unë e dija se vetëm një letër kishim gjetur në thesin me misër. Po, si duket, gjyshja dhe nëna kishin gjetur thasë me misër edhe herë të tjera te dera. «Ali, — i tha mësuesi, — me emër të njihja si shokun e Rizait... Kam bërë një detyrë... Po të mundja më shumë... Ndoqa atë rrugë, se bejlerët më kishin në shenjë dhe dyshoja se mos xhixhe Këzja nuk do ta pranonte...»

Rrallëherë mësuesi i lexonte babait ca gazeta me një letër të hollë, gati si letër cigareje. Kur sillte të tilla, bëheshin kokë më kokë e i lexonin me zë të ulët. Kurse mua më porositnin: «Shiko nganjëherë jashtë, mos vijë njeri». Atëherë kuptoja vetëm kaq: ato gazeta nuk duhej t'i dinin të tjerët. Vetëm vonë mësova se i dërgonin emigrantë politikë fshehurazi dhe në to shkruante edhe Riza Cerova. Njëherë, duke lexuar, babai foli me habi: «Sa bukur e ka thënë Rizai, zoti mësues: *Kush ka një pushkë, le ta rrëmbejë, kush ka një zemër, të mos e kursejë*. Si thua, zoti mësues, të bëhet gjë?» Ai i foli gjatë, po veç me zë shumë të ulët. Fjalë krejt të pakuptueshme më rrëmbente veshi. «KONARE», «revolucion», «proletariat», «Lenin», «Stalin». Kurse babai vetëm dëgjonte e shumë rrallë i bënte ndonjë pyetje.

IX

Ishte errur. Më kujtohet si tani. Atë natë, si shumë herë të tjera, babai mbajti për darkë edhe mësuesin. «Nënë, — thirri që jashtë, — na ther një zog sot, se kemi edhe Astritin». Ai kishte disa kohë që nuk i thërriste më «zoti mësues». Pasi iku ai, babai tha: «Morët vesh ju?! Ka ardhur Riza Cerrova». «Rizai?!» «Po. Është në Elbasan dhe nuk e lënë të lëvizë që andej». «Do ta vrasin të ziun!» — thirri gjyshja. «Si ka ardhur ai! Si iu fal këtij qeni?!» Unë e dija se «qen» ata thoshin për Zogun. «S'ka bërë mirë! — tha prapë ankueshëm gjyshja. — Jo, jo, s'ka bërë mirë!» «Nuk falet Rizai, — ia priti babai plot besim, — po kushedi si e ka punën». U bë qetësi e plotë për një copë herë. «Nesër do të nisem të vete ta takoj», e theu heshtjen babai. Gjy-

shja dhe nëna nuk shfaqën asnë mendim. «Më shtini një kulaçë bukë për rrugës, se nesër do të ngrihem pa feksur», vazhdoi ai.

Pas tri ditësh, kur u kthye nga takimi me Rizanë, babai ishte i çelur në fytyrë. «Më pyeti, — i tha gjyshes, — edhe për ty edhe për Eminenë. (Emine më quanin nënën.) Kujtoi kur i shpinit bukë te Shpella e Shites. Më pyeti për Bashkimin e për Lirinë. Si i ke, se ua kam vënë emrat vetë, më tha. Qessa me të. Bashkim kemi, i thashë, po liri jo, or vëlla, jo. Më vështroi një grimë i menduar e më tha se do të bisedonim. «Si ishte me shëndet?», e pyeti gjyshja. «Shumë mirë, veç nuk është ai Rizai lavrak që mban mend ti, nënë». «Epo, u bë tridhjetë e pesë vjeç, or bir! Asokohe ishte fare i ri». «Vetëm se, — babai mblodhi grushtin dhe e tundi në ajër, — nga të gjitha të tjerat është ai Rizai që dimë ne». «Asllani qenit nuk ia ka ulur kurrë kokën, or bir. Rizai është asllan!»

Sa kohë ndenji Rizai në Shqipëri, babai vajti e takoi edhe dy herë të tjera gjer në Tiranë.

* * *

Diçka po ziente, diçka po lëvizte. Në sytë e babait lexohej qartë një shqetësim i përhershëm. Dukej si shumë i merakosur për diçka që vetëm ai e dinte. E shihja gjithnjë të vëmendshëm, përgjues, gjithnjë me veshët bigë e gjithmonë në pritje të diçkaje. I mbyllur tërësisht në vetvete, rrallëherë bisedonte me gjyshen e me nënën, po në këso rastesh ne na përzinin jashtë, ose na thoshin të shkonim në dhomën tjetër. Lëvizjet e babait për në pa-

zar, për te gjyshi, te miqtë e shokët, madje edhe brenda për brenda në fshat tanë kishin diçka të fshehtë, që unë s'e merrja dot vesh. Mirë nga bejlerët e Arrishtës, po nga këta të fshatit pse ruhej babai aq shumë?! Këtë s'po e kuptoja dot. U përpoqa të mësoja qoftë edhe një fjalë, por heshtte babai, heshtte nëna, heshtte edhe gjyshja. Bile gjyshja këtë radhë ma priste shkurt e si shumë e zemëruar: «Mbylle buçen! Do ta marrësh vesh. Ka kohë. Kur të bëhet». «Po ç'do të bëhet, moj gjyshe?» «Hajt, qepe tanë, se nuk je e vogël. Bëj si të them, se je tamam, për të hipur në kalë!»

* * *

Bënte shumë vapë. Megjithëse malësi, netët ishin të nxehtha. Kishim kohë që kishim rënë të flinim. Trokitën tri herë në dritare, gjithnjë në atë dritaren pas shtëpisë. Eh, sa kujtime ruaj për atë dritaren që shikonte nga kopshti. U zgjova unë e para. «Kush është?» «Jam Ramizi. Zgjoje Alinë», më tha me ngut. E zgjova babanë, që kishte ardhur aq i lodhur. Bashkë me Bashkimin kishin qenë në mal për salep e një javë të tërë s'ishin kthyer në shtëpi.

Dialogun e asaj nate midis babait e Ramizit e kam të gjallë, si ta kem dëgjuar sot. Dolën të dy në hajat. Të gjithë të tjerët flinin.

— Si është puna?

— Rizai ka ardhur në Cerovë!

— Ç'thotë, si venë punët?

— Ç'thotë? Ai na e ka thënë me kohë, që kur e takuam në Tiranë: «Nuk bëhet kryengritje me bejlerët!»

— Pse? Ç'ka ndodhur?
— Ka tradhtuar Qemal Vrioni.
— Qeni! — shfryu babai.
— Qen, po çfarë qeni se! T'i tretësh plumbin në gojë.

— Po tanë si do bëhet?

— Kanë bërë mbledhje në Tiranë. Ata të grupeve të tjera sikur nuk kanë dashur, po Rizai ka ngulur këmbë: *Unë ju pata thënë që të përgatitim popullin më parë, pastaj kryengritjen*. Të futemi në popull. Por, meqë tanë u bë kështu, u tradhtuan, kryengritja duhet bërë doemos dhe duhet shpejtuar.

— E si e kanë vendosur?

— Tani, më 14 korrik. Rizai ka ardhur në Skrapar... Ti këto dy ditë lajmëro shokët këtu në fshat, në Arrishtë... dhe të jeni gati. Natën e 13 korrikut do të grumbullohemi në Polican.

— Po mësuesin?

— Mësuesi nuk është në fshat. I dërgova një letër nga Rizai dhe ai na pret në Berat, kur të hyjmë. Ka tjetër mision ai, më duket, në qytet.

— Na daltë pér hajër! — uroi babai dhe në zërin e tij dallova gjëzim, besim, vendosmëri, urrejtje.

— Do të rrish gjer në mëngjes? — e pyeti pastaj Ramizin.

— Jooo! Ika unë. Na daltë pér hajër!

— Pér hajër do të na dalë. Udhë mbarë! Pjekjen në Polican?

— Në Polican.

Ramizi iku. Babai ndezi edhe dy cigare në hajat njérën pas tjetrës, pastaj qetë-qetë shkoi në dhomën e tij.

Nuk më zuri gjumi gjersa u gdhi. Çfarë nuk solla

nëpër mend gjatë atyre dy-tri orëve. Kryengritje. Çfarë ishte kryengritja?

— Emine, — i tha babai, natën e 12 korrikut, — sido që të bëhet, ke amanet fëmijët.

Zëri i tij ishte i qetë. Fytyrën të menduar, po aspak të trembur. Ata nuk më shihnin mua.

— Pse ndjell kob?! — e qortoi nëna.

— Grua, — zëri i babait u bë më i shtruar, — në luftë po shkoj, nuk po shkoj në dasmë. Njeriu t'i bëjë hesap të gjitha.

— E, e, mjaft! Të dëgjova, të dëgjova!

Ai hëngri edhe darkën e unë nuk e pashë më, si iku e me sa shokë iku. Në mëngjesasnë nuk pyeti pér të. Si dukej edhe Bashkimi e dintë. Kurse dy vëllezërit e vegjël nuk kuptionin asgjë. Tërë atë ditë më bëhej sikur gjithë fshati kishte rënë në heshtje. Sikur të gjithë prisnin diçka.

Katër ditë më vonë, kur u ngrita në mëngjes, dëgjova nënën që i foli Yllit:

— Mbylle, mos qaj, se po fle yt atë!

Gjyshja, e mërzitur si s'e kisha parë kurrë, mori shatin e i tha nënës:

— Mos tund tanë, se zgjon Alinë. Unë po shkoj të prashit ato domate, se u ka hipur bari. Ti bëj lakkorin e drekës. Pastaj tund.

Edhe nëna ishte shumë e mërzitur.

Shkova te gjyshja në kopsht. Këputa një domate të madhe e po haja mëngjesin me uri. E shihja që gjyshja nuk kishte aspak dëshirë të bisedonim, si zakonisht. E mbylla edhe unë gojën më keq se ajo. Pastaj shkova në Gurraz e ktheva ujin, se e ki-

shim né radhën e ujijes. Bashkimi, nga ana tjetër, shkoi né arë të priste ujin. Sa u ktheva, u ula nën hijen e fikut né fund të kopshtit. Ndérkaq nga shtëpia doli babai me xhaketën krahëve, i vrenjtur né fytyrë dhe erdhi u ul aty me mua. Më férkoi kokën, po pa qejf fare dhe i tha gjyshes:

— Mjaft, o nënë, mjaft, se i prashit unë ato që kanë mbetur.

Gjyshja, e lodhur, e këputur, pikë e vrer, duke rënduar pas bishtit të shatit, u ul pranë babait dhe e pyeti me dhimbje:

— Po si, or Ali, or bir, nuk u bë gjë, ë?!

— Dështoi, o nënë.

Tek tha këto fjalë, m'u duk se ndiente aq dhimbje, sikur t'i qe këputur një copë e zemrës.

— Shiko, — m'u kanos gjyshja, — se mos fja losesh me njeri!

— Lëre, — e qetësoi babai, i mërzitur, — tanë mori fund çdo gjë. Po të na kallëzojë njeri do të më arrestojnë patjetër.

— Si ishte puna, mor bir?

— U shpejtuani ata të Fierit. Kështu, në vend që të pëlciste më 14, plasi që më 13. Kjo bëri të merrte erë puna.

— Po Rizai?

— U mërzit shumë. Kur u mblodhëm në Polican për t'i rënë Beratit, gati sa nuk fluturonte. «Dëgjoni shokë, — na tha, — ju u mblodhët këtu jo se ju thirra unë, po se ju thirri zemra juaj. Ju mblodhën këtu lotët e fëmijëve, gjaku i Muços, vuajtjet tuaja për bukë, për ilaqe, për doktor, për shkolla. Ju keni dëgjuar, o shokë e vëllezër, — na tha, — se si thonë pleqtë tanë në Skrapar: Nën Tomor éshtë një det... Deti nën Tomor jemi ne éshtë populli! Dhe

ne do ta përbysim qeverinë e sotme. Do t'u tretim plumb në gojë Ahmet Zogut e larove që i lëpihen». «Hiqna udhën, o Riza, — i thamë të gjithë me një gojë. — Ne këtë ditë kemi pritur. Kjo erdhi. Tani na dil përpara e ne na ke pas.» «Armët tonë të pathyera!» — thirri ai dhe ngriti maliherin lart. «Armët e pathyera!» — thirrëm edhe ne. Në atë çast m'u kujtua Rizai që mbaja mend në Luftën e Vlorës më Njëzetën, kur morëm Beratin në maj të Njëzetekatrës.

Gjyshja psherëtiu thellë:

— Ta kisha parë një herë. Më ka marrë malli për të. Gjer ku e përcolle?

— Gjer në Rrurrazt e Kuçit. Atje më tha: Kthehu! Unë nuk doja. Ai m'u betua. «Këtë radhë rëtmet për Ahmet Zogun, — më tha, — radhën tjetër do bëhet kiameti për të. Ne i duam shokët këtu, brenda në Shqipëri, nuk ka nevojë për jashtë. Prishja nga brenda do t'i vijë atij qeni, jo nga jashtë!» Kështu, u puthëm e u ndamë. Tani... — Babai ngriti duart, si të përballonë çdo furtunë që do t'i vinte që në atë çast, me tërë guximin e vendosmërinë e tij dhe shtoi: — Do ta heqim çdo gjë që do të na zërë.

— Po nuk të spiunoi njeri... — foli gjyshja pa e çuar mendimin gjer në fund.

— Druaj shumë se mos i shtyjnë urët bejlerët, — tha babai. — Duke përfituar nga ky rast, dinë, s'dinë gjë, ata e dinë që unë me Rizanë... dhe venë e thonë: Futeni brenda, se e dimë ne që ka qenë me Rizanë, pjesëtar në kryengritje. Kaq do qeveria për të më rrasur brenda. Përveç atyre s'ka kush spiunon.

* * *

Afroi dreka. Babai thirri që nga kopshti:

— Emine, a na bëre dy kafshita bukë?

— Ja edhe pak, sa të ftohet lako rori, se tani e hoqa nga zjarri.

Në këtë kohë në krye të fshatit, u dhanë ca njerëz. Në fillim ishin pak, pastaj u shtuan. Që an-dej ata nuk na shihnin.

— Ç'janë ata? — pyeti gjyshja dhe vuri dorën si strehë.

— 'Xhandarë, — tha babai me zë të qetë, por në fytyrë ndryshoi menjëherë. Pastaj foli si me vete: — Të kisha ngrënë bukë, të shkretën! Kam shumë uri.

Me xhandarët ishin edhe shumë civilë të armatosur. Kryeplaku, që e kishin vënë në mes dy oficerë, duke drejtuar shkopin, u tregoi shtëpinë tonë.

— E sheh!? — i tha babai gjyshes. — Të tha-shë që bejlerët do spiunonin!?

— Bëji gjoks, or bir, tani! — ia priti ajo.

Zemra sikur m'u thërrmua në një mijë copa.

E si do t'i bënte gjoks babai! Gjer atëherë nuk ishte marrë vesh pushkatimi i njëmbëdhjetë xhan-darëve në Fier, midis të cilëve kishte qenë edhe ai skraparliu i ri që shpëtoi babanë e dajat nga hel-mimi në burg. Prandaj mendova vetëm si «do t'i bënte gjoks» dhe as që më shkoi ndër mend se edhe mund ta pushkatonin babanë. Aty për aty me-ndja më shkoi vetëm te burgu dhe m'u kujtua ajo bardhësia e frikshme e fytyrës së babait, buhavitja e tij... Bëji gjoks, or bir! Ku e kisha dëgjuar edhe tjetër herë?

*Shqiptarët në breg të detit
po luftojnë turqit osmanë,
se ç'i bëjnë gjoks dovletit
si zogjtë në tramundanë!*

Ç'ishte dovleti dhe ç'ishte tramundana m'i kishte shpjeguar gjyshja me kohë, që kur e kisha dëgjuar këtë këngë pér herë të parë. Dhe përnjëherë përfytyrova babanë duke luftuar si zgalem me tramundanën. Kur e pata pyetur gjyshen: «Po si i bëjnë dot ballë çocërrit gjithë asaj ere?» Ajo pati qeshur. «Po jo, moj zemër, jo, nuk janë çocërr e cincra ata lloj zogjsh që i bëjnë ballë tramundanës! Janë të tjerë zogj ata!»

Xhandarët, me të dalë në krÿe të fshatit, u ndanë më dysh, sipas urdhrit të oficerëve dhe kryeplakut. Një pjesë morën djathtas shtëpisë sonë, një pjesë majtas. Po na rrethonin shtëpinë.

Në çast m'u kujtua që pak më përpara babai kishte thënë se kishte uri dhe brodha brenda. Nëna kishte dalë të mbushte ujë në çezmë. Rrëmbeva tërë tepsinë me lakror e shkova ia vura babait përpara. Ai më pa i mallëngjyer. «Shqipe e babait!», më përgëzoi e filloi të hante i qetë, duke na ftuar edhe mua me gjyshen. Për t'i bërë qejfin, u ulëm edhe ne. Duke ngrënë, babai porositi gjyshen:

— ...Atë çikë grurë që ka mbetur pa korrur, ta korrë shpejt Bashkimi, se pastaj ai bie i téri në arë... Për zahrenë e gjësë së gjallë në dimër.

Ndjeva një rrëqethje në tërë trupin, duart e këmbët m'u mpinë e në shpatulla ndjeva të ftohtë... U përhoqa të mblidhja veten, por, sa vinte, sendet rrëth meje po ndryshonin ngjyrat.

— Keq do ta keni, — po thoshte babai, — e di.

Po tani fëmijët u rritën. Bashkimin e keni. Edhe Liria, në mos shumë, pak do t'ju japë dorë. Se edhe kjo u bë tamam tani...

Kur dëgjova të thoshte kështu për mua, në çast e mblođha veten.

— Mos ki merak, baba, për shtëpinë, — i thashë me zë lutës.

Ai u mallëngjye, e, duke hapur krahët, më tha:

— Nuk ka pse të ketë merak baba, jo, se ju ka ju. As ju mos kini merak për mua. — Dhe më shtrëngoi në kraharor.

Në këto e sipër në krye të lëmit u dha kryeplaku me xhandarët.

— Ali, të kërkojnë, — tha ai që njëzet-tridhjetë metra larg.

— E mora vesh që kur më rrrethuat shtëpinë, — u përgjigj babai qetë e nuk reshti së ngrëni. Përkundrazi, i ftoi edhe ata tërë qesëndi: — Bujrëm. — Dhe pa lëvizur fare nga vendi, vazhdoi të hante.

— Duhet të vish tani! — nguli këmbë kryeplaku me një zë si të lehte një qen lanxho.

— Edhe kur e marrin për ta varur njeriun, nuk e ngrenë nga buka. Jemi shqiptarë ne!... As kam vrarë, as kam prerë njeri!

— Urdhri...

Xhandarët nuk flisnin vetëm se rrinin me pushtët gati, sikur babai të ishte zog e do t'u fluturonte nga lëmi. Pak më larg kishte xhandarë të tjerrë, që përpigeshin të rrinin fshehur, por që s'i shpëtuant dot syrit tim.

— Shko thuaji atij që ka dhënë atë urdhër, se unë do të ha bukë njëherë, do të ndez edhe një duhan... pastaj le të bëjë ai të vetën, — i tha babai kryeplakut. Pastaj u drejtua nga xhandarët; — Rrini

rehat ju, rrini rehat, se, po të kisha bërë ndonjë krim e po të doja të mos ju bija në dorë, nuk më zinit dot këtu, nën hijen e fikut, me lakror përpara... — Hajde, bujrëm, po patët uri.

«...do të ndez edhe një duhan...», kështu u tha babai. Po këtë ku e kisha dëgjuar? Edhe këtë herë më erdhën ndër mend këngët që më këndonte gjithmonë gjyshja.

— *Ngrehu, Bilbil, të të hedh litarë!*
— *Dale bej, të dredh cigarë,*
se nuk jam çanak me dhallë,
po jam Bilbili me pallë!

Ishte kënga e trembëdhjetë Bilbilenjve.

Kryeplaku iku e pas pak u kthyte me një kapiten barkmadh e me një toger në moshën e babait.

— Çohu! — iu kanosën të dy në një gojë.

Babai e njozu kapitenin.

— Më ngadalë, zoti Veiz, — i tha, — se nuk të kam ngrënë ndonjë karçin nga kopeja e zotërisë sate! Dhe ti e di mirë se Ali Vigani, vërtet e ka xhamadanin të grisur, po nuk i është grisur së bëri tema mena të tjerëve.

Kapiteni gati u çmend. Nxori revolen dhe po e tundte në ajër gjithnjë në drejtim të babait:

— Të... të... të...

— E çfarë «të... të... të...», e përqeshi babai. — Fute brenda atë revole! Ali Viganit, ti e di mirë, nuk i janë verbuar sytë nga pluhuri, duke mbajtur dorën në vithet e kalit të të tjerëve.

— Prangat! Prangat!.... — urdhëroi kapiteni xhandarët.

Dhëmbët e mëdhenj e të verdhë i kërciste si

ujk i plagosur, pa guxuar tē bēnte qoftë edhe një hap pérpara. Babai ia kishte mbërthyer sytë nē një ményrë kërcënuese, që e detyronin tē qëndronte larg.

Babai shtyu tepsinë e lakrorit, e ndezi edhe një cigare nē kohën që togeri po merrej me kapitenin, gjoja pér ta bindur tē fuste revolen nē brez, pastaj u çua nē këmbë e u tha xhandarëve, rëndë e burrërisht:

— Tani bëni punën tuaj.

Shtëpinë tonë e kontrolluan gjithandej. Atje kishin hyrë me kohë një pjesë e xhandarëve me një kapter nē krye dhe i kishin bërë dhomat lesh e li. Nënën e kishin veçuar me rojë nē fund tē oborrit. Por dyfekun e babait nuk e gjetën.

Çuditem edhe sot e kësaj dite, si nuk u tremba!? Si nuk qava atëherë!? Gjyshja nuk foli, po, kur kapiteni nxori revolen, ajo iu mat me bishtin e shatit:

— Veiz Kopaçja! Veiz Kopaçja! Mbaj vendin, se do ta pësosh keq! Se ka tre djem ai Ali Vigani, dhe një, sa pér t'i marrë hakun, do t'i bëhet atij!

M'u kujtua atë kohë një përrallë e saj se si vajza e një fukarai, pér t'i marrë hakun tē atit, që ia kishte fyter beu nē mes tē pazarit, ishte veshur si djalë dhe... Dhe sa s'i thirra atij qeni, kapitenit: «Babai më ka edhe mua!»

X

Babanë e lidhën që aty në kopsht, në sytë tanë.
Kur xhandarët e vunë përpara, pa hedhur as dy hapa, gjyshja i thirri që pas fort, sa u drodh ajri:

— Ali!...

Edhe babai ktheu paksa kryet dhe iu përgjigj po shkurt e me zë të fuqishëm:

— Mirë, nënë! — Ai e kishte kuptuar se gjyshja i bëri thirrje që ai të mos trembej, të mos epej, t'u qëndronte si burrë qenave, sido që të vinte puna.

Edhe përgjigjja e tij donte të thoshte: «Hiç mos ki merak! Një herë vdes burri! Mirë, nënë, ç'ke ti në zemër e në mendje, ato kam edhe unë. Të kuptova pér të gjitha ç'do të më thuash...»

Dhe eci me ballin lart.

Kur babai e xhandarët nuk po dukeshin më, doli

nëna nga shtëpia. Gjer atë kohë ajo kishte qëndruar brenda; babait do t'i vinte rëndë po ta shihte ajo ashtu, të lidhur me pranga. Burrat andej nga ne kështu e kanë pasur zakon. Po ajo, gjithçka që ndodhi, e kishte parë nga dritarja që binte nga kopshti.

Sapo e pa nënën, gjyshja i tha edhe asaj shkurt:
— Nuse!...

Edhe nëna iu përgjigj po shkurt:

— Nuk kemi q'bëjmë! Do t'i vëmë një gur zemrës dhe do ta kalojmë edhe këtë tramundanë!

«Do t'i vëmë një gur zemrës», përsërita disa herë me vete e shushatur nga tronditja, sikur të kisha marrë një goditje pas kokës. Si në çdo rast edhe këtë herë mençuria e qëndrimi i nënës e i gjyshes më dhanë më shumë kurajë e më bënë më trime.

Ndërsa tetë xhandarët e armatosur bashkë me togerin që morën babanë, u nisën rrugës së Beratit, kapiteni me ca xhandarë të tjerë e me civilë të armatosur u vunë në ndjekje të Rizait. Shfrynte kapiteni nëpër dhëmbët e nxirë, idhnak si bisha, kundërtim eti, njëkohësisht edhe triumfator. Por ngjyra jeshile si e zhabës që i mori fytyra kur babai s'e përfilli fare në lëmë, nuk i kishte ikur ende.

Atëherë m'u kujtua meraku i gjyshes për Rizanë dhe biseda që bëri ajo me babanë apo u panë të vinin xhandarët.

— Ku mund të jetë Rizai tani? — Dhe vështroi nga Rrurrzat e Kuçit.

— Janë larg ata tani, — e shkujdesi babai. — Nuk i arrijnë dot këta qena!

Nga toni i sigurtë me të cilin foli babai, gjyshen e pashë të qetësuar. Pastaj ai vazhdoi:

— Po unë kam një merak tjetër. Rizait sikur ki-

shin nisur t'i enjteshin këmbët dhe kam frikë se mos kjo i pengon gjersa të arrijnë në kufi.

Gjyshja prapë u merakos.

— Kë ka me vete?

— *Ka Myrto Cerovën, Ramiz Spatharën, Riza Valën... Shokët i ka të shëndoshë, xhanëm, janë djem të gjallë ata! Në krahë e marrin, po ta shohin se nuk ecën dot. — Gjyshja sikur u qetësua edhe këtë herë. Ndërsa im atë ra në mendime me vështrimin në zbrazëtirë e foli me vete me zë e si vazhdim të një bisede të heshtur me vetveten: — Po, po, dikush do ta ketë spiunuar Rizanë që po e ndjekin në gjurmë.*

Ne kishim mbetur një copë kohë si të ngrira atje në kopsht, pa marrë asnjë vendim se ç'duhej të bënim pas asaj gjëme që na pllakosi. Dukeshim sikur diçka prisnim, sikur do të niseshim për diku e nuk vendosnim dot, sikur prisnim të vinte dikush e të na përmendte. Shtëpia, dhomat na dukeshin si të huaja e sikur nuk na qasnin. Këmbët nuk kishin fuqi të na shpinin brenda. Mua më bëhej sikur kafazi i kraharorit më qe zbrazur nga gjithçka e mezi merrja frymë. Koha sikur kishte ndalur në vend. Qëndroja si e kotë e sikur luftoja të kapja diçka, pa ditur ç'ishte ajo. Tomori me vargmalet e tjera të gjata e të larta ashtu siç i kisha karshi, m'u bënë sikur lëvizën. «Do t'i vëmë një gur zemrës», kujtova përsëri thënien e nënës dhe aty për aty mblodha veten. Hodha sytë nga tepsia me lakror, ku kishte ngrënë babai.

— Shiko sa pak ka ngrënë! — thirra me dhimbje dhe e ngrita tepsinë ta shikonin nëna dhe gjyshja. — Babai kishte shumë uri!

— Pak, — pohoi gjyshja me pikëllim.

Nëna nuk foli, veç pa nga tepsia një grimë me

sytë ngulur në të, si të bindej në kishte ngrënë vërtetë pak.

— Noke! — iu drejtova dhe nuk prita ta sqaroja ç'doja të bëja, por u lëshova drejt saj dhe i zgjidha futën.

Ajo u habit.

— Ç'po bën?!

— Do shkoj të arrij babanë... Ai nuk u nginj.

Nëna dhe gjyshja vështruan andej nga kishte ikur babai. Donin të merrnin me mend se gjer ku mund të kishte arritur e nëse mund ta arrija dot unë apo jo. Dhe nuk më ndaluan.

Hodha shpejt e shpejt gjysmën e lakinorit në një sahan, theva dhe një gjysmë buke, se do t'i duhej përrugës, e mbështolla me futën e nënës dhe u nisa vrap, zbatohur siç isha, pa pyetur as për gjemba, as për gurët e mprehtë çakëll, që do të m'i grinin shputat e këmbëve si me brisk.

Ruga gjer në krye të fshatit, atje ku i pamë përtë fundit herë xhandarët me babanë, ishte e përpjetë dhe mbante gati një çerek ore. Po unë nuk e bëra për më shumë se pesë minuta. Me të arritur atje, m'u prenë gjunjët, nuk mbushesha dot me frymë dhe u platita sì zog i vrarë. Po nuk qëndrova gjatë. U çova e fillova të bridhja përsëri me sa më hanin këmbët. Nuk shihja asgjë përqark, vetëm rrugën, po edhe atë s'e dalloja mirë, sepse nga lodhja më ereshin sytë. Gulçoja, po vrapin s'e ula. Eca nëpër rrugë të drejtë shtatë a tetë minuta dhe qëndrova. I pashtë tek po i ngjiteshin rrugës së malit tonë. Kurre nuk kisha qenë ndonjëherë gjer atje. M'u kujtua që, kur vinte babai nga pazari i Beratit, unë e Bashkimi dilnim dhe e prisnim atje, te vendi ku kisha arritur tani dhe ruanim rrugën e malit. Me të dalë pazara-

kët atje, ne kërcenim të gëzuar, se babai do të na sillte doemos edhe ndonjë kallam sheqeri ngjyra-
-ngjyra.

Sapo i pashë, thirra me sa kisha në kokë:

— O babaaa! O babaaa!

Më dëgjuan, se i ndalën këmbët një grimë,
kthyen edhe kryet nga u vente zëri, po përsëri u
vunë në lëvizje. Këtë herë e shpejtuan ecjen edhe
më shumë.

Gëzimi që ndjeva kur e pikasa që më dëgjuan
e kthyen kryet, m'u shua në çast. Vazhdova të thë-
rrisja më fort:

— O babaaaaa!... Prisni, ore, prisni sa t'i bie bu-
kën babait...

Thërrisja kështu dhe u jepja këmbëve me sa
mundja. Shuajt e këmbëve më qenë çarë në dy-tri
vende e më kullonin gjak. Tek vrapoja, u pengova
pas një guri të egër dhe m'u zhvat edhe tërë lëkura
e mollëzës së gishtit të madh. Ajo u var si një copë
zhallatë. E kapa me dorë, shtrëngova nofullat nga
dhimbja dhe e këputa. Pastaj prapë vrapova gjith-
një duke gulçuar e duke thirrur.

Jehona e zërit tim prej fëmije, që e përcillnin
pylli dhe shpellat, vazhdonte pa ndërprerje:

— O babaaaaa, ore...!

Sa afër u kisha vajtur, kûr dola sipër në mal e
nuk donin qentë të qëndronin! Po të qëndronin, shu-
më-shumë pér dhjetë minuta i arrija. Ata iknin e unë
pas tyre. Mali, i tërë me gurë gri, pa asnë dru, thi-
thte rrezet përvëluesse të diellit të korrikut e lëshon-
te një afsh të nxehë, që më përcëllonte fytyrën. Era
e lehtë, që frynte rrafsh me tokën e që, duke lëkun-
dur fijet e barit sajonte ca tinguj si vajtim, as që ki-
shte fuqi ta pakësonte atë përvëlim të dyfishtë...

Vrapo e bërtit... Vrapo e thirrë... Vrapo e cirru...
Pastaj nuk e di se ç'ndodhi.

Kur u përmenda, pashë se më kishte marrë përpara duarve një stanar. Sapo hapa sytë, m'u bë sikur dëgjova jehonën e zërit tim:

— O babaaa..., orehee!...

Dhe pyeta:

— E mori bukën babai?

— E mori, e mori, — m'u përgjigj një zë i trashë, i pasigurtë, plot dhimbje. Ishte stanari.

Unë kisha vrapuar pas xhandarëve rrëth dy orë e gjysmë. Sa kohë kisha pa ndjenja nuk e di. Babai ishte këmbyer në rrugë me stanarin që kthehej në fshat e i kishte thënë:

— Shiko, o Luto, përpara do të takosh Lirinë... Ktheje çupën, merre me vete. Me q'mend e nisën atë foshnjë!

— Na, merr bukën time, — i kishte thënë stanari, — dhe për Lirinë mos ki merak.

Më hipi stanari në kalë e u nisëm për në shtëpi. Rrugës më zunë ethe të forta. Avulloja e tëra. Gjithçka para syve e shihja krejt të mjegulluar. Stanari më mbante për krahu. As që e mbaj mend rrugën e kthimit. Por m'i treguan më vonë. Rrugës, në ethe e sipër, u isha lutur xhandarëve të qëndronin. I kisha thirrur babait të më priste.

Pleviti që mora në atë qafë ku kisha mbetur, e djersitur, pa ndjenja, më mbajti dy muaj në shtrat. Ditët e para, siç më thanë, më pas, kur u shërova, flisja përcart, me zë të shuar:

— O baba, orehee!... Prit, o baba, sa të të jap bukën... O xhandarë, orehee!...

Këmbët e çara nga gurët dhe gishti i vrarë mezi m'u shëruan edhe ata.

Edhe sot, pas kaq vjetësh, kur kaloj rrugës së malit të fshatit tim, më duket për një çast sikur dielli lëshon po ato rreze verbuese, si atë ditë, sikur qielli e gurët e malit përvëlojnë njëlloj si atëherë, dhe zëri im sikur ka qëndruar pezull në ajër, duke jehuar:

— O baba, ore...!

* * *

Kryengritja e Fierit u bë biseda e të gjithë njerëzve. Ramizin dhe kushërin e Muço Kapinovës i kishin arrestuar në një ditë me tim atë. Po ashtu, qenë arrestuar në Skrapar edhe mësuesi, Xhaferi, Rizai, Asllani, Neshati... Po t'i mbledhësh dënimet që dha gjyqi i Fierit për skraparlinjtë e arrestuar si pjesëmarrës në Kryengritje, bëjnë qindra vjet.

Fshatarët që na vinin në shtëpi për babanë dhe për mua që rashë e sëmurë, shfrynin:

— Eh, kur nuk e përbysëm dot qenin këtë radhë!

Kurse për beun tregonin se kishte thënë duke fërkuar duart plot kënaqësi:

— Asnjë gjembë në këmbë nuk i hyn mbretit nga këta capacuqë!... Të ngordhin atje në burg!...

Një ditë nëna po milte lopën. Gjyshja më qe ulur te kryet dhe më hiqte e më vinte lecka me ujë të ftohtë në ballë, në duar e në këmbë. Vellezërit e vegjël po luanin pérpara portës së shtëpisë. Në këtë kohë erdhi Bashkimi me draprin në dorë e një deng me shkarpa të thata në krahë. Ai i lëshoi ato në fund të oborrit dhe vajti i vuri shpatullat e lodhura murit të ashefit.

— U lodhe, bir? — e pyeti gjyshja.

— U lodha shumë, moj nana, — iu përgjigj ai, me një zë që nuk të ndillte mendime të mira. Bashkimi i ngjante shumë babait. Hunda e tij e drejtë nuk këpuntej nën vetulla, por ishte vazhdim pa hark i kockës së ballit; tamam si hunda e babait. Kur kishte ndonjë dhembje të thellë në shpirt, i rrudhët vetullat e i vrenjtej fytyra.

— Ç'ke? — i tha nëna e merakosur, tek e pa ashtu të mërzitur. — Mos je gjë sëmurë? Të të ziej një filxhan qumësht?

— Nuk dua. Tani do të hamë darkën.

— Mos të dhemb gjë?

— Jo.

— Mos ke marrë vesh gjë?

Këtë radhë qe gjyshja që pyeti.

Ai, pa e përbajtur dot ngashërimin, mezi shqiptoi:

— Khaxha Rizanë e kanë vrarë!

Vetëm atëherë e kam parë gjyshen të mos e përbante dot veten e të derdhët lotë. Qau dhe mallkoi Ahmet Zogun. Të nesërmën, megjithëse unë isha e sëmurë rëndë, ajo mori Bashkimin e shkoi në Cerovë. Dikush e këshilloi: «Mos shko. Ti nuk e ke gjë. Do të biesh në sy të qeverissë, se spiunët e mbretit këto ruajnë». Por ajo nuk pyeti. Kur u kthyte që andej, na tregoi për durimin e madh që bënte nëna e Rizait. «Nuk m'u vra me turp, — kishte thënë ajo, — po u vra për Shqipérinë!» Ajo i kishte treguar gjyshes edhe për një letër që Rizai u kishte drejtuar asaj, së shoqes e fëmijëve, shkruar në çastet e fundit të jetës. Midis të tjerash u thoshte:

Të dashura nënë, grua, fëmijë!

Më falni që po ju lë rrugëve. Për mua keq të mos ju vijë dhe mos rrini kokëvarura e të turpëruara, se unë për Shqipërinë luftova, për popullin fukarà.

Do të vijë një kohë që Shqipëria do të bëhet e lirë dhe populli nuk do të vuajë më, po kjo do të bëhet pa bejlerë, pa agallarë!...

Kur kishte marrë lajmin e vrasjes së djalit, nëna e Rizait i kishte bërë një letër Ahmet Zogut e i kishte shkruar: «Më dërgo armët e djalit, se dua t'i ruaj për kujtimin e tij, se ai me ato armë ka luftuar për këtë popull e për këtë Shqipëri». Gjyshja tregon te e mua, nëna e Riza Cerovës, që s'e kisha parë kurrë gjer atëherë, më përhihej si shqipe në tramundanë, më e fortë se gjyshja ime. Sado e vogël, por prapë isha në gjendje të kuptoja se, t'i shkruaje mbretit «më jep armët e djalit», ato armë me të cilat ai donte të vriste vetë atë, mbretin, kjo donte kurajë shumë të madhe. Gjyshja fliste me admirim për të, si i priste e i përcillte të gjithë ata që i vinin për ngushëllim, si tregohej e papërgjunjur; tregonte edhe për kurajën e së shoqes së Rizait, dhe ato unë me fantazinë time i shihja shoqe të gjyshes e të nënës sime, të lidhura dorë për dore me njëra-tjetrën e që nuk i thyente dot e keqja.

E P I L O G

Pesë vjet pa babanë! Pesë vjet uri, vuajtje, përpjekje për të jetuar, luftë për t'i shpëtuar vdekjes.

Bashkëfshatarët edhe këtë herë na ndihmuan, por tokë nuk mund të na jepnin dhe ajo copë arë që kishim, nuk na jepte më shumë se tetë muaj bukë, kur bëhej mirë bereqeti. Pastaj, atyre që u tepronë e na huanin sado pak, prapë duhej t'ua kthenim. Bashkimi, atë verë që u burgos babai për së dyti, sapo pati mbushur të katërmبëdhjetat. Megjithatë punonte si kalë. Qetë i ngiste vetë. I ndihmonte edhe nëna. Shumë herë ata e merrnin zvarrë. Krahu i tij nuk kishte aq fuqi, sa t'i rëndonte par mendës e ta mbushte plot, sidomos në mbjelljet e pranverës, kur barkun e kishte më shumë zbrazur. E kam si tanë para syshtë heshtur si dhe babai, fjalëpakë e i ngrysur në fy-

tyrë, ai nuk dinte kurrë të ankohej. Unë i shkoja pas, i hidhja farën. Dy-tri ditët e para më mësoi nëna sa larg duheshin hedhur misri e fasulet; pastaj nuk qe më nevoja. «Të keqen nokja, — më porosiste ajo çdo mëngjes, — me kursim, shiko, me kursim! Misrin hidhe dy pëllëmbë larg kokrrën nga kokrra, me pëllëmbën tënde; fasulet hidhi në pesë kokrra misër, një kokërr fasule». Dhe unë, e kërrusur pas vëllait, i numëroja një më një kokrrat e misrit e të fasuleve. Një kile misër nga i farës po të na tepronente, ishte gjë e madhe; e përzienim me lakra e hanim me të plot dy ditë.

Si ne ishin shumica e fshatit.

Një vit pas burgosjes së babait vdiq xha Kase-mi. Kur i thanë gjyshes, ajo ia bëri: «Shyqyr, korbi, shpëtoi!... Iu mbyllën hallet! I mbaroi kusuret!» Kështu kisha dëgjuar të thoshin, sa herë vdiste njeri në fshat. Por, kur dëgjonin se filanit i kishte ngor-dhur kau apo gomari, rriheshin e përpinqeshin: «Bobo, c'ë gjeti! E theri në grykë, derëzinë! Ia mbylli derën korbit!»

* * *

Ditët e para të prillit 1939, kur u pushtua atdheu nga fashistët italianë, babai, bashkë me shokë të tjerë, u arratis nga burgu, rrëmbeu armët e shkoi në Durrës të luftonte. Atje dhe u plagos e, kur iu mbaruan fishekët, u tërhoq me këmbën e djathëtë zvarrë, duke lënë pas një vazhdë gjaku. Me të lënë pazarin e me të hyrë në një lagje, një grua, sa e pa, i hodhi dorën dhe e ndihmoi të ngrihej:

— Hajde, vëlla, hyr shpejt brenda!... Nuk e

dëgjon si po ulërijnë flamëmëdhenjtë!... Shpejt, se ia arritën qentë!...

Në atë shtëpi e kuruan pér një muaj rresht. Ne nuk dinim asgjë. Megjithatë gjithmonë prisnim.

— Gjersa na thonë se ka njerëz maleve të padorëuar te dushmani, — ia bënte gjyshja, — unë nuk e humbas kurrë shpresën pér Aliun. Ai nuk është nga ata, që humbet si sëpata pa bisht.

Edhe pse shpresën e kishte të madhe, asaj nuk i shkonte kurrë buza në gaz. Sytë e menduar i shprehnin gjithnjë dhimbje. Edhe nëna po ashtu.

Sikur të mos na mjaftonte «humbja» pa nam e nishan e babait, nuk na linin të qetë as spiunët. Ata përgjonin kush hynte e kush dilte në shtëpinë tonë. Nëna, si zakonisht, çohej e para që me natë dhe bënte një kontroll rrëth e rrotull. Dyshonim se mos bejlerët e Arrishtës i bënин ndonjë pritë Bashkimit; ai qe bërë nëntëmbëdhjetë vjeç dhe në ato kohë të turbullta të vriste i ligu e shkoje kot. Një ditë, në mëngjes, kur apo kishte gdhirë, nëna gjeti një karabinier, që e kishte zënë gjumi pas ledhit të selishtës sonë. Erdhi shpejt e lajmëroi gjyshen. Atëherë u zgjua Bashkimi e ua nxori merakun.

— Karabinierët e kanë bërë këtë punë përnatë. Duan të diktojnë babanë.

— Ose pér atë, ose janë të futur nga bejlerët e Arrishtës pér të të vrarë ty, bir! Prandaj ruhu, se kjo kohë!...

... Ishte kohë dreke. Sapo kishim shtruar sofrën. Në magje kishim vetëm miellin e qases së fundit të misrit. Asnjë thërrime tjetër nuk na kishte mbetur. Atë ditë vëllai kishte mbjellë lehët e fundit të misrit e unë i kisha hedhur farën. Qemë lodhur e na kishte

marrë uria shumë. Ndaj gjyshja neve të dyve na i kishte prerë copat e bukës paksa më të mëdha nga të të tjerëve. Vëllai i vogël po shikonte me lakmi sa bukën e tij, sa timen. Theva gjysmën e copës sime, e ndava atë më dysh e ua dhashë vëllait e motrës më të vogël.

Sipas zakonit, meqë atë ditë kishim mbyllur mbjelljen e misrit, duhej të kishim therur një kec, po ne ata pesë keca që kishim do t'i shisnim për bukë. *Kush e ka bukën mbi samar të gomarit apo të mushkës, nuk e hedh dot dorën mbi vesh kurrë.* Nëna, për mbarimin e mbjelljeve na theri një zog e na e kishte bërë me thërrime. Po gjella donte bukë!...

Ishim në kafshitat e para, kur trokiti dera. Pas-taj u dëgjua një zë i gjëzuar:

— A jeni gjallë, o xhiko Këzja!

— Lajm i mirë për Alinë ky! — thirri gjyshja.

Ky që na thirri, ishte kushërir i Muço Kapino-vës. E njohëm të gjithë nga zëri. Buka na u lidh të gjithëve. Unë e para u ngrita e hapa derën. Pas kushëririt të Muços hyri mësuesi e pas tij babai, i veshur me rroba qytetari, me borsalinë në kokë. E njoha, po edhe dyshova. Babai më buzëqeshi.

— Kryetari i komunës, — më tha mësuesi me shaka, duke më treguar babanë.

— Gjyshe!... Noke!... — thirra sa pata në kokë, — babai, babai!

— Mos thirr kaq! — më qortoiëmbël babai, duke më marrë kokën në kraharor e ashtu hymë brenda.

E kujt i hahej bukë në ato çaste!

I ftuam të uleshin me ne në sofër, por të tre kundërshtuan.

— Jemi gjer këtu, — vunë dorën në grykë, —

me bukëvale. Jemi velur kaq, sa gjer nesër nuk na shkon mendja pér bukë.

Që atë drekë mësuam se ardhja e babait duhej mbajtur e fshehtë. Ai do të qëndronte ilegal (ashtu qëndroi gjersa u krijua çeta e parë partizane në Skrapar, ku bashkë me babanë u futën mësuesi, Ramizi e shumë skraparlinj të tjerë.)

Duke folur, babai hodhi sytë nga unë. E kishte marrë malli shumë pér ne. Dukej që në sytë që i shkëndijonin sa herë na shihte. «Ç'të ka babai ty?» Kur isha e vogël e më pyeste kështu, duke më hedhur pérpara duarve, i përgjigjesha: «Djalë», se ashtu më kishte mësuar vetë. Atëherë ai më përgëzonte edhe më shumë e përsériste: «Djalë të ka babai, djalë, djalë!» Unë qeshja e trembur, nga frika mos bija përdhë. Por tani isha rritur, isha katërmëdhjetë vjeçë. «Ç'të ka babai ty?» M'u kujtuan këto e, me sy të ulur përdhë nga turpi, iu përgjigja:

— Çupë më ke, baba. Po ti mos ki merak, se...

Desha t'i thosha: ... se unë nuk kam frikë pér çdo gjë që mund të na ndodhë nga pushtuesit... Desha t'i thosha edhe më shumë: ... se unë do të luftoja përbri tij... Ai e mori me mend ç'më vlonte në shpirt.

— Çupë, — tha duke i theksuar fjalët, — çupë trime të ka babai!

... Kështu, kur kaluan pér herë të parë forcat e Brigadës I Sulmuese nëpër fshatin tonë, unë dola partizane.

Gjer atë kohë gjyshja dhe nëna më patën thënë:

— Ti ke tët atë partizan, ke tët vëlla, mjaft janë nga dera jonë! Pastaj... je çupë, moj bijë.

Megjithatë, kur u nisa, gjyshja hapi sëndukun e vet e nxori që andej një linjë të re.

— Na, bijë, merre, vishe!... Ta kisha ruajtur për pajë, kur të bëheshe nuse!... — Zëri i dridhej.

— Po merre, vishe që tani, nuse e gjyshes.

Atë çast m'u kujtua se si, kur isha e vogël, gjyshja më merrte pranë atij sënduku, e hapte atë, nxirrte që andej plaçkat e veta dhe më tregonte:

— Ja, këta sapunë myshku i kam për ty, kur të të bëjë gjyshja nuse. Ja, edhe këtë linjë të linte e kam për ty...

Atëherë ajo linjë ishte aq e madhe për trupin tim, sa mund të mblidhesha me të kutullaç e nuk e kuptoja dot se ç'do të më vlente një linjë aq e gjerë dhe e gjatë. Por, kur e vesha, më rrinte tamam.

— Sa më je rritur, bijë! — thirri gjyshja e përmallur, sikur ma shihte për të parën herë shtatin.

Edhe nëna nxori nga sënduku i vet dy palë corapë të leshtë me lule, që m'i ruante për pajë.

— Një palë vishi tani, — më porositi, — një palë ruaji në trastë, se është dimër, bijë!... Nuk dihet nëse do të vijë rasti të kalosh këtej me brigadën.

Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Batalionit ku bëja pjesë unë, nuk i rastisi ndonjëherë tjetër të kallonte nga lokaliteti im. Unë u ktheva në fshat pas Clirimt. Kishin kaluar katër vjet që nga dita që kisha dalë partizane.

Vajta në shtëpi e përmalluar e solla ndër mend gjithë jetën time. Çdo gur, çdo qoshe më kujtonte të kaluarën. Ja, atje ku qeshë ulur, vite më parë kishin ndenjur një ditë mësuesi dhe babai...

— Ali, ti do të marrësh hak kundër bejlerëve! Por i vetëm, ti nuk ke ç'u bën atyre! Ja, vrave një, po ata s'janë vetëm një. Po të tjerët? Duhet bashkimi i gjithë popullit. Duhet...

Dhe, tani që kuptoja, se lufta më kishte mësuar shumë, përsërita me vete:

«Po, vetëm kështu, siç i tha mësuesi babait, do të shfaroseshin.

— Ç'thuashtu? — më pyeti nëna. Kisha folur me zë.

— Asgjë, asgjë, — iu përgjigja. Hapa krahët dhe e përfshiva në gjoks.

Sa qe plakur e shkreta nënë në ato vite që s'e kisha parë! Sa kishte rënë edhe e shkreta gjyshe!

Ishin vitet e para të pasçlirimt. I kishim shkundur robërinë e shtypjen nga shpatullat; ato tani ishin të lira e të forta si kurrë ndonjëherë, po i kishim ende të vrara, ende me plagë. Hodha sytë nga dritarja jashtë. Dielli ndriçonte e ngrohte gjithçka. Psħeretiva e fola përsëri me vete me një ndjenjë gëzimi që më vërshonte së brendshmi:

— Po, do të të kthehet edhe ty, nënë, bukuria. Do të përtërihesh edhe ti, gjyshe.

Dhe m'u bë sikur dëgjoja fjalët e komisarit për të ardhshmen...

— Moj po ç'thuashtu!? — u merakos nënë.

— Nuk thashë gjë, nënë, — iu përgjigja. — Diç m'u kujtua... Shpëtuam...

— Po, bijë, — u hodhën në një gojë ato të dyja, — shpëtuam... Të gjitha të tjerat do të rregullohen tani e tutje. Solla ndër mend çastin, kur babai sapo qe kthyer nga Durrësi, pasi i qe mbyllur plaga. Dhe zérin e tij sikur po e dëgjoja si atëherë...

— Nënë, — iu drejtua ai gjyshes, — unë...

Në zérin e tij ndihej vendosmëri. Nga ana tjetër rrinte kokulur, sikur ishte fajtor për vuajtjet që pri-tej të hiqnim e lutej ta falnim.

— Bir, — i tha gjyshja, — bëj si të të thotë zemra ty. Ne me ty e ti me ne, bir.

Ajo kurrë nuk zgjatej. Fliste shumë e prerë.

Edhe nëna i foli e qetë...

— Këto shpatulla, — i tha babait, dhe rrahu me njëren dorë shpatullat e saj, — i kam për burrin e fëmijët. Po qe se ti shpëtimin tënd e të neve të gjithëve e sheh në atë rrugë që thua të zësh, zëre pa qenë kurrë i penduar. Për shtëpinë e fëmijët jam vetë.

— Të gjitha! — përsërita me shpirt, — të gjitha do të rregullohen.

Gjyshja e nëna bënë darkë për kthimin tim. E varfër darka, po sa e gëzuar! Nuk ishte babai; ai nuk erdhi dot me mua, por edhe sikur të ishte, si zakonisht, gjyshja do të ishte në krye, me bashkëfshatarët e ftuar. Edhe pse kishte rënë aq shumë, sytë e saj shprehnin gjallëri, shpirti i saj kishte mbetur gjithnjë i pandryshuar. Kur ja, ajo ia mori këngës burrërishte, siç këndonte gjithmonë:

*Malet e Skraparit, larë e zbukuruuar!
Zhdukëm robërinë, zhdukëm tradhëtarë...*

Këtë këngë e kishte ngritur vetë, ditën që kishte vajtur në fshat lajmi i çlirimt të plotë të atdheut.

Sapo nisi gjyshja, unë ia mbajta. I ngjaj shumë në zë dhe u përpoqa t'i shkoja pas siç donte ajo, se e dija që, po të çaloja sado pak, do t'i prishej qejfi, kurse po të çaloja shumë, do të më ndalonte e do të zgjidhë ndonjë tjetër nga ata që ishin aty e që e dinte si mund t'ia mbante. U kënaq nga unë, sa s'tregohet. Kur mbaroi këngën, hapi krahët e më pushtoi.

— Nuk të kisha dëgjuar të këndoje, bijë! — më

tha aq e gëzuar, sikur të fluturonte. — Shpuzë më ke këtu, shpuzë! — Dhe më vuri kokën në kraharor.

— Ti, — iu përgjigja, duke e shtrënguar edhe më fort, — ti, gjyshe, ma ke ndezur atë zjarr që thua. — Pranë nesh ishte edhe nëna. — Ju, — përsërita duke i përfshirë të dyja në krahet e mi e duke i mbledhur sa më pranë kraharorit, — ju të dyja ma keni shtirë në zemër çdo gjë të mirë, çdo gjë të bukur, të hijshme, të madhe, të zjarrtë...

Dhe ne qëndruam një copë herë ashtu të përqafuara, duke dëgjuar zemrët e njëra-tjetrës.

L E N D A

Faqe

Gurë stralli	3
Rruġa që na bashkoi	24
Djalë guri	37
Filxhanet prej porcelani	59
Zemra tē mēdha (novelē)	89